


Microsoft®  
Windows® XP  
Home Edition

10



M I N U T A  
U D H È Z U E S

**Dhjetë Minuta Udhëzues në Microsoft® Windows® XP,  
Home Edition**

**Copyright © 2002 by Que**

All rights reserved. No part of this book shall be reproduced, stored in a retrieval system, or transmitted by any means, electronic, mechanical, photocopying, recording, or otherwise, without written permission from the publisher. No patent liability is assumed with respect to the use of the information contained herein. Although every precaution has been taken in the preparation of this book, the publisher and author assume no responsibility for errors or omissions. Nor is any liability assumed for damages resulting from the use of the information contained herein.

International Standard Book Number: 0-7897-2737-4

Library of Congress Catalog Card Number: 2001098162

Printed in the United States of America

First Printing: February 2002

05 04 03 02 4 3 2 1

**Albanian translation copyright ©2003 by InfoTech.  
Original English language title: 10 Minute Guide to Windows  
XP, by Shelley O'Hara, by Pearson Education, Inc.  
Copyright by ©2002 by QUE. All Rights Reserved.  
Published by arrangement with the original publisher, QUE.**

**TRADEMARKS**

All terms mentioned in this book that are known to be trademarks or service marks have been appropriately capitalized. Que cannot attest to the accuracy of this information. Use of a term in this book should not be regarded as affecting the validity of any trademark or service mark.

**WARNING AND DISCLAIMER**

Every effort has been made to make this book as complete and as accurate as possible, but no warranty or fitness is implied. The information provided is on an "as is" basis. The author and the publisher shall have neither liability nor responsibility to any person or entity with respect to any loss or damages arising from the information contained in this book.

**Vëmendje:**

Informojmë të gjithë lexuesit se ky tirazh nuk shitet. Sponzorohet nga OJQ InfoTech dhe UNDP per qëllime humanitare.

**Associate Publisher**  
Greg Wiegand

**Acquisitions Editor**  
Stephanie J. McComb

**Development Editor**  
Todd Brakke

**Managing Editor**  
Thomas F. Hayes

**Project Editor**  
Karen S. Shields

**Production Editor**  
Candice Hightower

**Indexer**  
Mandie Frank

**Proofreaders**  
Maribeth Echard  
Harvey Stanbrough

**Team Coordinator**  
Sharry Lee Gregory

**Interior Designer**  
Gary Adair

**Cover Designer**  
Alan Clements  
**Page Layout**  
Susan Geiselman

---

**Editoi:**  
OJQ InfoTech  
Gjilan, Kosovë

**Shtypi:**  
Pika 5A,  
Gjilan, Kosovë

**Përktheu:**  
Bekim Dauti

**Lektoroi:**  
Ganimete Rexhepi

**Tirazhi:**  
1500 copë

**E-mail:**  
ojq\_ngo\_infotech@yahoo.com

**Sponzoroi:**  
UNDP  
Prishtinë, Kosovë

# Përmbajtja

Hyrje.....	1
<b>1 Cilat janë Risit në Windows XP</b>	<b>3</b>
Të Shikuarit e Menysë Start të Rizbukuar.....	3
Përdorimi i Task Pane në Dritaret e Follderave .....	4
Përdorimi i Control Panel .....	6
Të Mësuarit e Thekseve tjera të Windows XP .....	7
<b>2 Të Kuptuarit e Desktop të Windows XP</b>	<b>8</b>
Çka ka në Desktop? .....	8
Përdorimi i Menysë Start .....	9
Puna me Ikonat e Desktop .....	11
Të Shikuarit e Taskbar dhe të System Tray .....	13
Puna me Dritaret.....	14
<b>3 Startimi i Programeve</b>	<b>16</b>
Startimi i Programit nga Menya Start.....	16
Startimi i Programit nga Ikona e Çasjes së Shpejtë.....	19
Kalimet Ndërmjet Programeve .....	19
Mbyllja e Programit .....	20
<b>4 Puna me Dokumentet</b>	<b>21</b>
Ruajtja e Dokumentit .....	21
Mbyllja e Dokumentit .....	23
Hapja e Dokumentit .....	24
Realizimi i Një Dokumenti të Ri.....	25
<b>5 Përdorimi i My Computer për të Organizuar Follderat e Juaj</b>	<b>27</b>
Startimi e My Computer .....	27
Hapja e Drarjave dhe Follderave.....	28
Navigimi i Follderave.....	30
Ndërtimi i Follderit të Ri.....	32
Puna me Folldera .....	33

<b>6</b>	<b>Menagjmi i Fajllav</b>	<b>35</b>
	Shfaqja dhe Selektimi i Fajllave.....	35
	Fshirja e Fajllit.....	36
	Kthimi i Fajllit të Fshirë.....	37
	Riemërtimi i Fajllit.....	39
	Kopjimi i Fajllit.....	39
	Zhvendosja e Fajllit.....	40
<b>7</b>	<b>Gjetja e Fajllave</b>	<b>41</b>
	Pamja dhe Sortimi i Fajllave.....	41
	Kërkimi i Dokumenteve .....	45
<b>8</b>	<b>Shtypja e Dokumentit</b>	<b>48</b>
	Instalimii i Shtypsit .....	48
	Vendosja e Parametrave dhe Preferencave të Shtypjes.....	50
	Shtypja e Dokumentit .....	53
	Të Shikuarit dhe Anulimi i Punëve të Shypsit .....	54
<b>9</b>	<b>Dërgimi i E-mail-it</b>	<b>57</b>
	Konfigurimi i Llogarisë së Juaj të E-mailit .....	57
	Kontrollimi i E-mailit .....	58
	Kthimi i Mesazhit .....	59
	Shkrimi dhe Dërgimi i Mesazhit të Ri.....	61
	Fshirja dhe Shtypja e Mesazheve.....	62
	Dalja dhe Ç'kyçja .....	63
	Mundësitë Tjera me E-mail.....	63
<b>10</b>	<b>Shfletimi i Internetit</b>	<b>67</b>
	Konfigurimi i Koneksionit të Internetit .....	67
	Startimi i Internet Explorer .....	68
	Përdorimi i Lidhjeve për Navigim .....	71
	Shkruarja e Web Adresës .....	72
	Kërkimi në Internet .....	73
	Përshtatja e Internet Explorer .....	75
	Dalja dhe Ç'logimi nga Interneti .....	78

<b>11</b>	<b>Dërgimi dhe Pranimi i Fakseve</b>	<b>79</b>
	Konfigurimi i Fax Console .....	79
	Dërgimi i Faksit.....	80
	Pranimi dhe Shfletimi i Faksit.....	83
<b>12</b>	<b>Puna me Fotografit</b>	<b>85</b>
	Përdorimi i Skenerit ose i Kamerës Digjitale.....	85
	Konfigurimi i Skenerit ose i Kamerës Digjitale.....	86
	Shtypja e Fotografive.....	87
	Dërgimi i Fotografive me E-mail.....	89
	Porositja e Fotografive të Shtypura nga Interneti.....	91
<b>13</b>	<b>Ekzekutimi i Muzikës</b>	<b>92</b>
	Ekzekutimi dhe Regjistrimi i Tingullit përmes Sound Recorder .....	92
	Ekzekutimi i një CD Muzikore.....	94
	Puna me Windows MediaPlayer .....	95
	Përdorimi i Veçorive të Windows Media Player.....	96
<b>14</b>	<b>Përdorimi i Veglave të Tjera të Windows XP</b>	<b>100</b>
	Përdorimi i Windows Movie Maker .....	100
	Argëtimi me Lojra.....	101
	Përdorimi i Kalkulatorit.....	102
	Përdorimi i Command Prompt .....	103
	Përdorimi i WordPad .....	104
	Përdorimi i Paint.....	105
<b>15</b>	<b>Përshtatja e Desktop të Windows XP</b>	<b>107</b>
	Përshtatja e Taskabar ....	107
	Përshtatja e Menysë Start.....	108
	Përshtatja e Desktop .....	110
<b>16</b>	<b>Instalimi i Programeve</b>	<b>116</b>
	Instalimi i Programeve.....	116
	Instalimi i Risive të Windows .....	118
	Instalimi i Komponenteve të Windows.....	119
	Deinstalimi i Programeve.....	120
	Ikonë me Çasje të Shpejtë e Programit .....	122
	Ngjitja e Programit në Menynë Start .....	123

<b>17</b>	<b>Mirëmbajtja e PC së Juaj</b>	<b>125</b>
	Ristartimi dhe Fikja e Kompjuterit.....	125
	Përdorimi i Help.....	126
	Shfaqja e Vetive të Sistemit .....	128
	Shfaqja e Informatave të Diskut .....	129
	Përdorimi i Veglave të Diskut.....	130
	Përdorimi i System Restore .....	133
<b>18</b>	<b>Konfigurimi i Windows për Përdorues të Shumfishtë dhe për Rrjetë</b>	<b>136</b>
	Konfigurimi i Windows për Përdorues të Shumfishtë .....	136
	Bazat e Rrjetës Shtëpiake .....	139
<b>19</b>	<b>Konfigurimi i Hardware të Ri</b>	<b>146</b>
	Konfigurimi i Hardware të Ri .....	146
	Risijimi dhe Zgjidhja e Problemeve të Paisjeve .....	152
<b>20</b>	<b>Përdorimi i Veçorive të Accessibility</b>	<b>160</b>
	Përdorimi i Programeve të Accessibility .....	160
	Përdorimi i Accessibility Control Panel Option .....	164

Autori i librit:

## **DEDIKUAR**

*Mbesave të mia, Alana and Stephanie, të cilat më sjellin shumë krenari dhe kënaqësi në jetën time.*

## **FALËMNDERIMET**

*Falëmnderit Stephanie McComb që më ftoi për të bërë këtë projekt. Gjithashtu, i falëmnderohem Todd Brakke, Kyle Bryant, Karen Shields dhe Candice Hightower për këshillat, editimet dhe korigjimet.*

---

Përkthyesi i librit:

## **DEDIKUAR**

*Të gjithë atyre lexuesve të cilët bëjnë hapat e parë ose tashmë i kanë bërë ato në fushën e Teknologjisë Informative. Zoti ynë shtona diturinë. Kësisoj, largojmë paditurinë dhe ngritemi në nivelet e shoqërive të civilizuara shkencëtarisht.*

## **FALËMNDERIMET**

*Falëmnderit Zotit që më dhuroi jetë, shëndet dhe rast që sado pak të jap kontributin në edukimin e shoqëris. Zoti i shpërbleftë të gjithë që më përkrahën.*

## NA THONI SE ÇFARË MENDONI!

Si lexues i librit, ju jeni komentuesi dhe kritiku më i rëndësishëm. Neve çmojmë mendimin e juaj dhe dëshirojmë të dijmë se çfarë po bëjmë tani, çfarë mund të bëjmë më mirë, cilat fusha do të donit që neve t'i publikojmë, si dhe çdo fjalë tjetër të urtë që dëshironi të na e thoni neve.

Si një publicist shoqëruar i Que, i mirëpres komentet e juaja. Ju mund t'i faksoni, dërgoni përmes e-mail-it, ose të mi shkruani direkt mua ato të cilat u kanë pëlqyer dhe nuk u kanë pëlqyer në këtë libër – ashtu si edhe çfarë duhet të bëjmë neve që t'i bëjmë librat tonë më të fuqishëm.

*Ju lutem të keni parasysh se unë nuk mundem t'u ndihmojë në zgjidhjen e problemeve teknike në lidhje me temat e këtij libri si dhe duke patur parasysh volumin e madhë të e-maila-ve që unë pranoj, nuk do të jem në gjendje t'i përgjigjem secilit mesazh.*

Kur të shkruani, ju lutem të shkruani emrin e librit si edhe autorin, njashtu edhe emrin, numrin apo faksin e juaj. Me kujdes do t'i rishikojë komentet e juaja, si dhe do t'i ndajë ato së bashku me autorët dhe editorët që punuan në këtë libër.

Fax: 317-581-4666  
E-mail: [feedback@quepublishing.com](mailto:feedback@quepublishing.com)  
Posta: Greg Wiegand  
Que  
201 West 103rd Street  
Indianapolis, IN 46290 USA

Fax: (0280) 25 - 944  
E-mail: [ojq\\_ngo\\_infotech@yahoo.com](mailto:ojq_ngo_infotech@yahoo.com)  
Posta: Rr. Evlia Qelebia  
Gjilan,  
Kosovë



## HYRJE

Microsoft Windows XP është versioni më i ri i sistemit operativ Windows, i prezantuar për herë të parë në vjeshtën e vitit 2001. Ky version paraqet një ribërje totale të versioneve ekzistues të Windows, duke bërë që veçoritë të përdoren më lehtë dhe njëkohësisht duke ofruar versione të reja të programeve, siç janë Windows Movie Maker and Internet Explorer. Mësimi 1, “Cilat Janë Risitë në Windows XP,” jep një përmbledhje më të detajzuar për versionin e ri të Windows XP.

## PËRDORUES TË RINJË DHE MBINGRITËS TË SISTEMIT

Nëse, kohëve të fundit keni blerë kompjuter, me siguri se ka ardhur me Windows XP e instaluar në të. Atëherë, ky libër do jetë adekuat për ju që të filloni të përdorni Windows XP. Do t’i mësoni bazat e ekzekutimit të të gjitha detyrave që kanë të bëjnë me përdorimin e kompjuterit, përfshirë këtu: startimin e programeve, ruajtjen e fajllave të juaj, dërgimin e e-mailit, shfletimin e Internetit, si dhe shumë të tjera.

Në qoftë se e keni mbingritur apo mendoni t’a mbingritni sistemin e juaj operativ, ky libër do ju ndihmon të arrini hapin e duhur në Windows XP si dhe të mësoni veçoritë e reja. A duhet t’a bëni mbingritjen? Ndoshta po. Versioni i ri, përveç që përfshinë një mjedis të rizbukuar, gjithashtu përmban në sfondë ndryshimet që e bëjnë këtë version akoma më stabil (më pak i prirur për t’u bllokuar) dhe më intuitiv...

## KONVENTAT E PËRDORURA NË KËTË LIBËR

Ju mund t’a përdorni këtë udhëzues në shumë mënyra. Ju mund t’a lexoni nga fillimi deri në mbarim. Temat janë renditur që nga ato më fillestare e deri ke ato më të avancuara. Ose ju mund të përdorni faqën e përmbajtjes që të gjeni një temë me interes dhe t’a lexoni atë mësim. Do të gjeni mesimet që flasin për aspektet kryesore të Windows XP.

Libri përmban shumë shpjegime që tregojnë hapë pas hapi se si të kryhet një punë. Shumë lehtë do t'i kuptoni. Gjithashtu, figurat ilustronë pikat kryesore, ashtu që të keni një udhëzim të dukshëm deri tek instruksionet.

Për t'u ndihmuar juve që të lëvizni më lehtë nëpër mësimet, janë përdorur këto konventa:

Teksti Onscreen

Teksti Onscreen paraqitet në formatin **bold**.

Tekstin që ju duhet shkruar

Informacionin që ju duhet shkruar është paraqitur në formatin **monospace bold**.

Objektet e selektuara nga ju

Komandat, opcionet dhe ikonat që ju duhet t'i selektoni dhe tastet që ju duhet t'i shtypni janë paraqitur në formatin **bold**.

Duke u sqaruar juve gjatë zgjedhjes së komandave të menyve, ky libër përdorë emrin e formatit të menysë, komandën e menysë. Për shembull, "zgjedhë **File, Properties**" do të thotë të "hapet menya **File** dhe të selektohet komanda **Properties**".



## SHQIPE E QARTË

Janë definuar terminologjit e reja apo të panjohura.



## KËSHILLË

Lexoni këto këshilla që kanë të bëjnë me idetë të cilat do të ju kursejnë nga konfuzionet.



## KUJDES

Kjo identifikon pjesët tek të cilat përdoruesit e rinjë shpeshë zhyten në telashe; këto këshilla ofrojnë zgjidhje praktike të atyre problemeve.

# MËSIMI 1

## Cilat janë Risitë në Windows XP

*Në këtë mësim ju do të mësoni veçoritë e reja dhe të risijuara të Microsoft Windows XP.*

### TË SHIKUARIT E MENYSË START TË RIZBUKURUAR


Windows XP, i prezantuar në vjeshtën e 2001, është versioni më i ri i Windows. Ndryshimi më i madh i dukshëm në këtë version është butoni dhe menya Start. Klikoni butonin Start që të shfaqet menya (shiko Figurën 1.1). Vëreni anën e majtë e cila paraqet programet e përdorura më së shumti, përderisa gjysma e djathtë siguron çasjen deri tek komandat e Windows XP.



FIGURA 1.1

*Vëreni pamjen e re të Desktop, përfshirë këtu edhe butonin dhe menynë Start.*

Në këndin e majtë të sipërm të menysë Start, Windows XP gjithmonë rendit programet për çasjen e Internetit dhe e-mailit (të parafinuara janë Internet Explorer dhe Outlook Express, që të dy këto programe janë pjesë e Windows XP). Nën këto dy programe, ju do të vëreni edhe gjashtë programet më së shpeshti të përdorura nga ju. Për çasje më të shpejtë, ju mund të klikoni secilën nga këto ikona me qëllim që të startoni programin.



## KËSHILLË

Ndrysho menynë Start      Ju mund të modifikoni menynë, duke shtuar programe të tjera në pjesën e majtë, për shembull. Shiko Mësimi 16, “Instalimi i Programeve,” më vonë në këtë libër.

Në qoftë se programi të cilin dëshironi t’a startoni nuk ndodhet në listë, ju mund të përdorni menynë e re All Programs që të hapni listën e të gjithë follderave dhe programeve.

Në qoftë se shikoni në pjesën e djathtë, ju dë të shifni follderat dhe komandat e Windows XP. Për shembull, ju mund të përdorni My Documents që të tregoni përmbajtjen e këtij follderit sistemor. Ju mund të klikoni Control Panel që të hapni Control Panel të Windows XP.

Në pjesën e fundme të menysë Start, ju mund të përdorni butonin Log Off për t’u ç’loguar. Kjo veçori përdoret për përdorues të shumfishtë. Shiko Mësimi 18, “Konfigurimi i Windowsit për Përdorues të Shumfishtë dhe për Rrjetë”, për më tepër informatë. Për t’a fikur ose ristartuar kompjuterin, përdorni butonin Turn Off Computer, i shpjeguar në Mësimi 17, “Mirëmbajtja e PC së juaj.”

## PËRDORIMI I TASK PANE NË DRITARET E FOLLDERAVE

Një veçori tjetër e Windows XP ka të bëjë me atë se si paraqitet përmbajtja e drajvave dhe follderave kur përdorim programet si My Computer ose File Explorer. Pamja e re përmban Task Pane i cili rendit komandat e përbashkëta për objektin e selektuar. Për shembull, në qoftë se ju selektoni një follder, atëherë do të vëreni komandat për punë me folldera. Në qoftë se ju selektoni fajllin, ju do të shikoni komandat për punë me fajlla. Në qoftë se ju selektoni një fotograf, ju do të vereni komandat për punë me fotografitë (shikoni Figuren 1.2).




FIGURA 1.2

*Në vend që t'a mbani në mend se cilën meny apo buton t'a përdorni, ju mund të përdorni komandat përshkruese të Task Pane për të punuar me follderat dhe fajllat.*

## KËSHILLË

Ndryshoni pamjen Windows XP gjithashtu ju bën të mundur që të ndryshoni pamjen e paraqitjes së përmbajtjes të follderave. Shiko Mësimi 6, "Menagjimi i fajllave", si dhe Mësimi 7, "Gjetja e fajllave" për më tepër informatë.

Përfshirja e ikonës My Documents në menynë Start paraqet edhe nje risi tjetër. Vëreni se desktop i Windows XP nuk përmbanë follderat My Documents dhe My Computer si në versionet e mëparshëm. Ju i çasni këta dhe follderat tjerë të zakonshëm, siç është edhe My Pictures, nga menya Start. Klikoni butonin Start, dhe pastaj klikoni emrin e follderit. Po që se e preferoni, ju mund të shtoni ikonat e këtyre follderave në desktop, siç është treguar në Mësimi 2, "Të kuptuarit e Desktop të Wndows XP".

## PËRDORIMI I CONTROL PANEL

Në qoftë se dëshironi që të ndryshoni sa më shumë parametra sipas dëshirës, atëherë përdorni Control Panel. Ju mund të përdorni ikonat e kësaj veçorie të sistemit që të vendosni parametrat e ekranit, ndryshoni parametrat e miut, të shtoni shtypsi të ri, si dhe të bëni ndryshime të tjera të pranueshme. Në versionet e mëparshme, të gjitha ikonat kanë qenë të renditura në një dritare të vetme. Në Windows XP, ikonat e Control Panel janë të grupuara në kategori (shiko Figurën 1.3). Ju mund t'i gjeni më lehtë dhe t'i kuptoni se cilat opsione janë në dispozicion në këtë pamje.





FIGURA 1.3

*Për të hapur Control Panel kliko Start, Control Panel. Ju mund të klikoni secilën nga kategoritë e paraqitura si dhe tiparet në atë kategori.*



## KËSHILLË

Përdorë Classic View Në qoftë se e preferoni që t'a përdorni pamjen origjinale ose nuk mund t'a gjeni ikonën e dëshiruar të Control Panel, kalo në opcionin Classic View duke klikuar komandën Switch to Classic View në Task Pane.

## TË MËSUARIT E THEKSEVE TJERA TË WINDOWS XP

Krahas këtyre ndryshimeve të mëdha, vërehen gjithashtu disa shtesa të reja si dhe ndryshime të disa veçorive tjera. Më poshtë jepet një sqarim i hollësishëm i secilës veçori, e gjithashtu dhe referencat për gjetjen e më shumë informatave:

- **Internet Explorer 6** – Windows XP përmbanë versionin e ri të Internet Explorer. Ky version përmban në vehte veçori të reja të sigurisë përfshi këtu edhe ndryshimin e vogël të pamjes së dritares të browserit. Mësimi 10, “Shfletimi i Internetit” shpjegon këtë program.
- **Windows Messenger** – Ju mund t'a përdorni Windows Messenger për të dërguar dhe pranuar mesazhe të çastit. Shiko Mësimi 9, “Dërgimi i e-mailit”, për më tepër informatë.
- **Llogaritë e përdoruesve** – Në qoftë se më shumë se një përdorues e përdor kompjuterin e juaj, atëherë ju mund t'i konfiguroni llogaritë e përdoruesve të tjerë në atë mënyrë që secili përdorues mund t'a përshtat Windows XP sipas dëshirës së tij. Mësimi 18 shpjegon këtë temë.

Në këtë mësim ju mësuat për pamjen dhe veçoritë e reja të Windows XP. Mësimi 2 shpjegon Desktop i Windows XP – si vend nisje për të gjitha punët.



## MËSIMI 2

# Të Kuptuarit e Desktop të Windows XP

*Në këtë mësim ju do të mësoni për Desktop të Microsoft Windows XP. Pas startimit të PC suaj dhe logimit të suksesshëm, atëherë kjo është ajo që do të shifni.*

### ÇKA KA NË DESKTOP?

Desktop, vend nisja e juaj, siguron çasje deri tek të gjitha programet dhe fajllat në kompjuterin e juaj (shiko Figurën 2.1). Ja një rishikim i shpejtë i tërë asaj çfarë ju po shifni:

- Desktop është sipërfaqja e sfondit. Ju mund të vendosni ikonat në desktop për të patur një çasje më të shpejtë deri tek programet dhe follderat.
- Butoni Start përdoret për të hapur menynë Start (i shpjeguar në paragrafin tjetër).
- Taskbar tregon butonin e secilës dritareje ose programi të hapur. Në Figurën 2.1, Outlook Express është i hapur. Ju mund të klikoni butonin në Taskbar për të hapur dritaren e këtij programi.
- System Tray përmban ikonat e punëve aktive. Për shembull, në qoftë se ju jeni duke shtypur, ju do të vëreni ikonën e shtypsit. Në qoftë se ju jeni të lidhur në Internet, ju do të vëreni ikonën e lidhjes. Për më tepër informatë në lidhje me System Tray, shiko paragrafin "Të shikuarit e Taskbarit dhe System Tray" pak më vonë në këtë mësim.
- Ikonat e Desktop sigurojnë çasje deri tek programet, follderat dhe fajllat e kompjuterit. E vetmja ikonë e cila paraqitet në Desktop është Recycle Bin. Ju mund të shtoni edhe ikona të tjera. Shiko paragrafin "Puna me Ikonat e Desktop" më vonë në këtë mësim.






FIGURA 2.1

*Desktop i ri është mjaftë i thjeshtë dhe jo i rrëmujshtëm.*

## KËSHILLË

Ndrysho sfondin e Desktop    Ju mund të ndryshoni pamjen e desktop. Për më tepër informata, shih Mësimi 15, "Përshtatja e Desktop të Windows XP".

## PËRDORIMI I MENYSË START

Kur të hapni një follder ose të startoni një program, përdoreni menynë Start. Siç është përmendur edhe në Mësimi 1 "Cilat janë risit në Windows XP," menya Start në Windows XP ka pamje të re, kështu që në qoftë se jeni duke bërë mbingritjen nga versioni paraprak, shikojeni se si

menya Start është e organizuar. Dhe, në qoftë se jeni i ri në Windows XP, ju shumë lehtë do të ambientoheni me menynë Start. Thjeshtë, klikoni butonin Start që të hapet menya (shiko Figurën 2.2).




FIGURA 2.2

*Kur të klikoni në butonin Start ju do të shifni komandat në menynë Start.*

Në pjesën e sipërme majtas menysë Start, ju shifni programet që juve i përdorni për Internet dhe e-mail. Ju mund të klikoni komandën e dëshiruar që të startoni programin. Për shembull, për t'a startuar programin për e-mail, klikoni **E-mail**.

Poshtë programeve për Internet dhe e-mail, ju shifni gjashtë programet që juve i keni përdorur më së shpeshti. Kjo listë ju mundson që në mënyrë të lehtë të startoni programet më të përdorura nga ana juaj. Kliko emrin e programit që të startohet ai program. Çfarë do të shifni në menynë Start është e ndryshme nga ajo çfare paraqitet në Figurën 2.2. Ju shifni programet që i përdorni më së shpeshti si dhe programet e selektuara të Internetit dhe e-mailit.

Në qoftë se programin të cilin dëshironi t'a startoni nuk ndodhet në listë, atëherë ju duhet të klikoni All Programs që të shfaq të gjithë follderat e programeve dhe programet në kompjuterin e juaj. Ju do të mësoni më shumë në lidhje me startimin e programeve në Mësimi 3, "Startimi i Programeve."

Në vend që t'i përmbajë ikonat e Desktop për follderat në desktop (si në rastin e versioneve paraprake), Windows XP liston follderat në menynë Start. Ju mund të klikoni cilindo nga këta folldera My Documents, My Pictures, My Music, ose My Computer, për t'ë hapur këta folldera. Shiko Mësimi 5, "Përdorimi i My Computer për të Organizuar Follderat e Juaj", për më tepër informatë për sa i përket hapjes së follderave.

Përveç follderave, Windows XP rendit edhe komandat si Control Panel, Connect To, Help and Support, Search, dhe Run. Për t'a startuar ndonjë nga komandat mjaftonë që të klikoni njëherë me tastin e majtë të miut.

Kur të keni mbaruar punën me kompjuter, ju mund t'a fikni atë duke përdorur butonin Turn Off Computer. Në qoftë se përveç jush edhe ndokush tjetër e përdorë po të njëjtin kompjuter, atëherë ju mund të ç'logoheni nga sistemi ose të ndërroni përdoruesit duke përdorur butonin Log Off në mënyrë që personi tjetër të logohet në sistem.

## KËSHILLË

**Ristarto Kompjuterin** Në qoftë se ndodhë që kompjuteri i juaj është bllokuar ose në qoftë se bëni ndryshime në veçoritë kryesore të sistemit, do të duhet t'a ristartoni kompjuterin. Klikoni Turn Off Computer, dhe pastaj klikoni Restart. Për më tepër informatë në lidhje me fikjen dhe ristartimin e kompjuterit, shiko Mësimi 17, "Mirëmbajtja e PC së Juaj."

## PUNA ME IKONAT E DESKTOP

Në formë të parafinuar, Windows XP tregon vetëm Recycle Bin në desktop. Ju mund të shtoni ikona të çasjes së shpejtë ashtu që të keni një çasje më të favorshme deri tek programet më të përdorura nga ana e juaj. Një shembull, do të mund të ishte vendosja e ikonave të My Computer dhe My Documents në Desktop.

Për të shtuar ikonat e My Documents, My Computer, ose të My Network Places në Desktop, ndjek këta hapa:

1. Kliko me tastin e djathtë të miut hapsirën e zbrazët në Desktop që të paraqisni menynë e çasjes së shpejtë.
2. Kliko komandën **Properties**. Do të paraqitet kutia për dialog e Display Properties.

3. Kliko tabulatorin **Desktop** që të paraqiten këto opsione.
4. Kliko butonin **Customize Desktop**.
5. Në tabulatorin **General**, të paraqitur në Figurën 2.3, zgjedhni secilën nga ikonat që ju dëshironi t'i keni në Desktop. Për shembull, pët t'a shtuar follderin My Documents në Desktop, kliko në katrorin e kontrollit të follderit **My Documents**.
6. Kur të keni mbaruar, kliko **OK**. Secila nga ikonat që ju i keni zgjedhur, do të paraqiten në Desktop.





FIGURA 2.3

Përdoreni këtë kuti dialogu për të shtuar ikonat në desktop si dhe të ndryshoni pamjen e këtyre ikonave.



## KËSHILLË

Realizimi i Follderave dhe Fajllave me çasje të shpejtë Për të realizuar ikona me çasje të shpejtë të follderave dhe fajllave tjerë, sigurohuni që të keni pamje tek ai follder ose fajll. Kliko me tastin e djathtë të miut njëherë mbi follder ose fajll dhe zgjedh opcionin **Send To, Desktop** (Create Shortcut).

Përveç follderave me çasje të shpejtë, ju mund të shtoni edhe ikonat e programeve. Që të realizoni një program me çasje të shpejtë në Desktop, shikoni Mësimi 16, "Instalimi i Programeve."

Pasi t'i keni vendosur ikonat, ju mund t'i zhvendosni, t'i fshini, si dhe t'i riemërtoni ato në Desktop sipas nevojës:

- Për t'a zhvendosur ikonën, klikojeni atë njëherë me tastin e majtë dhe mbajeni të shtypur butonin e majtë të miut dhe pastaj tërhiqeni në drejtimin e dëshiruar.
- Për t'a fshirë ikonën, klikojeni atë njëherë me tastin e majtë dhe pastaj shtypni tastin Delete nga tastiera. Konfirmojeni fshirjen duke klikuar butonin **Yes**. Vëreni, në qoftë se fshini ikonë me çasje të shpejtë të ndonjë programi, ju nuk keni shlyer programin në fjalë, por vetëm ikonën. Për t'a larguar programin nga sistemi, deinstaloheni atë ashtu siç është shpjeguar në Mësimi 16, "Instalimi i Programeve."
- Për t'a riemërtuar një ikonë, kliko me tastin e djathtë te miut mbi ikonë dhe zgjedhni opcionin Rename. Shkruani emrin e ri dhe shtypni tastin Enter.

## TË SHIKUARIT E TASKBAR DHE TË SYSTEM TRAY




Taskbar, siç është përmendur, përmban butonat e të gjitha dritareve dhe programeve të hapura. Për të ri-zgjuar një program specifik ose dritare, klikoni butonin përkatës në Taskbar.

System Tray është pjesë e Taskbar dhe tregon orën si dhe ikonat aktive. Në mënyrë periodike, një mesazhë lajmëruet paraqitet nga System Tray për të lajmëruar për ndodhitë apo aksionet sygjeruese. Për shembull, kur një dokument të jetë shtypur me sukses, ju shifni ikonën e shtypsit si dhe mesazhin i cili tregon se puna e shtypjes është përmbyllur. Për t'a mbyllur mesazhin, kliko butonin e saj për mbyllje.

Windows XP gjithashtu mund të ju lajmrojë që të shikoni risijimet ose të provoni ndonjë veçori më të re (posaçërisht MSN Passport, të cilin ju mund t'a përdorni për të pranuar dhe dërguar mesazhi të çastit). Për t'a çasur një nga veçoritë e theksuara, kliko në mesazh.

## PUNA ME DRITARET

Windows XP shfaq të gjitha programet dhe përmbajtjen e tyre në dritare në desktop. Për shembull, kur ju të startoni një program, ju shifni dritaren e programit. Kur ju hapni një follder, ju shifni përmbajtjen e follderit në dritare. Gjithashtu pjesë përbërëse e punës me dritaret, është edhe të kuptuarit e manipulimit të dritareve ashtu që ju të mund të shifni dhe punoni me hapsirën që doni. Rishikoni këto metoda të thjeshta në formë të ndihmës, ashtu që të mund të punoni me çdo llojë të dritareve:

- Për të hapur dritaren e programit, startoni programin (siç është sqaruar në Mësimi 3). Për të hapur dritaren e përmbajtjes bëni klik të dyfishtë në drajv ose ikonën e follderit, ose selektoni follderin nga menya Start.
- Kur dritarja të jetë hapur, ju shifni kontrollorët e dritares në këndin e sipërm djthtas. Figura 2.4 paraqet dritaren e hapur të My Computer. Dritarja aktive paraqitet mbi çdo dritare tjetër të hapur si dhe shiriti i emërimit është me ngjyrë më të n'dritur.
- Për të mbyllur dritaren, kliko butonin **Close** .
- Për të minimizuar dritaren (zvogluar atë në Taskbar), kliko butonin **Minimize** .
- Për të zmadhuar dritaren, ashtu që ajo të mbushë tërë ekranin, kliko butonin **Maximize** .

### KËSHILLË

Dritaret e Zmadhuara Kur dritarja të jetë zmadhuar atëherë ajo nuk ka kufij; çka do të thotë, se ju nuk mund t'a zhvendosni apo t'a rizmadhoni për faktin që ajo mbush tërë ekranin. Gjithashtu, butoni për Maximize konvertohet në buton Restore. Ju mund të klikoni butonin Restore për t'a kthyer dritaren në madhësinë e saj të pararendinuar.




FIGURA 2.4

Në dritaren My Computer ju mund të zhvendosni, ri-zmadhoni, minimizoni, si dhe të mbyllni dritaren sipas nevojës.

- Për të zhvendosur dritaren, vendos shënjesin e miut mbi shiritin e emërit dhe duke mbajtur të shtypur tastin e majtë tërhiqje dritaren në lokacionin e dëshiruar.
- Për të ri-zmadhuar dritaren, vendos shënjesin e miut në kufijtë e jashtëm të dritares dhe duke mbajtur të shtypur tastin e majtë të miut, tërhiqje kufirin në drejtimin e dëshiruar.

Në këtë mësim ju mësuat për Desktop të Windows XP si dhe mënyrën se si të punojmë me dritaret. Në Mësimi 3 “Startimi i Programeve” ju do të mësoni t’i startoni dhe mbyllni programet.



## MËSIMI 3

# Startimi i Programeve

*Në këtë mësim ju do të mësoni t'i startoni, të kaloni ndërmjet dhe t'i mbyllni programet.*

### STARTIMI I PROGRAMIT NGA MENYA START

Ju kaloni kohën më të madhe me kompjuter duke punuar në ndonjë nga programet - programi për përpunimin e tekstit për të shkruar ndonjë dokument, programi për llogaritje tabelare për të llogaritur buxhetin, dhe të tjerë. Ju mund të startoni programin në shumë mënyra, përfshi këtu edhe atë nga menya Start.

Kur ju instaloni një program të ri në Windows XP, procedura e instalimit të programit krijon ikonën e programit (nganjëherë edhe follderin e programit, në qoftë se programi përmban disa komponente). Këto do të vendosen përbrenda menysë Start.

Ju mund të përdorni një nga dy metodat e përdorimit të menysë Start. Në qoftë se përdorni një program shumë shpesh dhe i cili ndodhet në menynë Start, ju mund t'a klikoni atë nga paneli i majtë i menysë Start. E në qoftë se programi nuk ndodhet në panelin e majtë, atëherë ju duhet të shfaqni të gjithë programet.

### STARTIMI I PROGRAMIT TË RI

Ndjekë këta hapa që të startosh një nga programet tuaja më të përdorura më së shpeshti:

1. Kliko butonin **Start**. Paneli i majtë afishon gjashtë programet më të përdorura nga ana juaj.
2. Kliko programin. Programi startohet dhe ju shifni dritaren e programit.



## KËSHILLË

Ndrysho Listën Ju mund të ndryshoni numrin e paraqitjes së programeve më të përdoruar në panelin e majtë të menysë Start, ashtu siç edhe mundeni të fshini tërë listën. Për të bërë një gjë të tillë, klikoni tastin e djathtë të miut mbi butonin Start dhe zgjedhni opcionin **Properties**. Në faqen Start Menu, klikoni **Customize**. Në kutinë e dialogut të opcionit Customize, jepni numrin e programeve që do të afishohen. Për t'a fshirë listën, klikoni butonin **Clear List**.

### LISTIMI I TË GJITHA PROGRAMEVE

Ndjek këta hapa për të startuar njërin nga programet e instaluar:

1. . Kliko **Start**, dhe pastaj kliko butonin **All Programs**. Ju shifni listën e të gjitha ikonave dhe të follderave të programeve (shiko Figurën 3.1)




FIGURA 3.1

Ju mund të çasni të gjitha programet e instaluara duke klikuar butonin All Programs tek menya Start.

2. Sipas nevojës, klikoni follderin e programit. Secili opcion që ka pranë një shigjetë paraqet follderat e programit dhe jo ikonat. Kur të keni klikuar follderin e programit, ju shifni ikonat e programit përbrenda atij follderi. Për shembull, në qoftë se klikoni tek opcioni Accessories, ju shifni programet e Accessories të përfshira në Windows XP. Ndjek këtë hap deri sa të vëreni ikonën e programit të cilin dëshironi t'a startoni.



## KËSHILLË

Shënjo ose Kliko Për të treguar një follder, thjeshtë ju mund të shënjoni e jo edhe të klikoni. Në qoftë se keni telashe që t'a mbani menynë të hapur atëherë më lehtë do t'a keni të klikoni se sa të shënjoni.

3. Kliko ikonën e programit që t'a startosh programin. Programi hapet në dritaren e tij dhe në Taskbar paraqitet butoni i Taskbar i cili tregon dritaren e hapur. Figura 3.2 paraqet WordPad, një program i cili është pjesë e Windows XP.




FIGURA 3.2

*Shumica e dritareve të programeve përmbajnë elemente të ngjashme, duke e bërë që këto të mësohen më lehtë, për faktin se paraqiten në të gjitha programet. Për shembull, për afërsisht të gjitha programet e përmbajnë shiritin e menyve, të cilin ju e përdorni për të zgjedhur komandat.*

## STARTIMI I PROGRAMIT NGA IKONA E ÇASJES SË SHPEJTË

Përveç mënyrës së startimit përmes menysë Start, ju mund të startoni programet edhe përmes ikonave me çasje të shpejtë. Disa programe në mënyrë automatike krijojnë ikonat me çasje të shpejtë, duke i vendosur ato në desktop. Gjithashtu, ju mund të shtoni ikona të çasjes së shpejtë të programeve edhe vetë, ashtu si është shpjeguar në Mësimi 16, "Instalimi i Programeve."

Për të startuar programin nga ikona me çasje të shpejtë, kliko dy herë me tastin e majtë mbi ikonën me çasje të shpejtë në Desktop. Programi startohet dhe hapet në dritaren e vetë. Në Taskbar paraqitet butoni i këtij programi.

## KALIMET NDËRMJET PROGRAMEVE

Shpeshë mund të punoni edhe me më shumë se një program njëkohësishtë. Windows XP ju bën të mundur që shumë shpejtë të bëni kalimet nga një program në tjetrin. Për shembull, ju dëshironi të shikoni pasqyrën e shitjeve në një tabelë, përderisa në anën tjetër ju bëni raportin e shitjeve në programin për përpunim të tekstit. Kalimet ndërmjet programeve ju bëjnë të mundur që jo vetëm të shikoni të dhënat nga burime të ndryshme, por gjithashtu edhe të shkëmbeni të dhënat ndërmjet programeve.

Siç kemi përmendur, kur ju startoni një program, butoni i atij programi paraqitet në Taskbar. Për të kaluar në program tjetër, thjeshtë klikoni butonin e atij programi. Ai program bëhet programi aktiv. Për shembull, në Figurën 3.3, Outlook Express është i hapur së bashku me WordPad. Ju mund të thoni se WordPad është programi aktiv sepse butoni i tij është i errësuar. Për të kaluar në Outlook Express, klikoni butonin e tij në Taskbar.



FIGURA 3.3

*Butonat e Taskbar paraqesin emrin e dokumentit dhe të programit për secilin program dhe dritare të hapur.*

## MBYLLJA E PROGRAMIT

Kur të keni mbaruar punën me ndonjë program, mbylleni atë që të lironi kujtesën e sistemit (kujtesën RAM). Megjithëse sistemet me 128MB RAM kujtesë ose edhe më shumë mundën të punojnë pa ndonjë problem me më shumë se një program njëkohësisht, në anën tjetër puna me më shumë se një program ngarkon kujtesën e sistemit si dhe bënë që të ngadalsohet procesimi i të dhënave. Ju mund të përdorni një nga metodat vijuese për të mbyllur programet:

- Klikoni menynë **File**, dhe pastaj klikoni komandën **Exit**. Programi mbyllet
- Klikoni butonin **Close** në dritaren e programit.
- Shtypni **Alt+F4** në tastier kur dritarja është aktive.



### KUJDES

Së pari Ruaj! Në qoftë se ke shkruar një dokument në program, sigurohu që t'a kesh ruajtur para se t'a mbyllësh programin. Në qoftë se nuk e ke ruajtur fajllin dhe e ke mbyllur programin, shumica e aplikacioneve kërkojnë nga ju që të ruani punën e juaj. Për t'a ruajtur dokumentin, kliko **Yes**. Për t'a mbyllur dokumentin pa e ruajtur fare, klikoni **No**. Për t'u kthyer në dokument pa e mbyllur programin, kliko **Cancel**. Shih Mësimi 4, "Puna me Dokumentet" për detaje më të hollësishme në lidhje me ruajtjen e fajllave.

Tani kur keni mësuar se si të startoni programet, kaloni në mësimin e ardhëshëm për të marrë informata në lidhje me ruajtjen dhe hapjen e dokumenteve që ju i keni ndërtuar përmes këtyre programeve.

## MËSIMI 4

# Puna me Dokumentet



*Në këtë mësim ju do të mësoni të ruani, hapni dhe krijoni dokumente.*

### RUAJTJA E DOKUMENTIT

Kur punoni në përgjithësi me programe, ju e ruani punën e juaj si një lloj i dokumentit – si fajll i përpunimit të tekstit siç është memo, si fajll tabelar siç është buxheti, si fajll i bazës së të dhënave siç është lista e klientëve, dhe të tjera. Një nga gjërat më të rëndësishme që ju duhet të mbani në mend në lidhje me përdorimin e kompjuterit është se ju duhet të ruani punën e juaj dhe atë ruajeni shpesh.



### KUJDES

Ruaj më Shpeshë      Mos pritni deri sa ju të përfundoni dokumentin e pastaj t'a ruani. Në qoftë se ndalet rryma ose kompjuteri bllokohet, ju do të humbni tërë punën e juaj në qoftë se nuk e keni ruajtur. Në vend të kësaj, ruajeni në mënyrë periodike përderisa jeni duke realizuar dhe edituar dokumentin.

Kur ju e ruani punën e juaj, programi e ruan fajllin në formatë të veçantë. Kur t'a ruani fajllin për herë të parë, ju duhet t'a emërtoni fajllin dhe të caktoni vendin ku do të ruhet ai. Ju mund të jepni deri në 255 karaktere për emrin, përfshirë edhe hapësirat në mes fjalëve. Për vendin e ruajtjes, ju mund të zgjedhni njërin nga drajverat dhe follderat në kompjuterin e juaj.

Ndjek këta hapa për t'a ruajtur dokumentin:

1. Kliko **File**, dhe pastaj kliko komandën **Save As**. Do të paraqitet kutia e dialogut Save As (shiko Figurën 4.1).




FIGURA 4.1

*Kjo është kutia e dialogut për ruajtje në WordPad. Opcionet e kutisë së dialogut ndryshojnë nga programi në program.*




## KUJDES

Ruaj Shpeshë Hapat për ruajtjen e dokumentit në përgjithësi janë të njëjtë, pamvarësisht aplikacionit që juve përdorni. Megjithë atë, disa programe ofrojnë opsione plotësuese për ruajtje. Për t'u udhëzuar në mënyrë ekzakte për programin në fjalë, shfletoni manualin e aplikacionit.

2. Shkruani emrin. Disa programe gjenerojnë vetvetiu emërin. Është e preferueshme të zëvendsoni këtë emër të gjeneruar me një emër shumë më përshkrues.
3. Selektto vendin e ruajtjes së fajllit:
  - për t'a ruajtur dokumentin në follder tjetër, bëni klik të dyfishtë mbi atë follder në goftë se ndodhet në listë.

për t'a zgjedhur një nga follderat e përdorur më së shumti, kliko ikonën tek Places Bar. Për shembull, për t'a hapur follderin My Computer, kliko butonin **My Computer**.


në qoftë se follderit nuk ndodhet në listë, ju mund të lëvizni nëpër strukturën e follderave duke klikuar butonin **Nup One Level** .

për t'a zgjedhur një drajv apo follder tjetër, shfaq Save në formë të listës rënëse, dhe pastaj selekto drajvin apo follderin e dëshiruar.

4. Kliko **Save**. Dokumenti është ruajtur, dhe shiriti i emërit tregon emrin e dokumentit.

Pasi t'a keni ruajtur dhe emërtuar fajllin, ju mund të klikoni **File** dhe selektoni **Save**, për të riruajtur të njëjtin fajll në të njëjtin lokacion dhe me të njëjtin emër. Kur ju ruani përsëri, fajlli është i risijuar në atë mënyrë që ruan çdo ndryshim apo shtesë që keni bërë në fajll.

## KËSHILLË

Krijoni një follder të Ri Ju mundeni të ndërtoni një follder të ri nga vetë kutia e dialogut Save As. Për t'a bërë një gjë të tillë, klikoni butonin **Create New Folder** , shkruani emrin e follderit të ri dhe klikoni Enter.

## MBYLLJA E DOKUMENTIT

Kur të keni mbaruar së punuari me dokumentet, mbylleni atë që të lironi resurset e sistemit. Shumica e programeve, me përjashtim të WordPad dhe Paint, përmbajnë komandën Close si dhe butonin Close në dritaren e dokumentit. Për t'a mbyllur dokumentin, kliko menynë **File, Close** ose kliko butonin **Close** në dritaren e dokumentit. Në WordPad dhe Paint ju duhet të hapni një dokument tjetër, të realizoni një dokument të ri, ose të mbyllni programin që të mbyllni edhe dokumentin.

## HAPJA E DOKUMENTIT

Siç është përmendur më herët, kur ruani dokumentin të dhënat ruhen në fajll në vendin (follder dhe drajv) që ju e keni selektuar. Po që se dëshironi të punoni përsëri në atë follder, për shembull, për të bërë ndryshime, për të shtypur fajllin dhe kështu me rradhë, atëherë duhet hapur fajllin. Ndjek këta hapa për të hapur një dokument:

1. Në qoftë se është e nevojshme, starto programin që ke përdorur për të krijuar fajllin.
2. Kliko menynë **File**, dhe pastaj kliko komandën **Open**. Shfaqet kutia e dialogut e komandës Open (shiko Figurën 4.2). Në qoftë se e sheh fajllin që donë t'a hapësh, atëherë kalo në hapin 4.




FIGURA 4.2

*Përdorë kutinë e dialogut të komandës Open për të shfaqur dhe hapur dokumentet me të cilat dëshironi të punoni.*

3. Sipas nevojës, ndrysho vendin ku fajlli është ruajtur duke bërë njërin nga hapat vijues::

Kliko dy herë follderin i cili përmban fajllin.

Në qoftë se nuk e sheh follderin në listë, kliko butonin **Një nivel më lartë** për të lëvizur nëpër folldera dhe për të shfaqur follderat tjerë.



Për të shfaqur ndonjë drajv tjetër ose follder, shfaq listën rënëse dhe selekto drajvin apo follderin.

Për të shfaqur një nga follderat e zakonshëm, kliko emrin e tij në Shiritin e vendeve. Për shembull, për të hapur follderin My Documents, kliko butonin **My Documents** në Places Bar.

4. Kur t'a shifni fajllin që dëshiron t'a hapësh, kliko dy herë emrin e tij për t'a hapur fajllin. Dokumenti do të shfaqet në ekran.



## KËSHILLË


Nuk mund t'a gjejë fajllin Në qoftë se nuk mund t'a gjeni fajllin që ju duhet, mund të jetë që nuk e keni ruajtur aty ku keni menduar. Provoni t'a kërkonin në ndonjë drajv apo follder tjetër. Në qoftë se akoma nuk mund t'a gjeni, provoni të bëni kërkimin e fajllit. Për më tepër informatë në lidhje me kërkimin e fajllave, shiko Mësimi 7, "Gjetja e fajllave."

## REALIZIMI I NJË DOKUMENTI TË RI

Kur startoni shumicën e programeve, shfaqet një dokument i zbrazët. Në qoftë se e përdorë këtë dokument dhe e ruan atë, ju çdo herë mund të realizoni një dokument të zbrazët në çdo kohë. Përveç dokumenteve të zbrazëta, shumica e programeve u bëjnë të mundur selektimin e Template (formularit) në të cilin do t'a bazoni dokumentin e juaj të ri. *Template* është një dokument i dizajnuar paraprakisht që përmban tekstin dhe formatimin. Në qoftë se, nuk doni dokument të zbrazët, atëherë ju mund të selektoni një formular për dokumentin e ri.

Për të krijuar një dokument të ri, ndjek këta hapa:

1. Në program, kliko menynë **File**, opcionin **New**.
2. Në qoftë se, paraqitet një kuti e re e dialogut, kliko llojin e dokumentit që dëshiron të realizosh dhe kliko butonin **OK**. Dokumenti i ri shfaqet. Ju mund të përdorni secilën nga vegëlat e programit për t'a realizuar dhe ruajtur këtë dokument të ri.



## KËSHILLË

Realizimi i dokumenteve                      Për instruksione më të sakta në lidhje me përdorimin e programit për të krijuar një dokument, shiko dokumentacionin e programit. Vendosija e të dhënave në shumicën e programeve është e drejtëpërdrejtë.. Për shembull, në programet për përpunim të tekstit, ju vetëm filloni të shkruani. Në programet tabelare ju selektoni katërkëndshin (pikë takimi i rreshtit dhe i shtyllës) dhe shkruani të dhënë. Instruksionet për programe më komplekse, për shembull, programe te bazave të të dhënave kërkojnë më shumë punë paraprake.

Në këtë mësim, ju mësuat rëndësinë e ruajtjes së punës suaj si dhe gjithashtu edhe se si të rihapni dokumentin që ju e keni ruajtur. Në Mësimi 5, "Përdorimi i My Computer për të Organizuar Follderat e Juaj," ju do të mësoni si t'i organizoni dokumentet që i keni ruajtur nëpër folldera.

## MËSIMI 5

# Përdorimi i My Computer për të Organizuar Foldersat e Juaj



*Në këtë mësim, do të mësoni të hapni My Computer dhe të navigoni ndërmjet folderave në kompjuterin e juaj.*

### STARTIMI I MY COMPUTER

My Computer është një ikonë e cila përmban të gjithë drajvat e sistemit të juaj. Për të hapur folderat dhe shfaqur fajllat, zakonisht ju duhet të klikoni tek **My Computer**. Kur ju të keni hapur këtë dritare, pastaj do të mund të hapni secilin nga drajvat për të parë se cilët foldera dhe fajlla përmban ai drajv.

Pse do të bënit një gjë të tillë? Kur ju keni nevojë për të hapur një fajllë të posaçëm, ju duhet t'a gjeni dhe hapni folderin i cili përmban atë fajll. Për shembull, në qoftë se ju dëshironi të krijoni një ikonë me çasje të shpejtë të atij programi, atëherë ju duhet së pari të hapni fajllin e programit. Kur ju do të doni të zhvendosni, kopjoni, ose edhe të fshini fajllat, ju i bëni të gjitha këto duke i shfaqur ata. Përsëri, ju e gjeni dhe e hapni folderin në të cilin janë ruajtur fajllat.

Ndjek këta hapa për të hapur My Computer:

1. Kliko butonin **Start**.
2. Kliko **My Computer**. Ju shifni ikonat e secilit drajv në kompjuterin e juaj, përfshi këtu edhe folderat e sistemit (shiko Figurën 5.1).





FIGURA 5.1

*Kur dëshiron të punosh me folderat apo fajllat në kompjuterin tënd, ti mund të fillosh me My Computer.*



## KËSHILLË

Përdorë Ikonën me Çasje të Shpejtë Në qoftë se ke vendosur ikonën me çasje të shpejtë të My Computer në desktop, atëherë me klikun e dyfishtë ju do të hapni ikonën My Computer. Shiko Mësimi 2, "Të Kuptuarit e Desktop të Windows XP" për më tepër informatë në lidhje me vendosjen e kësaj ikone në desktop.

Për t'u ndihmuar juve që të mbani të organizuar dokumentet, krahas My Computer folderit, Windows XP ka vendosur edhe disa foldera të veçantë. Këtu përfshihen My Documents, My Pictures, dhe My Music. Ju mund të shikoni përmbajtjen e secilit nga këta foldera duke klikuar **Start**, dhe pastaj duke klikuar folderin që dëshironi të hapni.

## HAPJA E DRAJVAV DHE FOLLDERAV

Dy drajva të cilët përafërsisht ndodhen tek të gjithë kompjuterat janë drajvi floppy (drajvi A:) dhe disku i ngurtë (drajvi C:). Në qoftë se keni më

tepër se një drajv, atëherë ata janë të emërtuar si D:, E:, dhe kështu me rradhë. Gjithashtu, nëse keni CD drajv ose DVD drajv, atëherë edhe këta janë të emërtuar me shkronjë. Në princip, Windows XP grupon drajvat në bazë të llojit, siç është paraqitur në Figurën 5.1. Hapja e diskut të ngurtë është shumë e lehtë. Vetëm bëni klik të dyfishtë në ikonën e cila përfaqëson drajvin që ju dëshironi të hapni (shiko Figurën 5.2).



## KUJDES

Hapja e drajvit të CD/DVD Në qoftë se bëni klik të dyfishtë në ikonën e drajvit të CD ose DVD, Windows XP do të mund të startonte fajllin vetë-ekzekutues (në qoftë se është prezent) ose të fillojë së ekzekutuari këngën e parë (të audio CD). Për të parë përmbajtjen e drajvit të CD ose DVD, klikoni tastin e djathtë mbi drajvin dhe zgjedhni opcionin **Explore**.




FIGURA 5.2

*Kjo figurë paraqet përmbajtjen e drajvit të diskut të ngurtë D:. Vëreni ikonat e ndryshme për follderat dhe për fajllat.*







Secila ikonë paraqet një follder në drajvin e diskut të ngurtë të kompjuterit tuaj. Secila faqe ikonë paraqet një dokument (fajll). Pamja e faqës apo dokumentit ndryshon mvarësisht nga programi i cili përdoret

për të operuar me dokumentin. Ju mund të degëzoni follderat përmbranda follderave me qëllim të organizimit të përmbajtjes në drajvin e diskut të ngurtë të juaj. Për të hapur një follder, bëni klik të dyfishtë në ikonën e tij. Ju mund të vazhdoni me hapjen e follderave derisa të takoni fajllat dhe follderat me të cilët ju do të punoni. Për t'a mbyllur dritaren, klikoni butonin **Close**.

## NAVIGIMI I FOLLDERAVE

Secila dritare e follderit përmban shiritin e veglave, të cilët ju mund t'i përdorni për të naviguar nga folleri në follder. Ju mund të lëvizni para dhe mbrapa ndërmjet përmbajtjeve të dritareve që i keni vizituar paraprakisht. Gjithashtu, ju mund të lëvizni një nivel më lartë në strukturën e follderit deri te përmbajtja e follderit. Për shembull, ju do të mund të lëviznit deri në nivelin e desktopit e pastaj të hapni drajvat dhe follderat për të lëvizur tek tjetra degë e strukturës së follderit. Tabela 5.1 identifikon secilin buton të shiritit të veglave si dhe qëllimin e tij.

TABELA 5.1 Butonat e shiritit të veglave të dritares së Follderave

Butoni	Kliko për të...
	Ecë mbrapa në follderin e shikuar më parë.
	Kthim në follderin e shikuar më parë. Ju mund të ecni para vetëm në qoftë se keni klikuar Back për të ecur mbrapa një hap.
	Shfaq një nivel më lartë të strukturës së follderit.
	Shfaq shiritin e kërkimit për të kërkuar follderin apo fajllin. Shiko Mësimi 7, "Kërkimi i Fajllave" për më tepër informatë.
	Shfaq listën hierarkike të follderit (e ngjashme me atë të Windows Explorer nga versionet e mëparshme të Windows). Shiko paragrafin vijues, "Përdorimi i Folders Bar"
	Ndryshon mënyrën e paraqitjes së përmbajtjes së follderave. Mësimi 6, "Menagjimi i Fajllave" flet për ndryshimin e pamjes.

## PËRDORIMI I TASK PANE

Në Windows XP, My Computer gjithashtu shfaq Task Pane (Panelin e Punëve) me detyrat e zakonshme si edhe Other Places (Vendet Tjera) dhe Details Area (Hapsira e Detajeve). Për shembull, në qoftë se ju jeni duke shikuar follderat, ju do të vëreni File and Folder Tasks. Në qoftë se ju jeni duke shikuar një fajll të fotografisë, ju do të vëreni Picture Tasks. Kur ju klikoni një ikonë, ju mund të shikoni informatat në lidhje me ikonën tek Details Area.

## PËRDORIMI I FOLDERS BAR

Në qoftë se dëshironi të shikoni listën hierarkike të të gjithë follderave në sistemin e juaj dhe jo atë të Task Pane, atëherë ju mund të shfaqni Folders Bar (Shiritin e Folderave). Ju do të mund ta preferoni këtë pamje kur punoni me follderat dhe fajllat sepse ju mund të shikoni përmbajtjen si të follderit të selektuar ashtu edhe të drajvave edhe të follderave të tjerë që ndodhen në kompjuterin e juaj. Për shembull, Folders Bar e bën atë më të lehtë për t'a zhvendosur dhe kopjuar përmes tërheqjes. Kliko butonin **Folders** për të paraqitur Folders Bar (shiko Figurën 5.3).




FIGURA 5.3

*Paraqitja e Folders Bar ju bën të mundur që të shikoni të gjithë drajvat dhe follderat në kompjuterin e juaj.*

Në nivelin më të lartë ndodhet Desktopi; më poshtë tij ju do të shifni drajvat dhe follderat në desktop. Ju mund t'a zgjeroni ose mbledhni secilin nga follderat dhe drajvat në listë duke klikuar simbolin e plusit pranë drajvit apo follderit. Për shembull, kliko plusin pranë My Computer. Kur të keni klikuar simbolin e plusit për të zgjeruar follderin apo drajvin, ikona merr formën e simbolit minus. Ju mund të klikoni simbolin e minusit për të fshehur përmbajtjen e atij follderit. Për shembull, ju do të mund të fshihnit përmbajtjen e cila nuk ka të bëjë me detyrën që ju jeni duke kryer. Për të mbyllur Folders Bar, kliko butonin e follderave përsëri ose kliko butonin Close të shiritit.

## NDËRTIMI I FOLLDERIT TË RI

Gjetja, ruajta dhe hapja e dokumenteve është më e lehtë në qoftë se i keni grupuar fajllat e përbashkët në folldera. Për shembull, ju do të dëshironit të ndërtonit një follder për të gjithë dokumentet e përpunuesit të tekstit ose për çdo person i cili përdorë kompjuterin e juaj. Ndërtimi i follderit u bënë të mundur që të mbani dokumentet e juaja të ndarë nga fajllat e programit në mënyrë që të mund të gjeni më lehtë fajllat e dokumenteve të juaja.

Jumund të ndërtoni follder përbrenda secilit follder ekzistues në kompjuterin e juaj. Ndjek këta hapa:

1. Hapë follderin tek i cili dëshiron të ndërtosh një follder të ri.



### KËSHILLË

Përdorë My Documents Windows XP ka disa rrugë të shkrutëra të cilat të çojnë deri tek follderit My Documents. Megjithë këtë, ju do të dëshironit të vendosnit të gjithë follderat e dokumenteve të juaja përbrenda këtij follderit sistemor kyç.

2. Në Task Pane, kliko **Make a new folder**. Follderit i ri paraqitet në dritare dhe emri i tij është i theksuar.
3. Shkruaj emrin e ri dhe shtyp **Enter**. Follderit është ndërtuar.



## PUNA ME FOLLDERA

Ju mund të fshini, zhvendosni, riemërtoni dhe kopjoni follderat, ngjashëm siç bëni edhe me fajllat (shiko Mësimi 6). Në vijim do të jepem disa nga punët kryesore me folldera:

- Për t'a selektuar një follder, klikoje atë.
- Për t'a fshi një follder, selekto atë dhe pastaj kliko **Delete this folder** në Task Pane ose shtyp tastin **Delete** në tastierë. Kliko butonin **Yes** për të konfirmuar fshirjen.
- Për t'a kopjuar follderin dhe përmbajtjen e tij, selekto follderin dhe pastaj kliko **Copy this folder**. Në kutinë e dialogut të Copy Items, selekto follderin ku dëshiron të vendosësh kopjen (shiko Figurën 5.4). Ju mund të zgjeroni çdo njërin nga drajvat ose follderat duke klikuar simbolin e plusit pranë ikonës. Kliko **Copy**.




FIGURA 5.4

*Për të kopjuar një follder dhe përmbajtjen e tij, selekto drajvin ose follderin ku do t'a vendosësh kopjen.*

- Zhvendosja e follderit është e ngjashme me kopjimin, vetëm që kur ju zhvendosni follderin origjinali fshihet dhe vetëm i zhvendosuri mbetet (dhe përmbajtja e tij). Selektto follderin, kliko **Move this folder** dhe pastaj selekto drajvin ose follderin ku do t'a vendosësh follderin. Kutia e dialogut që paraqitet është e

ngjashme me kutinë e dialogut të Copy Items, por kjo është për zhvendosje. Kliko butonin **Move**.

- Për t'a riemërtuar follderin, selekto follderin dhe pastaj kliko lidhjen **Rename this folder**. Emri aktual është i selektuar. Shkruaj emrin e ri dhe kliko **Enter**.

Në këtë mësim ju keni mësuar si të shfaqni dhe punoni me follderat në sistemin e juaj. Kalo në Mësimi 6 për ndihmë në lidhje me punën me fajllat e ruajtur në follderat e kompjuterit të juaj.

## MËSIMI 6

# Menagjimi i Fajllave



*Në këtë mësim ju do të mësoni të punoni me fajllat në kompjuterin e juaj: si selektimin, kopjimin, fshirjen, zhvendosjen dhe kështu me rradhë.*

### SHFAQJA DHE SELEKTIMI I FAJLLAVE

Kur ju e ruani një punë të juajën nga programi në të cilin po punoni, ajo e dhënë është e ruajtur si fajll në drajvin dhe follderin e selektuar nga ju. Ju punoni shpeshë me këta fajlla. Do të dëshironit ndonjëherë të kopjoni fajllin ose zhvendosni atë në ndonjë follder tjetër. Do të dëshironit të krijoni ikonë me çasje të shpejtë të fajllit. Për t'a startuar, ju do të hapni drajvin dhe follderin ku fajlli është i ruajtur (siç është paraqitur në Mësimi 5, "Përdorimi i My Computer për të Organizuar Follderat e Juaj").

Pasi t'i shfaqni fajllat ju do të dëshironit të punoni me t'a, selektoni fajllin apo fajllat. Ju mund të selektoni një fajll të vetëm apo disa. Për shembull, ju do të dëshironit të fshini një grup fajllash.

Për të selektuar një fajll ose disa fajlla, bëni njërën nga vijueset:

- Për të selektuar një fajll të vetëm, klikoni atë.
- Për të selektuar disa fajlla njërin pran tjetrit, kliko fajllin e parë të grupit që ju dëshironi t'a selektoni, mbaje të shtypur tastin **Shift**, dhe pastaj kliko fajllin e fundit. Fajlli i parë dhe i fundit dhe të gjithë fajllatë ndërmjet tyre janë të selektuar.
- Për të selektuar disa fajlla të cilët nuk ndodhen njëri pran tjetrit, mbaje të shtypur tastin **Ctrl** dhe kliko çdo fajll që dëshiron të selektosh.
- Për të selektuar të gjithë fajllat, kliko menyunë **Edit**, dhe pastaj kliko komandën **Select All** (ose shtyp kombinimin e tastave **Ctrl+A**).

- Për të deselektuar një fajll apo grup të fajllave, kliko jashtë listës së fajllave. Për të deselektuar një fajll të vetëm në një grup, duke mbajtur të shtypur tastin Ctrl kliko fajllin.

## FSHIRJA E FAJLLIT

Përfundimisht, kompjuteri juaj mbushet përplot me fajlla dhe juve u paraqet vështirësi të madhe organizimi dhe ruajtja e tyre. Ju mund të fshini secilin fajll i cili më nuk u nevojitet.

Windows XP në fakt nuk e fshin fajllin; në vend të kësaj, ai e zhvendos fajllin në Recycle Bin. Në qoftë se paraqitet nevoja, atëherë ju mund t'a ktheni në vend fajllin nga Recycle Bin.

Ndjek këta hapa për t'a fshier fajllin:

1. Selektu fajllin(at) që dëshiron t'a(i) fshiesh. Vëreni që Task Pane shfaq punë të përafërta që kanë të bëjnë me fajllin(at) (shiko Figurën 6.1).




FIGURA 6.1

*Kur ju selektoni një fajllë, Windows XP shfaq punët në Task Pane që kanë të bëjnë me fajllat.*

2. Kliko **Delete this file**.
3. Kliko **Yes** që të konfirmosh fshirjen. Windows rizhvendos fajllin(at), duke i vendosur atë(ata) në Recycle Bin.

## KËSHILLË

Shiko Detajet e Fajllit Kur ju selektoni një fajll të vetëm, ju mund të shikoni detajet në lidhje me atë fajll në Task Pane. Në qoftë se sipërfaqja për Detaje nuk është shfaqur, kliko shigjetën me kokë teposhtë pranë titullit. Në qoftë se ju keni selektuar disa fajlla, kjo sipërfaqe shfaq numrin e fajllave të selektuar si edhe totalin e madhësisë së fajllave.

## KTHIMI I FAJLLIT TË FSHIRË

Ndodhë që të keni fshirë fajllin apo follderin gabimisht. Po që se ke bërë gabim, atëherë ri-gjeje fajllin ose follderin në Recycle Bin (për derisa Recycle Bin nuk është zbrazur) dhe kërthe fajllin në lokacionin e tij original.

Për t'a kërthyer një fajll të fshirë, ndjek këta hapa:


1. Bënë klikë të dyfishtë mbi ikonën **Recycle Bin** në desktopin e juaj. Ju shikoni përmbajtjen e Recycle Bin, përfshi këtu të gjithë follderat, ikonat, ose fajllat që ju i keni fshirë (shiko Figurën 6.2).

## KUJDES

Nuk mund t'a hapi Fajllin Ju nuk mund t'i hapni fajllat nga Recycle Bin. Ju mundeni vetëm t'i ktheni fajllat në lokacionet e tyre të më parshme, t'i zhvendosni në ndonjë drajvë ose follder tjetër, ose t'i shlyeni ato përgjithmonë.

## KËSHILLË

Kthimi i Follderit të Fshirë Ndjek këta të njëjtë hapa që të ktheshë një follder të fshirë dhe përmbajen e tij. Selektu follderin, dhe pastaj kliko **Restore this item**.



Kliko këtë ikonë dy herë që të hapet Recycle Bin

FIGURA 6.2

*Recycle Bin përmban secilin fajll apo follder që juve e keni fshirë.*

2. Selektu fajllin e fshirë që dëshiron t'a ktheshë.
3. Kliko **Restore this item** në Task Pane. Fajlli është zhvendosur nga Recycle Bin mbrapa në lokacionin origjinal të tij.
4. Kliko butonin **Close** për t'a mbyllur Recycle Bin.

Edhe pse ju nuk mund t'i shihni ata në My Computer ose File Explorer, përmbajtja e Recycle Bin okupon hapsirë të diskut të ngurtë, kështu që në mënyrë periodike ju duhet t'a zbrazni atë. Sigurohu që fajllat në Recycle Bin nuk përmbajnë dicka që u nevojitet. Kujto Ligjin e Murphy-it. Ndoshta ju do të keni nevojë për fajllin që në momentin e fshirjes së tij!

Pasi të keni kontrolluar përmbajtjen, ju mund t'i fshini përgjithmonë përmbajtjet përmes zbrazjes së Recycle Bin. Bëj klik të dyfishtë mbi ikonën **Recycle Bin**. Pastaj kliko në Task Pane, **Empty Recycle Bin**. Windows shfaq kutinë e dialogut të Confirm Multiple File Delete; kliko **Yes** për të zbrazur Recycle Bin.

## RIEMËRTIMI I FAJLLIT

Në qoftë se nuk keni përdorur një emër përkthues, gjatë kohës kur ju e keni ruajtur fajllin ose në qoftë se emri aktual nuk e përkthuan sa duhet përmbajtjen e fajllit, ju keni mundsinë e riemërtimit të tij. Ju mund të riemërtoni vetëm një fajll mbrenda një intervali kohor. Ndjek këta hapa:

1. Selektu fajllin që dëshiron t'a riemërtosh.
2. Kliko **Rename this file** në panelin e Detyrave. Emri aktual është theksuar.
3. Shkruaj emrin e ri dhe shtyp **Enter**. Fajlli është riemërtuar.

## KOPJIMI I FAJLLIT

Windows e bënë të lehtë kopjimin e fajllit nga një folder në folderin tjetër si dhe nga një disk në tjetrin. Ju mund të kopjoni fajllat që të krijoni një kopje rezervë ose të përdorni një kopje për punë dhe origjinalin t'a leni të paprekur. Ndjekë këta hapa që të kopjosh fajllin:

1. Selektu fajllin(fajllat) që dëshiron t'i kopjosh.
2. Kliko **Copy this file** në Task Pane. Do të vëreni kutinë e dialogut Copy Items (shiko Figurën 6.3).





FIGURA 6.3

*Në këtë kuti dialogu, zgjeroni listën e drajvit apo folderit përderisa të shifni folderin e dëshiruar. Pastaj kliko folderin për t'a selektuar atë.*

3. Shfaqe dhe pastaj kliko follderin tek i cili ju dëshironi të vendosni fajllin. Ju mund të zgjeroni listën e follderit duke klikuar simbolin e plusit pranë ikonës, drajvit ose follderit.
4. Kliko butonin **Copy**. Windows kopjon fajllat tek lokacioni i ri.



## KËSHILLË

Kopjimi në Flopi Disk Ju do të dëshironit të kopjoni fajllin në flopi disk, për t'a marrë me vehte fajllin ose për të bërë kopje rezervë. Windows ofron çasjen e shpejtë (komandën Send To) për kopjimin e fajllit në flopi disk. Inserto flopi diskun në flopi drajv, dhe pastaj selekto fajllin (fajllat) për të kopjuar. Kliko me tastin e djathtë mbi fajllin(at) dhe selekto komandën Send To nga menya me çasje të shpejtë. Kliko flopi drajvin. Fajllat janë kopjuar.

## ZHVENDOSJA E FAJLLIT

Do të paraqitet nevoja që të zhvendosni fajllat nga një follder apo drajvë në një tjetër (për shembull, për të riorganizuar follderat vendosim bashkarisht fajlla të ngjashëm në një follder të njejtë). Gjithashtu, ju mund të zhvendosni fajllin të cilin gabimisht e keni ruajtur në një follder tjetër. Zhvendosja është përafërsisht e ngjashme me kopjimin. Ndjek këta hapa:

1. Selektto fajllin (fajllat) që dëshiron t'a zhvendosësh.
2. Kliko **Move this file** në Task Pane. Ju shifni kutinë e dialogut Move Items që është e ngjashme me kutinë e dialogut Copy Items e paraqitur në Figurën 6.3.
3. Shfaq dhe pastaj kliko follderin tek i cili dëshiron të vendosësh fajllin. Mund të zgjerosh listën e follderit duke klikuar simbolin e plusit pranë ikonës, drajvit ose follderit.
4. Kliko butonin **Move**. Windows zhvendos fajllat në lokacion të ri.

Në këtë mësim ju mësuat punët kyçe të manipulimit të fajllave. Në mësimin e ardhshëm ju do të mësoni se si t'i gjeni fajllat që gabimisht i keni vendosur në lokacione jo të duhura.



# MËSIMI 7

## Gjetja e Fajllave



*Në këtë mësim ju do të mësoni disa mënyra të ndryshme të gjetjes së fajllave, të cilët i keni vendosur gabimisht në lokacione jo të duhura në kompjuterin e juaj.*

### PAMJA DHE SORTIMI I FAJLLAV

Të ruash fajllin dhe të mos mund t'a gjesh atë përsëri është punë shumë e zakonshme. Ose nuk e keni ruajtur fajllin në lokacionin ku keni menduar t'a ruani, ose nuk u kujtohet se në cilin follder e keni ruajtur. Nganjëherë, nuk u kujtohet emri i saktë i fajllit. Një mënyrë për t'a gjetur fajllin është të ndryshoni pamjen e paraqitjes së fajllave në dritaren e follderit. Ju mund të shifni përmbajtjen e dritares në disa mënyra. Gjithashtu, ju mund të sortoni përmbajtjen ashtu që fajllat të jenë të renditur sipas alfabetit, sipas datës, ose sipas llojit. Komanda e re në Microsoft Windows XP bënë të mundur grupimin e fajllave të të njëjtit lloj së bashku.

### NDRYSHIMI I PAMJES

Në qoftë se ju dëshironi të shifni më shumë nga përmbajtja e dritares, atëherë ju mund t'a ndryshoni pamjen duke e kthyer atë në pamjen List. Një alternativë tjetër, është kalimi në pamjen Details për të parë më tepër informacion të detajuar në lidhje me përmbajtjen (madhësinë, emrin, llojin ose datën e modifikimit). Gjithashtu, ju mund të selektoni opcionin Thumbnails, i dobishëm për fotografitë ose Tiles i cili paraqet ikonën së bashku me informatën mbi fajllin. Duke bërë ndryshimet e pamjes me anë të të cilave dritarja shfaq përmbajtjen e vetë, e bën më të lehtë gjetjen e fajllave.

Për të kaluar në pamje tjetër, ndjek këta hapa:

1. Në dritaren tek e cila dëshiron të bësh ndryshimin e pamjes, kliko menynë **View** ose kliko shigjetën me kokë te poshtë pranë

butonit Views .

2. Selektu pamjen që të intereson. Dritarja shfaq përmbajtjen në atë pamje. Figurat 7.1 dhe 7.2 paraqesin përmbajtjet në pamjen Tiles, respektivisht në pamjen List.




FIGURA 7.1

*Pamje e paradefinuar për shumicën e dritareve është pamja Tiles. Kjo pamje paraqet një informacion bazë të fajllave.*

## SORTIMI I FAJLLAVE

Bëje sortimin e përmbajtjes së dritares së follderit ashtu që më lehtë të mund të gjeni follderat dhe fajllat që ju nevojiten. Windows u mundson që të bëni radhitjen e përmbajtjes së dritares në bazë të emrit, llojit, datës dhe madhësisë. Të gjitha pamjet e paraqesin sortimin, por më e dallueshme është në pamjen Details, sepse kjo pamje përmban kolonat për madhësinë, datën dhe llojin.

Ndjek këta hapa për të sortuar fajllat:

1. Hapë dritaren përmbajtjen e të cilës dëshiron t'a sortosh.
2. Kliko **View**, dhe pastaj kliko komandën **Arrange Icons By**.
3. Selektu llojin e sortimit që dëshiron t'a aplikosh. Windows sorton fajllat në rendin e selektuar. Për shembull, Figura 7.3 paraqet fajllat e sortuar siaps datës së modifikimit. Vëreni se kolona tek e cila është aplikuar sortimi përmban një hijëzim të zbehtë ashtu si edhe ikonën në titull.




FIGURA 7.2

*Pamja List bënë më të lehtë menyrën e selektimit të një grupi të fajllave sepse ata janë të listuar në rradhë. Gjithashtu pamja List okupon më pak hapësirë për listimin e fajllave.*




FIGURA 7.3

*Ju mund të sortoni fajllat me qëllim të gjetjes sa më të lehtë të fajllave që u nevojiten.*

## GRUPIMI I FAJLLAVE

Diçka e re në Windows XP është edhe mundësia e grupimit të ikonave të fajllave. Grupimi mvaret nga menyra se si janë sortuar fajllat. Në qoftë se juve e keni bërë sortimin në bazë të emrit, atëherë përmbajtja do të grupohet në bazë të alfabetit. Në qoftë se ju sortoni në bazë të llojit, atëherë përmbajtja do të grupohet në bazë të llojit. Për këtë arsye, së pari sortoni e pastaj bëni grupimin. Ju mund të bëni grupimin në secilën pamje.

Ndjek këta hapa për të grupuar fajllat:

1. Sorto përmbajtjen në bazë të asaj se si dëshiron t'i gruposh ata. Për shembull, për t'i grupuar në bazë të llojit, atëherë sorto në bazë të llojit.
2. Kliko **View, Arrange Icons By, Show in Groups**. Windows i grupon ikonat në bazë të rradhës së sortimit. Figura 7.4 paraqet fajllat e sortuar, dhe pastaj të grupuar sipas llojit.




FIGURA 7.4

*Ju mund t'i gruponi fajllat me qëllim që të mbani fajllat e llojit të të njëjtë së bashku.*



## KËSHILLË

Shiko Informatën e Fajllit Një ndihmesë tjetër për të gjetur fajllin është të shikohen detajet ose vetitë e fajllit. Selektu fajllin dhe pastaj zgjero sipërfaqen e Details në Task Pane duke klikuar shigjetën me kokë poshtë pranë atij titulli. Ju shifni informatën e fajllit. Për të shfaqur vetitë, kliko me tastin e djathtë mbi fajllin, dhe pastaj selektu Properties. Disa fajlla mund të kenë disa tabulator për të identifikuar informatën. Kur të keni mbaruar rishikimin e vetive të fajllit, kliko **OK**.

## KËRKIMI I DOKUMENTEVE

Në qoftë se e keni ruajtur dokumentin, por nuk mund të gjeni lokacionin e tij as përmes hapjes së follderave ekzistues, ju keni mundsinë e kërkimit të tij. Ju mund të kërkoni lloje të ndryshme të fajllave. Nga rezultatet e kërkimit ju mund t'i hapni, t'i shtypni, t'i kopjoni, ose t'i zhvendosni fajllat.

Ndjek këta hapa për të bërë kërkimin e fajllit:

1. Kliko butonin **Start**, dhe pastaj kliko komandën **Search**.
2. Selektu llojin e fajllit të cilin dëshiron t'a gjesh. Ju mund t'i kërkoni fajllat muzikorë, fotografitë, video, dokumentet (përpunuesit e tekstit, tabelat, dhe të tjerë), ose të gjithë fajllat dhe follderat.



## KËSHILLË

Hulumto Internetin Gjithashtu, ju mund të përdorni komandën Search për të kërkuar Internetin ose për të kërkuar informata në lidhje me adresat ose e-mailat e njerëzëve. Shiko Mësimi 10, "Shfletimi i Internetit" për më tepër informatë.

3. Shkruaj kriterin e kërkimit. Opcionet që ndodhen në dispozicion ndryshojnë varësisht nga ajo që keni selektuar për të kërkuar. Figura 7.5 paraqet kërkimin e dokumentit. Ju mund të specifikoni herën e fundit që fajlli është ndryshuar dhe/ose shkruani komplet ose vetëm një pjesë të emërit të fajllit.




FIGURA 7.5

Për të kërkuar, shkruaj kriterin e kërkimit që juve mendoni se do t'i ndihmoj Windows XP të gjej ekuivalentin.

## KËSHILLË

Kufizo Kërkimin Për të përdorur kriter plotësues të kërkimit kliko lidhjen Use advanced search options. Pastaj, do të mund të kufizoni kërkimin në vetëm një drayv ose folder të veçantë duke përdorur Look in drop-down list. Gjithashtu, ju mund të kërkoni një fjalë apo frazë të vetme në dokument.

4. Kliko butonin **Search**. Windows fillon kërkimin dhe pas nje kohe shfaq rezultatet e gjetura në formë të listës në panelin e djathtë të dritares (shiko Figurën 7.6). Për të hapur ndonjërin nga folderat apo fajllat mjaftonë të bëni klikë të dyfishtë mbi ta.

## KËSHILLË

Kërko Përsëri Shiriti i kërkimit tregon numrin e fajllave të gjetur, poashtu edhe opcionet për rafinimin e kërkimit. Në qoftë se rezultatet nuk japin fajllin e kërkuar, kërko përsëri.



FIGURA 7.6

*Rezultatet e kërkimit janë shfaqur në panelin e djathtë të dritares Search Results. Secilin nga fajllat e listuar ju mund t'a hapni, zhvendosni, kopjoni apo edhe t'a fshini.*

5. Për të mbyllur dritaren e kërkimit, kliko butonin **Close** të saj.

Në këtë mësim ju mësuat për shumë vegla që ju do të mund t'i përdorni për të përcaktuar lokacionin e fajllit i cili ka qenë vendosur gabimisht. Mësimi i ardhshëm do të shpjegon shtypjen e fajllave në shtyp.



## MËSIMI 8

# Shtypja e Dokumentit

*Në këtë mësim ju do të mësoni se si të bëni konfigurimin e shtypsit, vendosjen e preferencave, si dhe të shtypni një dokument.*

### ISTALIMI I SHTYPSIT

Në të shumtën e rasteve, Microsoft Windows XP në mënyrë automatike e konfiguron shtypsin e juaj pasi juve të keni lidhur atë për kompjuterin. Pasi të keni lidhur shtypsin, Windows XP icon procesin dhe u'a bënë me dije se shtypsi është gjetur dhe instaluar, përmes mesazheve që shfaqen nga System Tray.

Në qoftë se auto-konfigurimi nuk ecë për disa arsye, ju mund të shtoni shtypsin e ri tek Windows XP duke përdorur udhëzuesin hap-pas-hapi të quajtur **wizard**. Kjo mund të ndodhë në qoftë se ju keni një shtypsi i cili akoma nuk është shtuar tek lista e drajverave të shtypsave të Windows XP ose ndonjë shtypsi shumë i vjetër të cilin Windows nuk e njeh.



### KËSHILLË

Wizard      Një veçori e cila ju drejton hap-pas-hapi përgjat procesit të veçantë. Për shembull, the Add Printer Wizard ju ndihmon që të shtoni një shtypsi të ri në konfigurimin e juaj. Gjithashtu, do të takoni wizarda të tjerë si për konfigurimin e fax-it, e-mail-it, programeve si dhe veçorive të tjera.

Ndjek këta hapa për të bërë konfigurimin e shtypsit të ri duke përdorur Add Printer Wizard:

1. Kliko **Start** dhe pastaj kliko **Control Panel**.
2. Kliko **Printers and Other Hardware**.



3. Kliko **Add a printer** për të startuar Add Printer Wizard (shiko Figurën 8.1).




FIGURA 8.1

Përdorë Printers and Other Hardware Control Panel për të instaluar një shtypës të ri.

## KËSHILLË

Zgjidh Problemet e Shtypsit Në qoftë se keni probleme me shtypsin e juaj, klikoni **Printing** në sipërfaqen Troubleshooters në panelin e detyrave. Kjo e starton Windows XP Troubleshooter i cili kërkon nga ju që të identifikoni problemin dhe pastaj të zgjedhni variantin e mundshëm.

4. Kompletë çdo hap në wizard, kliko **Next** për të ecur nga hapi në hap. Do të kërkohet nga ju që të selektoni llojin e shtypsit (lokal ose i rrjetit), detektimin automatik apo konfigurimin manual, portin tek i cili shtypsi është lidhur, prodhuesin e shtypsit dhe emrin e shtypsit, opcionet për ndarjen e shtypsit, si dhe a doni të printoni faqen testuese. Hapi përfundimtar i wizard liston të gjitha selektimet e juaja (shiko Figurën 8.2).

5. Kliko **Finish** për të përfunduar konfigurimin e shtypsit. Shtypsi është konfiguruar dhe është shtuar në Windows XP.




FIGURA 8.2

*Kur ju të përfundoni të gjitha përgjigjet në wizard, të gjitha selektimet e juaja janë listuar.*

## KËSHILLË

Përdor Diskun e Shtypsit Në qoftë se keni diskun e shtypsit me fajllin e drajverit të shtypsit (fajll i cili i tregon Windows detajet e shtypsit të veçantë), kliko **Have Disk** në faqen e Wizard Install Printer Software, inserto diskun, dhe pastaj selekto drajverin për të kërkuar fajllin.

## KËSHILLË

Ecë Mbrapa Një Hap Kliko butonin **Back** në kutinë e dialogut të wizard për t'u kthyer mbrapa në kutinë paraprake të dialogut dhe rishiko ose modifiko selektimet tuaja.

## VENDOSJA E PARAMETRAVE DHE PREFERENCAVE TË SHYTPJES

Në qoftë se dëshiron të modifikosh parametrat e shtypsit, fillo përmes hapjes së **Printers and Faxes Control Panel**. Ju pastaj mund të shikoni dhe modifikoni preferencat dhe parametrat për secilin shtyp. Gjithashtu, ju

mund të çasni rradhën e shtypjes për t'a pauzuar, ristartuar, ose anuluar punën e shtypjes. Preferencat e shtypjes janë parametrat si përcaktimi i renditjes në të cilën janë shtypur faqet (nga fillimi e deri në fund të dokumentit, ose nga fundi në fillim të dokumentit), orientimi (portret ose pejsazh), si dhe burimi i letrës. Në qoftë se ju gjithnjë shtypni në një mënyrë të përcaktuar, ju mund t'i ndryshoni këta parametra.

### TË SHIKUARIT E SHTYPSAVE TË INSTALUAR

Për të bërë çfarëdo ndryshimi, ju së pari duhet të shfaqni ikonën e shtypsit. Ndjek këta hapa:

1. Kliko butonin **Start**, dhe pastaj zgjedh **Control Panel**.
2. Kliko kategorin **Printers and Other Hardware**.
3. Kliko ikonën **Printers and Faxes Control Panel**. Ju shifni listën e të gjithë shtypsave dhe faksave të instaluar (shiko Figurën 8.3).



FIGURE 8.3

*Ju mund t'i shifni shtypsat e instaluar kur juve dëshironi të modifikoni parametrat ose të shikoni rradhën e printimit.*



## KËSHILLË

Shtypësi i Definuar Paraprakisht      Shtypsi i definuar paraprakishtë paraqitet me një simbol të zgjedhjes. Për të selektuar një printer tjetër si shtypës të paradefinuar, klikoni me tastin e djathtë ikonën e atij shtypësi dhe selekto **Set as Default Printer**.

### NDRYSHIMI I PREFERENCAVE TË SHTYPSIT

Ndryshimi i preferencave të shtypsit do të thotë ndryshim për të gjithë dokumentet që do të shtypen në këtë printer. Në qoftë se ju dëshironi t'i ndryshoni preferencat për vetëm një dokument, atëherë bëj ndryshimet vetëm në atë dokument. Për t'i ndryshuar preferencat e shtypjes për të gjitha punët e shtypsit, ndjek këta hapa:

1. Shfaq ikonën e shtypsit. Shiko paragrafin paraprak “Të Shikuarit e Shtypsave të Instaluar”.
2. Selektto shtypsin tek i cili dëshiron të ndryshosh preferencat.
3. Kliko **Select printing preferences** në Task Pane. Do të shifni kutinë e dialogut Printing Preferences (shiko Figurën 8.4).




FIGURA 8.4

*Përdorë opcionet në kutinë e dialogut për të kontrolluar orientimin, rregullin e faqës si dhe burimin e letrës për të gjitha punët e shtypjes me këtë shtyp.*


4. Në tabulatorin Layout, selekto orintimin e paradefinuar dhe rregullin e letrës të paradefinuar.
5. Kliko tabulatorin **Paper/Quality**. Selekto burimin e letrës të paradefinuar.
6. Kliko **OK**.

Përveç ndryshimit të preferencave, ju gjithashtu mund t'i shikoni dhe ndryshoni edhe parametrat e shtypsit. Këto kanë të bëjnë më shumë me detajet teknike se si punon shtypsi i juaj. Për shembull, kur shtypsi është aktiv, porti për të cilin shtypsi është i kyçur, pamvarësisht se a është aktiv opcioni i ndarjes së shtypsit si dhe opcionet tjera. Pë t'i bërë këto ndryshime, selekto shtypsin dhe pastaj kliko **Set printer preferences** në Task Pane. Bëj ndryshime në secilin nga tabulatorët dhe pastaj kliko **OK**.

## SHTYPJA E DOKUMENTIT

Të shtypsh dokumente do të thotë të bësh një kopje në letër, të cilën do të mundesh t'a përdorësh në raport, t'ua japësh bashkpuntorëve dhe kështu me rradhë. Opcioni për shtypje ndryshon nga programi në program, por hapat kryesorë janë të njëjtë.

### KËSHILLË



ParaPamja Shumica e programeve u mundsojnë që të bëni parapamjen e dokumentit në mënyrë që t'i kontrolloni marzhinat, titujt, vendet e grafiqeve, dhe të tjera gjëra para se të filloni t'a shtypni atë. Parapamja u kursen kohë dhe letër, sepse ju do të mund të bëni çfardo ndryshimi para se t'a shtypni. Kliko **File** dhe pastaj selekto komandën **Print Preview**. Kur të mbaroni së shikuari Parapamjen, kliko butonin **Close**.

Për të shtypur dokumentin, ndjek këta hapa:

1. Kliko **File**, dhe pastaj kliko komandën **Print**. Në formë të ikonës me çasje të shpejtë, kërko butonin Print në shiritin e veglave të programit ose përdorë tastin me çasje të shpejtë (zakonisht Control + P). Në qoftë se e përdorni komandën, ju e shifni kutinë e dialogut të shtypjes të paraqitur në Figurën 8.5. Në qoftë se e përdorni butonin Print ose kombinimet e tasteve me çasje të shpejtë, dokumenti do të shtypet në shtypsin e paradefinuar nga sistemi, pa e shfaqur fare kutinë e dialogut.

2. Bëj ndryshime të çfardoshme në opcionet e shtypsit. Shumica e programeve mundsojnë që të selektohet shtypsi, të selektohet se çfarë është shtypur (për shembull një rang i veçantë i letrës, si dhe të selektohet numri i kopjeve për t'u shtypur. Vëreni se opcionet aktive dallojnë nga programi në program.
3. Kliko butonin **OK**. Dokumenti është shtypur.




FIGURA 8.5

*Kjo figurë paraqet kutinë e dialogut të Microsoft Word-it. Varësishtë nga programi që shtypni, mundeni edhe të vëreni ndryshime të mëdha.*

## TË SHIKUARIT DHE ANULIMI I PUNËVE TË SHTYPSIT

Rradha e shtypjes liston dokumentet që janë dërguar në shtyp dhe pastaj i shfaq ato ashtu si po ecën puna e shtypjes. Duke përdorur rradhën e shtypjes, ju mund të përdorni: pauzimin, ristartimin, ose anulimin e punës së shtypsit. Për shembull, ju duhet që të pauzoni shtypjen, ashtu që t'a ndrroni letrën. Ju do të mund t'a anuloni një punë të shtypsit që e keni filluar gabimisht.

Ndjek këta hapa për të bërë ndryshime tek një punë e shtypsit që është në progres:

1. Shfaq ikonën e shtypsit. Shiko paragrafin “Të Shikuarit e Shtypsave të Instaluar” më sipër në këtë mësim.

2. Selektto shtypsin që dëshironi t'a shikoni dhe kliko opcionin **See what's printing** nga Task Pane. Do të shfaqet rradha e shtypjes (shiko Figurën 8.6). Gjithashtu, do të mund të shfaqni rradhën e shtypjes duke klikuar dy herë ikonën e shtypsit në System Tray të Taskbar (në pjesën më të djathtë). Ikona e shtypsit do të paraqitet sa herë që ju shtypni ndonjë dokument.

Klikoni dy herë këtë ikonë të shtypsit për të hapur rradhën e shtypjes




FIGURA 8.6

*Përdorë rradhën e shtypjes për të paузuar, ristartuar ose anuluar punën e shtypsit*

## KUJDES

**Radha e Shtypjes e Zbrazët** Në qoftë se dritarja e radhës së shtypjes është e zbrazët, atëherë ose puna që do duhej të shtypej nuk ka arritë fare deri ke rradha ose tashmë është procesuar nga shtypsi. Punët e shkruatra të shtypsit zakonisht shtypen shumë shpejt, me çka ju nuk do keni kohë të mjaftueshme për t'a ndalur punën e shtypjes.

3. Bëj një rën nga vijueset:

Për t'i anuluar të gjitha punët e shtypsit, kliko **Printer** dhe pastaj kliko komandën **Cancel All Documents**. Kliko **Yes** për të konfirmuar anulimin.

Për të pauzuar shtypjen, kliko **Printer** dhe pastaj kliko **Pause Printing**. Për t'a ristartuar pas pauzimit, kliko **Printer** dhe pastaj kliko përsëri **Pause Printing**.

Për t'a anuluar, pauzuar, rikompletuar ose ristartuar një punë të veçantë, kliko punën e shtypsit në listë. Pastaj kliko **Document** dhe selekto komandën adekuate (**Pause**, **Resume**, **Restart** ose **Cancel**).

4. Kliko butonin **Close** për t'a mbyllur rradhën.

Në këtë mësim ju mësuat si të punoni me shtypsin. Mësimi i ardhshëm shpjegon përdorimin e Outlook Express, një program i postës elektronike i përfshirë në Windows XP.



## MËSIMI 9

# Dërgimi i e-mailit



*Në këtë mësim ju do të mësoni se si të përdorni Outlook Express, një program për postë elektronike i përfshirë në Windows XP, për të dërguar dhe pranuar mesazhe elektronike (apo e-mail).*

### KONFIGURIMI I LLOGARIS SË JUAJ TË E-MAILIT

Para se të përdorni Outlook Express, ju duhet të bëni konfigurimin e lidhjes së juaj me Internet dhe të llogarisë së e-mailit. Pasi të keni konfiguruar llogarinë e e-mailit, ju mund të përdorni Outlook Express për të shkruar, dërguar dhe pranuar e-mail përmes Internetit.

Kur e startoni për herë të parë Outlook Express nga ju do të kërkohet që të konfiguroni llogarin e juaj të e-mailit. Ju duhet të keni në dispozicion të gjithë informacionin nga furnizuesi i juaj me Internet dhe e-mail, përfshirë këtu username, e-mail adresën, password, si dhe informacionin teknik siç është **incoming mail server name** (i quajtur POP3, IMAP, ose serveri HTTP) si dhe **outgoing mail server** (i quajtur serveri SMTP). Në qoftë se juve keni probleme ose pyetje në lidhje me këtë informacion, kontaktoni Internet Service Provider të juaj (shpesh i referuar si ISP i juaj).

### KËSHILLË

Shtoni Llogari të Tjera      Në qoftë se juve keni më shumë se një llogari të e-mailit, ju mund t'i konfiguroni që të gjitha këto llogari në Outlook Express dhe nga këtu t'i kontrolloni. Kliko **Tools**, dhe pastaj kliko komandën **Accounts**. Çdo llogari ekzistuese do të listohet. Kliko butonin **Add** dhe selekto **Mail** që të startosh Internet Connection Wizard. Ndjek të njëjtat hapa si për konfigurimin e llogarisë së parë, duke e shkruar username, password, dhe kështu me rradhë.

## KONTROLLIMI I E-MAILIT

Pasi llogari e juaj e e-mailit të jetë konfiguruar, ju mund të startoni Outlook Express dhe të kontrolloni e-mailin e juaj. Ndjek këta hapa:

1. Kliko **Start**, dhe pastaj kliko **E-mail** (Outlook Express).
2. Në qoftë se kërkohet, atëherë lidhuni tek Internet Service Provider i juaj. Outlook Express starton dhe kontrollon serverin e juaj të e-mailit për ndonjë mesazh. Mesazhet pastaj ç'ngarkohen në Outlook Express. Numri i mesazheve të reja paraqitet në kllapa pranë Inboxit në listën e Folderit. Paneli i kokës së mesazhit liston të gjitha mesazhet. Mesazhet në **bold** akoma nuk janë lexuar. Ju mund të hapni dhe lexoni secilin mesazh në listën e mesazheve (shiko Figurën 9.1).

Lista e Folderit

Paneli i kokës së mesazhit




FIGURA 9.1

*Starto Outlook Express, dhe pastaj kontrollo Inboxin tënd për mesazhe të reja.*

3. Në se e nevojshme, atëherë selekto Inbox në listën e Folderit të Outlook Express.
4. Bën klik të dyfishtë mbi mesazhin që dëshiron t'a lexosh.

Mesazhi i selektuar do të shfaqet në dritaren e vetë (shiko Figurën 9.2). Ju mund të shfaqni gjithashtu mesazhin paraprak apo të ardhshëm përmes butonave Previous dhe Next në shiritin e veglave. Për t'a mbyllur mesazhin, kliko butonin **Close**.

## KËSHILLË

Ndrysho të Paradefinuarën Si e paradefinuar, Outlook Express shfaq Outlook Today, një pasqyrë e e-mailit, newsgroups, dhe kontakteve. Për të shkuar direkt në Inboxin e juaj kur të hapni Outlook Express, zgjedh(kliko katrotin tek opcioni) **When Outlook Express starts, go directly to my Inbox** në dritaren e Outlook Express.




FIGURA 9.2

*Ju mund të hapni dhe rishikoni secilin nga mesazhet që ju pranoni. Përdorë butonat nga shiriti i veglave për të shfaqur mesazhet tjera.*

## KTHIMI I MESAZHIT

Ju shumë lehtë mund t'i përgjigjeni mesazheve që i keni pranuar. Outlook Express mbush për ju rreshtat e adresës dhe të titullit gjithashtu duke përfshirë këtu edhe tekstin origjinal të mesazhit të pranuar. Pastaj ju mund të shkruani përgjigjen e juaj. Ju mund t'i përgjigjeni vetëm dërguesit origjinal ose t'i përgjigjeni edhe dërguesit origjinal

e edhe pranuesve të tjerë (secilit të listuar në fushën Cc: të mesazhit). Gjithashtu ju keni mundsinë e përcjelljes së mesazhit deri tek ndokush tjetër.

Për t'iu përgjigjur një mesazhi që ju e keni pranuar, ndjek këta hapa:


1. Shfaq mesazhin të cilit dëshiron t'i përgjigjesh.
2. Bënë një nga vijueset:

Për t'iu përgjigjur vetëm dërguesit, kliko butonin **Reply**  në shiritin e veglave.

Për t'iu përgjigjur dërguesit si dhe pranuesve të tjerë, kliko **Reply**

**All** .

Për të përcjellur një mesazh deri tek një tjetër pranues, kliko

**Forward** . Pastaj shkruaj adresën e e-mailit të atij personi. Rreshti i adresës dhe i **subject** janë të mbushur si dhe teksti i mesazhit origjinal është i shtuar në pjesën e poshtme të mesazhit përgjigjës (shih Figurën 9.3).




FIGURA 9.3

Ju mund t'i përgjigjeni mesazhit duke shkruar një përgjigje, dhe pastaj t'a dërgoni mesazhin.

3. Shkruaj mesazhin tënd.
4. Kliko butonin **Send** i cili ndodhet në shiritin e veglave të mesazhit. Mesazhi do të dërgohet në Outboxin e juaj.

Mvarësisht nga preferencat e e-mailit të juaj, mesazhi do të mund të dërgohet menjëher ose do të vendoset në Outbox dhe pastaj të dërgohet kur ju të keni klikuar butonin **Send/Rec**. Gjithashtu si veçori e paradefinuar, Outlook Express ruan një kopje të të gjitha mesazheve të dërguara në follderin Sent Items. Ju mund të shikoni këtë follder duke klikuar **Sent Items** në shiritin e Folders. Për të modifikuar preferencat e e-mailit të juaj, përdorë komandën Options në menynë Tools.

## SHKRIMI DHE DËRGIMI I MESAZHIT TË RI

Ju nuk jeni të kufizuar në përgjigjen ndaj mesazheve ekzistuese. Ju mund të dërgoni një mesazh secilit i cili ka një adres e-maili në Internet. Për të bërë një gjë të tillë, ju duhet të dini e-mail adresën e atij personi. Ju mund t'a shkruani atë ose t'a selektoni nga libri i adresave. (Shiko "Mundësit tjera me E-mail" më vonë në këtë mësim.). Pasi të keni shkruar adresën, ju duhet mbushur kolonën **subject** dhe pastaj mesazhin e juaj.

Ndjek këta hapa për të shkruar dhe dërguar një mesazh:

1. Në dritaren e Outlook Express, kliko butonin **Create Mail**. Ju do të vëreni një mesazh të zbrazët të e-mailit (shiko Figura 9.4).




FIGURA 9.4

*Shkruaj një mesazh e-maili të ri dhe pastaj kompleto fushën To: dhe Subject: dhe pastaj shkruaj mesazhin.*

2. Shkruaj adresën e e-mailit të pranuesit. Adrsat kanë këtë format username@domainname.ext (për shembull, sohara@msn.com). Shtyp tastin **tab**.
3. Për të dërguar një carbon copy (Cc:) deri tek një pranues tjetër, shkruaj adresën e atij personi dhe shtyp **tab**. Për të kaluar fushën Cc:, thjesht shtyp dy herë tastin **tab**.

## KUJDES

Adresa e Gabuar Në qoftë se keni dhënë një adresë të pasaktë dhe mesazhi juaj nuk është dërguar, në rastet e përgjithshme ju do të pranoni një Failure to Deliver shënim. Ju pastaj mund t'a kontrolloni dhe korigjoni adresën dhe t'a ridërgoni mesazhin.

4. Mbush kutinë tekstuale të Subject:, dhe pastaj shtyp **tab**.
5. Shkruani mesazhin e juaj.
6. Kliko butonin **Send**. Si edhe gjatë përgjigjes të një mesazhi, mesazhi ose dërgohet menjëherë ose vendoset në Outboxin e juaj dhe do të dërgohet kur ju të keni klikuar **Send/Rec**, ashtu siç është përcaktuar në preferencat e e-mailit të juaj.

## FSHIRJA DHE SHLYPJA E MESAZHEVE

Për të evituar situatat e stërngarkimit të Inbox, ju mund të shlyeni mesazhet. Në dritaren e Outlook Express, selekto mesazhin që dëshiron t'a shlyesh, ose hape mesazhin që dëshiron t'a shlyesh. Kliko ikonën **Delete**




. Kur ju të keni shlyer mesazhin, në faktë nuk është shlyer, por është zhvendosur në follderin Deleted Items.

## KËSHILLË

Kthimi i Mesazhit të Fshirë Për të kthyer një mesazh të fshirë, hap follderin Deleted Items, selekto mesazhin, dhe pastaj zhvendose atë në një follder tjetër duke e tërhequr nga paneli i Header i mesazhit në njërin nga follderat në listën e Folders.

Për të shtypur një mesazh të hapur, selekto mesazhin nga dritarja e

Outlook Express ose hap mesazhin. Pastaj kliko butonin **Print** .

## DALJA DHE Ç'KYÇJA

Për të dalur nga Outlook Express, kliko butonin **Close** të dritares së programit. Në qoftë se kërkohet nga ju që të bëni ç'logimin, selekto **Yes** ose **Disconnect**. Në qoftë se kjo nuk kërkohet nga ju, atëherë kliko tastin e djathtë të miut mbi ikonën e connection në Taskbar dhe selekto **Disconnect**.

## MUNDËSIT TJERA ME E-MAIL

U shpjeguan bazat e mënyrës së dërgimit të e-mailit, por ka akoma shumë gjëra që ju mund t'i bëni me Outlook Express. Disa nga ato tema të cilat ja vlejné të dihen janë të mbuluara në paragrafet vijuese.

### BASHKANGJITJA E FAJLLIT PËR MESAZHI

Ju mund të bashkangjitni fajllin për t'a dërguar së bashku me mesazhin. Për shembull, ju mund të dërgoni fotografi ose në qoftë se punoni nga shtëpia, ju mund t'i bashkangjitni dokumentet si raportet apo tabelat e shpenzimeve. Për të bashkangjitur një fajll, kliko butonin **Attach** në dritaren e mesazhit të e-mailit. Selekto fajllin që dëshiron t'a bashkangjesësh nga Insert Attachment kutia e dialogut dhe pastaj kliko butonin **Attach**. Fajlli i bashkangjitur do të listohet në kutinë tekstuale të Attach. Kliko butonin **Send** për të dërguar mesazhin dhe fajllin e bashkangjitur.

### HAPJA E FAJLLIT TË BASHKANGJITUR

Në qoftë se ndokush u ka dërguar fajll të bashkangjitur, atëherë ju ose do t'a hapni atë ose do t'a ruanit në disk. Mesazhet që përmbajnë fajlle të bashkangjitura, paraqiten zakonisht me ikonën e kapëses së letrave. Vëreni se, për të hapur një fajll të bashkangjitur, ju duhet të keni programin i cili ka mundsinë e hapjes së atij fajlli.

Ndjek këta hapa:

1. Kliko dy herë mbi mesazh. Fajlli(at) e bashkangjitur listohen në kutinë tekstuale të Attach.
2. Kliko dy herë ikonën e bashkangjitjes. Ju do të shifni kutinë e dialogut Open Attachment Warning (shiko Figurën 9.5).



FIGURA 9.5

*Trajtimi i fajllave të bashkangjitur të e-mail-it.*

3. Selecto **Open it** ose **Save it to disk**.

Në qoftë se keni selektuar që të hapet ai, atëherë fajlli është hapur në programin e shoqëruar (zakonisht është programi në të cilin është realizuar). Në qoftë se keni selektuar që t'a ruani fajllin e bashkangjitur, atëherë do të shfaqet kutia e dialogut Save Attachment As. Shkruani emrin e fajllit, selekto ffolderin ku dëshiron t'a ruash fajllin e bashkangjitur dhe kliko **OK**. (Shiko Mësimi 4, "Puna me Dokumente," për më tepër informatë në lidhje me ruajtjen e fajllave.)

## PËRDORIMI I ADDRESS BOOK

Në qoftë se ju shpesh dërgoni e-mail tek personat e ngjashëm, mos shkruani adresën çdo herë. Në vend të kësaj, ju do të mund të shtoni emrin në Address Book. Pastaj ju më shpejtë do të selektoni këtë emër dhe adresë kur shkruani mesazhe të reja ose përcjellni mesazhe.

Mënyra më e shpejtë e shtimit të adresës është t'a marrësh atë nga mesazhi ekzistues. Shfaq mesazhin e personit që dëshiron t'a shtosh.



Pastaj kliko me tastin e djathtë adresën e e-mailit. Në menynë që paraqitet, kliko **Add to Address Book**. Tabulatori Summary shfaq emrin e paradefinuar dhe adresën e e-mailit (shiko Figurën 9.6). Kliko tabulatorin **Name** dhe bëji ndryshimet e nevojshme tek emri i shfaqur (emri që paraqitet në listë). Kliko **OK** për t'a shtuar emrin.




FIGURA 9.6

*Shto adresat e e-mailit të përdorura më së shpeshti në address book.*

Që t'a shtosh emrin dhe jo t'a shkruash atë, kliko butonin **To:** në dritaren e mesazhit. Do të shifni kutinë e dialogut Select Recipients me listën e kontakteve në Address Book (shiko Figurën 9.7). Selektu personin për t'a shtuar dhe kliko **To:**. Ky person është shtuar tek lista e pranuesve të Mesazheve. Përsërit hapin e fundit për secilin person që dëshiron t'i dërgosh mesazh. Kliko **OK**.

## KËSHILLË

Shto Cc: ose Bcc: Gjithashtu ju mund t'i klikoni emrat dhe t'i shtoni pastaj ata në listën **Carbon copy (Cc:)** ose në **Blind carbon copy (Bcc:)**. Për të bërë një gjë të tillë, kliko emrin dhe pastaj kliko **Cc:** ose **Bcc:**. Adresa do të listohet tek carbon copy. Përmes Blind carbon copy, pranuesi merr mesazhin, por adresa e tij nuk është e listuar në listën kryesore të pranuesve të mesazheve.




FIGURA 9.7

*Përdorë Address Book që të importosh adresat e e-mailit kur dërgon mesazhe.*

Në këtë mësim ju mësuat përdorimin e Outlook Express për të dërguar dhe pranuar mesazhe të e-mailit. Kaloni në mësimin e ardhshëm që të merrni më shumë informatë për një program tjetër të Windows XP, Internet Explorer. Ju mund t'a përdorni këtë shfletues të Internetit për t'i parë faqet e Web në Internet.

# MËSIMI 10

## Shfletimi i Internetit



*Në këtë mësim ju do të mësoni se si t'a përdorni Internet Explore, një shfletues i Web i përfshirë në Microsoft Windows XP.*

### KONFIGURIMI I KONEKSIONIT TË INTERNETIT

Në qoftë se posedoni modem dhe koneksion të Internetit, ju do të mund t'a përdorni Internet Explorer për t'a eksploruar Internetin. Ju do t'a përdorni Internet Explorer për të shfletuar faqet e World Wide Web, me qëllim që të kërkonti temat specifike si dhe të vendosni parametrat e privatësisë dhe të sigurisë, ashtu që të keni një shfletim të sigurtë.

Për t'a eksploruar Internetin, ju duhet të posedoni modem (analog, kabllor, DSL ose satelitor) si dhe një koneksion të Internetit. Ju do të mund të merrni një koneksion të këtillë përmes furnizuesve on-line siç janë: America Online ose MSN, ose ju mund të merrni një llogari nga Internet Service Provider (ISP). Para se t'i shijoni të gjitha avantazhet e të mirave të Internetit, ju duhet t'a konfiguroni koneksionin e Internetit. Specifikat e konfigurimit mvaren nga lloji i koneksionit dhe nga furnizuesi i juaj. Megjith atë, ndjek instruksionet specifike që ju i keni marrur nga furnizuesi i juaj i Internetit. Për të bërë një gjë të tillë ju mund t'a përdorni Internet Connection Wizard. Kliko **Start, All Programs, Accessories, Communications, New Connection Wizard**.

### KËSHILLË

Çasje me Shpejtësi të Lartë Mënyra më e ngadalshme e çasjes në Internet është përmes modemit analog dhe lidhjes telefonike. Risitë, metodat e shpejta po bëhen gjithnjë e më të popullarizuara dhe lehtë për t'u marrë (dhe gjithashtu më të lira se kur këto

Veçori u prezantuan). Për shembull, ju mund të kyçeni me modem kabllor dhe llogari të dhënë nga furnizuesi i juaj kabllor. Gjithashtu, ju mund të kyçeni përmes mënyrave tjera të posaçme. DSL në princip punon mbi bazën e linjes telefonike, por kërkon nga ju që të ndodheni me lokacion afër kutisë për kyçje **telco**, përderisa koneksioni satelitor funksionon pa patur nevojë për tela, por nuk është i shpejtë sa edhe DSL-ja. Njashtu mund të kyçeni edhe përmes linjave të posaçme telefonike si ISDN. Në qoftë se nuk keni një llogari për kyçje në Internet, shikojë të gjitha variantet e mundshme para se të përcaktohesh për njërin nga opsionet.

## STARTIMI I INTERNET EXPLORER

Pasi të keni bërë konfigurimin e koneksionit të Internetit, ju do të mund të startoni Internet Explorerin. Ndjek këta hapa:

1. Kliko **Start**, dhe pastaj kliko **Internet**.
2. Shkruaj emrin e përdoruesit (username) dhe fjalë-kalimin (password) (një pjesë e informacionit mund të jetë kompletuar për ju) dhe pastaj kliko butonin **Connect**. Windows lidhet me ISP e juaj dhe shfaq dritaren e Internet Explorer. Ju do të shifni faqen e juaj startuese, zakonisht është web faqja e MSN (shiko Figurën 10.1)



### KUJDES

Problem gjatë Lidhjes? Në qoftë se u paraqiten probleme gjatë lidhjes – si përshembull: linja është e nxënë, - provoni përsëri . Por nëse vazhdoni të keni aloma probleme, atëherë bisedojeni me ISP e juaj.

Dritarja e Internet Explorer ofron një sërë veglash për shfletim. Të gjitha këto janë përshkruar në tabelën 10.1.




FIGURA 10.1

Ju mund t'a përdorni Internet Explorer-in për t'a shfletuar Internetin. Kalo ca minuta duke e familjarizuar vehten me veglat e këtij programi.

Tabela 10.1 Veglat e Internet Explorer-it












Butoni	Emri	Kliko që të...
	Mbrapa	Kthehesh mbrapa tek faqja e fundit e vizituar
	Përpara	Shkosh një faqe më përpara. Ky buton është aktiv vetëm në qoftë se keni klikuar <b>Back</b> për të shkuar mbrapa për një faqe.
	Stop	Stopon shfaqjen e faqes së kërkuar. Përdorë këtë buton nëse faqja merr kohë për t'u shfaqur ose nëse ndërroni mendjen.

Tabela 10.1 (vazhdon)

Butoni	Emri	Kliko që të...
	Rifresko	Rishfaqësh faqen e kërkuar, ose për të rifreskuar të dhënat në faqen aktuale.
	Shtëpia	Kthehesh në faqen shtëpi (faqja e parë e një Web sajti të paradefinuar).
 Search	Kërkim	Shfaqësh shiritin e Kërkimit për të kërkuar një sajt. Shiko “Kërkimi i Internetit” më vonë në këtë mësim.
 Favorites	Favoritet	Shfaqësh listën e sajteve të favorshme. Shiko “Pështatja e Internet Explorer” më vonë në këtë mësim.
 Media	Media	Shfaqësh udhëzuesin për Media me mundësi çasjeje në muzikë, sekuencë filmike dhe veçori të tjera të mediave.
	Historia	Shfaqësh listën e sajteve të vizituar së fundi. Shiko “Pështatja e Internet Explorer” më vonë në këtë mësim.
	Posta	Dërgosh një faqe me e-mail apo të lidhesh me faqen. Për më tepër informatë për mesazhet e e-mail, shiko Mësimi 9 “Dërgimi i e-mail”.
	Shtypë	Shtypësh Web faqen aktuale.
	Edito	Editosh faqen aktuale në programin për editim të Web.
	Diskuto	Bashkangjitesh serverëve të diskutimeve për të ndarë komentet në tema të ndryshme.
 Links >>	Shiriti i Lidhjeve	Shfaqësh linket deri tek sajtet që kanë të bëjnë me Windows.
	Shiriti i Adresës	Shkruash adresën e ndonjë Web sajti tjetër.



## KËSHILLË

Më Tepër Informatë për Publikimet në Web Në qoftë se interesoheni për publikimet në Web, provo njërin nga titujt e shumtë të **Que** në lidhje me këtë temë: **10 Minuta Udhëzues në Microsoft Front Page 2002.**

## PËRDORIMI I LIDHJEVE PËR NAVIGIM

Informatën në internet është e lehtë për t'a shfletuar, sepse dokumentet përmbajnë lidhje deri tek faqet tjera, dokumentet dhe sajtet. Ju mund të klikoni një lidhje në faqen aktuale për të shikuar faqen që thërritet nga ajo lidhje. Nganjëherë lidhja u dërgon ju deri tek një sektorë tjetër i faqes aktuale apo në ndonjë faqe tjetër tek sajt i Web aktual. Ndonjë herë, kliku i lidhjes mund t'u dërgojë në ndonjë sajtë tërësisht të ndryshëm. Gjysmën e kënaqësisë së shfletimit e paraqet kërkimi i të gjitha llojeve të temave dhe niveleve të informatës duke përdorur lidhjet.



## KËSHILLË

Lidhjet ose Hiperlidhjet Lidhjet gjithashtu quhen edhe Hiperlidhje dhe zakonisht paraqiten të nënvizuara dhe nganjëherë me ngjyrë tjetër. Fotografitë gjithashtu mund të jenë lidhje. Shumë e dukshme është lidhja, meqë kur shënjojmë mbi të me shënjesin e miut, shënjesi merr formën e dorës me gishtin tregues dhe adresa që përmban ajo lidhje paraqitet në shiritin e statutit.

Që të shkoni tek një lidhje, thjeshtë vetëm klikojeni atë. Ju mund të kaloni nga një lidhje tek tjetra deri sa të gjeni informatën e dëshiruar. Në qoftë se, mendoni që jeni shmangur shumë nga informata që kërkoni, kujtoni që ju mund të përdorni butonin **Back** aq herë sa të ketë nevojë për t'u kthyer disa faqe mbrapa. Gjithashtu, mund të klikoni shigjetën me kokë poshtë pranë butonit **Back** dhe të selektoni sajtin nga lista e shfaqur.

## SHKRUARJA E WEB ADRESËS


Shkruarja e Web adresë paraqet mënyrën më të shpejtë për të shkruar deri tek ai sajt.



### SHQIPE E QARTË

Web Adresë apo URL Ju mund të dëgjoni që Web adresa i referohet URL (**Uniform Resource Locator**). Në përgjithësi, Web adresat përbëhen nga protokoli (zakonisht **http://**), treguesi i Web (zakonisht **www**) si dhe emrit të domain (diçka si **nba.com**). Kështu që, adresa e kompletuar do jetë **http://www.nba.com**. Kur shkruani një adresë nuk kërkohet që të shkruhet pjesa **http://**. Në disa raste mund të mos përdorni edhe pjesën **www**. Gjithashtu, emri i domain mund të përfshijë shtegun (listën e folderave) deri tek dokumentet.

Ju mund të gjeni adresa në reklama, gazetate ditore ose artikuj të revistave si dhe nga burimet tjera mediale. Prapashtesat (zakonisht **.com**, **.net**, **.gov**, **.edu**, ose **.mil**) paraqesin kategorinë e sajtit (komercial, resurset e rrjetit, qeverisë, edukimit, ose respektivisht të ushtrisë).



### KËSHILLË

Mundohu t'ia Qëllosh Shumica e emrave të Web sajteve në njëfarë mënyre paraqesin emrin e lokacionit ose të kompanisë, që shpesh edhe mund t'i qëlloni. Për shembull, për të shkruar tek sajt i **NFL**, shkruani **www.nfl.com**. Nëse, adresa është jo e saktë, ju do të shifni një faqe tek e cila jepet sqarimi se sajt nuk ekziston ose do të mësoni që ndokush tjetër ka regjistruar atë adresë për qëllime të tjera. Ju mund të provoni një version tjetër të emrit të sajtit ose kërkoni sajtin ashtu siç është shpjeguar në "Kërkimi i Internetit" më vonë në këtë mësim.

Për të shkruar deri tek një adresë, ndjek këta hapa:

1. Kliko shiritin e **Adresës**.
2. Shkruaje adresën e sajtit që dëshironi t'a vizitoni dhe pastaj shtypni tastin **Enter**. Internet Explorer shfaq faqen e asaj adrese.





## KËSHILLË

Përdorë AutoComplete Në qoftë, më parë keni shkruar një adresë specifike, ju vetëm duhet të shkruani shkronjat e para të saj dhe Internet Explorer do të shfaq pjesën tjetër për ju. Shtyp **Enter** që Internet Explorer të kompletoj adresën për ju.

## KËRKIMI NË INTERNET

Interneti përmban në vehte sajte të shumta. Të kërlesh sajtin e dëshiruar përmes shfletimit mund të gjasojë si kërkimi i gjilpërës në “stomin e sanës”. Në vend të kësaj, ju mund të bëni kërkimin e temës dhe do t’i gjeni të gjitha sajtet që kanë të bëjnë me atë temë:

Për të kërkuar sajtin me ndonjë temë të veçantë, ndjek këta hapa:

1. Kliko butonin **Search** në shiritin e veglave. Ju shifni shiritin e Kërkimit në panelin e djathtë të dritares së Internet Explorer.
2. Shkruaj çfarë dëshiron të kërlesh dhe pastaj kliko butonin **Search** (shiko Figurën 10.2).




FIGURA 10.2

*Shkruaj temën që dëshiron të kërlesh tek editorit tekstual për kërkime.*



## KËSHILLË

Të Thënurit Lamtumirë Qenit të Animuar Disave u pëlqejnë karakteret e animuara. Microsoft ka një tendencë që t'i përfshijë ato në programet e veta. Të tjerët ndjehen të bezdisëshëm. Pë të ç'kyçur karakteret, kliko **Turn off animated characters** tek shiriti i Kërkimit. Mbase do të kërkohet nga ju që të lëvizni nëpër shiritin e Kërkimit që t'a vëreni këtë opcion, i cili është i listuar i fundit.

Rezultatet e kërkimit do të shfaqen në krahun e djathtë të dritares së Internet Explorer (shiko Figurën 10.3). Ju mund të lëvizni me shiritat rrëshqitës që të shikoni informacionin e rezultateve të para që kanë përmbushur kriterin e kërkimit. Në qoftë se, më shumë se një faqe me rezultate janë gjetur, atëherë klikoni lidhjen **Next** për të shfaqur faqen tjetër me rezultate. Për të shkuar tek ndonjëri nga sajtet e gjetura, kliko lidhjen në dritaren e rezultateve të shfaqura. Faqja që ju keni selektuar, do të shfaqet në panelin e djathtë.




FIGURA 10.3

*Ju mund t'i rishikoni të gjitha rezultatet që kanë përmbushur kriterin e kërkimit të temës së juaj. Gjithashtu ju mund t'a rafinoni kërkimin e juaj duke përdorur sygjerimet në shiritin e Kërkimit.*

Në qoftë se, nuk gjeni rezultate të kënaqshme, atëherë ju mund t'a rafinoni kërkimin e juaj. Shiriti i Kërkimit (shiko panelin e majtë në Figurën 10.3) ofron disa sugjerime për kërkim më specifik. Për të mbyllur shiritin e Kërkimit, kliko butonin **Close** të tij ose kliko përsëri butonin **Search**.

## PËRSHTATJA E INTERNET EXPLORER

Për t'a bërë kërkimin akoma më të lehtë, ju mund të përdorni ikonat me çasje të shpejtë si dhe veçoritë për përshtatje të Internet Explorer. Nëntitujt e mëposhtëm do të theksojnë disa nga to.

### PËRDORIMI I LISTËS SË FAVORITEVE

Nëse keni gjetur një sajt që e pëlqeni jashtzakonisht, do të dëshironit që në mënyrë të shpejtë të ktheheni deri ke sajt pa patur nevojë që të bëni një shfletim nga lidhja në lidhje ose që të mbani në mend adresën. Fatmirësisht, Internet Explorer u bënë të mundur që të ndërtoni listën e sajteve të favoriteve dhe t'i çasni ato sajte duke i klikuar ato nga lista.

Për të shtuar një sajt tek lista e favoriteve, ndjek këta hapa:

1. Shfaq Web sajtin që dëshiron t'a shtoshë në listën tënde.
2. Hape menynë **Favorites** dhe kliko komandën **Add to Favorites**.
3. Në kutinë e dialogut Add Favorites, të paraqitur në Figurën 10.4, shkruaj emrin e faqes (nëse nuk jeni i kënaqur me emrin e pararendinuar të sajtit).




FIGURA 10.4  
*Shto sajtet e pëlqyera tek lista e Favoriteve.*

4. Kliko **OK**.

Pasi të keni shtuar sajtin tek lista e Favoriteve, ju mund të shkoni tek ai sajt duke klikuar butonin **Favorites**. Në shiritin e Favoriteve që do shfaqet, kliko sajtin që dëshiron t'a vizitosh.

#### PËRDORIMI I LISTËS SË HISTORISË

Në qoftë se kohëve të fundit ke vizituar sajtet që i pëlqen, por nuk u kujtohen adresat e tyre, ju mund t'i shikoni ato në listën e Historisë. Nga kjo listë ju pastaj mund t'i shikoni sajtet dhe faqet që i keni vizituar në javët e fundit. Po nga kjo listë, ju mund t'i gjeni sajtet që i dëshironi dhe klikoni lidhjet e tyre për të shkuar deri tek ato sajte.

Ndjek këta hapa për të parë dhe shkuar tek sajt nga lista e Historisë:



1. Kliko butonin **History** . Shfaqet shiriti i Historisë.
2. Selektu javën dhe ditën që dëshiron të rishikosh dhe sajtin që dëshironi të vizitoni. Përfundimisht, klikoni faqen specifike në atë sajt Faqja do të shfaqet.
3. Kliko butonin **Close** për t'a mbyllur shiritin e Historisë.

#### KONFIGURIMI I FAQES SË JUAJ SHTËPI DHE OPCIONEVE TË SIGURISË

Për t'a përshtatur akoma Internet Explorer, ju mund të përdorni kutinë e dialogut të Internet Options për të bërë ndryshimet. Në këtë kuti të dialogut, ju mund të zgjedhni faqen shtëpi (sajti i cili do shfaqet kur ju logoheni dhe kur ju klikoni butonin **Home**). Gjithashtu, ju mund të vendosni parametrat e sigurisë si dhe të bëni akoma më shumë ndryshime të avancuara. Për shembull, shumë përdorues shtëpiak përdorin koneksion kabllor të Internetit. Për faktin që këto koneksione janë të lidhura 24/7, është shumë e rëndësishme që ju t'a mbronni kompjuterin e juaj nga të tjerët në Internet. Për të bërë një gjë të tillë, ju mund të përdorni mbrojtjen Windows Firewall.

Ndjek këta hapa për të bërë ndryshimet në Internet Options:

1. Kliko **Tools** dhe pastaj kliko komandën **Internet Option**.
2. Në t'abulatorin General, të paraqitur në Figurën 10.5, ju mund të bëni gjithçka nga çka vijon:



FIGURA 10.5

*Konfiguroni parametrat bazë të Internetit në tabulatorin General.*

Për të konfiguruar një faqe shtëpi, shkruaje atë në kutinë tekstuale të Adresës. Gjithashtu, ju mund të shkoni tek faqja që dëshironi t'a përdorni si faqe shtëpi dhe pastaj klikoni butonin **Use Current**. Për të përdorur faqen shtëpi të paradefinuar, kliko butonin **Use Default**.

Për t'a pastruar listën e historisë, kliko butonin **Clear History**. Ju do t'a bëni këtë me qëllim që të mos lejoni që të tjerët të shfletojnë nëpër listën e sajteve që ju i keni vizituar ose për të liruar hapsirë të diskut që Windows XP e përdorë për të ruajtur listën e historisë.

3. Bëjë çfardo ndryshimi tjetër. Më poshtë do të përmenden disa ndryshime tjera të rëndomta:

Pë të vendosur nivele te sigurisë, kliko tabulatorin **Security** dhe pastaj selekto zonën në të cilën do të shtoni sajtet. Për shembull, selekto **restricted sites**. Pastaj kliko butonin **Sites** dhe shkruaj sajtet që ju dëshironi të vendsoni restriksione deri tek to.

Për të përcaktuar nivelet e privacisë, kliko tabulatorin **Privacy**. Pastaj tërhiq shiritin rrëshqitës të Privacy deri tek niveli që ju dëshironi.

Për t'a aktivizuar Content Advisor (i dobishëm zakonisht kur fëmijët përdorin koneksionin e juaj të Internetit), kliko tabulatorin **Content** dhe pastaj kliko butonin **Enable** tek pjesa e Content Advisor. Pastaj ju keni mundsinë e përcaktimit të shkallës së nivelit për lloje të ndryshme të kategorive, përfshi këtu: të zhargonin e të folurit, lakuriqësinë, seksin dhe dhunën.

Për t'a aktivizuar mbrojtjen përmes Firewall, kliko tabulatorin **Connection** dhe pastaj selekto koneksionin që dëshironi t'a mbron. Kliko **Settings**, pastaj kliko butonin **Properties** për koneksionin dhe pastaj kliko tabulatorin **Advanced**. Kliko katrorin e zgjedhjes të opcionit të Firewall që të aktivizohet ai.

## DALJA DHE Ç'LOGIMI NGA INTERNETI

Për të dalur nga Internet Explorer, kliko butonin **Close** të tij ose selekto **File, Close**. Kur të keni dalur nga Internet Explorer, mbase mund të kërkohet nga ju që të ç'logoheni nga furnizuesi i juaj i Internetit. Klikoni **Yes** ose **Disconnect Now**. Në qoftë se, një gjë e tillë nuk kërkohet por ju përdorni koneksion përmes thirrjes telefonike (dial-up), sigurohuni që të bëni ç'logimin. Kliko me tastin e djathtë mbi ikonën që ndodhet në System Tray dhe selekto **Disconnect** (kjo nuk vlenë për përdoruesit që kanë koneksion kabllor ose DSL).

Në këtë mësim ju mësuat konceptet bazë të përdorimit të Internet Explorer me qëllim që të shfletoni Internetin. Kaloni në mësimin vijues që të mësoni përdorimin e një veçorie tjetër komunikuese të Windows XP, Fax Console.

# MËSIMI 11

## Dërgimi dhe Pranimi i Fakseve



*Në këtë mësim ju do të mësoni se si të dërgoni dhe pranoni fakset përmes Microsoft Windows XP.*

### KONFIGURIMI I FAX CONSOLE

Para se të filloni të përdorni faks modemin e juaj për të dërguar dhe pranuar fakse, ju duhet të bëni setapin e tij në Windows, siç është për shembull regjistrimi i informacionit për faks numrin dhe faks paisjen. Për t'u ndihmuar juve në këtë process, Windows XP përmban Fax Configuration Wizard. Ky program starton me startimin për herë të parë të Fax Console. Për të bërë këtë, klikoni **Start, All Programs, Accessories, Communications, Fax**, dhe përfundimisht **Fax Console**. Figura 11.1 paraqet dritaren e Fax Console.





FIGURA 11.1

*Përdorë Fax Console për të dërguar dhe pranuar Fakset.*

Për të startuar Fax Configuration Wizard në mënyrë manuele (në qoftë se ajo nuk startohet kur ju të hapni Fax Console), kliko **Tools** nga Fax Console dhe pastaj kliko komandën **Configuration Fax**.

Për të konfiguruar faksin e juaj, kompleto çdo hapë në **Wizard**, duke shkruar informacionin e duhur dhe duke klikuar **Next** për të ecur në hapin tjetër. Ju mund të pritni të kompletohen të dhënat vijuese:

- Shkruani informatat e juaja kontaktuese (emri, numri i faksit, adresa e e-mailit, ndërmarrja, si dhe informata të tjera telefonike).
- Zgjedh paisjen e faksit për dërgim dhe pranim dhe shkruaj **TSID** dhe **CSID**.



## KËSHILLË

TSID dhe CSID TSID është linjë e cila identifikon faksin e juaj kur ju dërgoni faks. Ju mund të shkruani emrin e biznesit të juaj ose numrin e faksit të juaj. CSID është një linjë teksti që identifikon paisjen e faksit të juaj kur ai pranon fakset.

- Përcakto se si fakset e pranuar do të trajtohen (do të shtypen direkt në shtyp apo do të ruhen në follder). Në qoftë se zgjedhni që t'i shtypni fakset e pranuar, atëherë mund t'a zgjedhni shtypsin nga lista rënëse. Por, në qoftë se do të zgjedhni që t'i ruani fakset në follder (të cilët pastaj do të mund t'i hapni dhe t'i shikoni në atë folder), zgjedh këtë opcion dhe pastaj përcakto cilin follder do t'a përdorësh.

## DËRGIMI I FAKSIT

Pasi të jetë konfiguruar Fax Console, atëherë ju mund t'a përdorni atë që të dërgoni dhe pranoni fakse. Për t'u ndihmuar juve që t'a përpiloni dhe dërgoni një faks, Windows XP ofron **Fax Send Wizard**. Ky **Wizard** do t'u ecë juve nëpër hapat e përpilimit dhe dërgimit të faqes së ballinës të faksit.



Për të dërguar faks përmes **Wizard**, ndjek këta hapa:

1. Në qoftë se Fax Console nuk është e hapur, kliko **Start, All Programs, Accessories, Communications, Fax**, dhe përfundimisht **Fax Send Wizard**.

Në qoftë se Fax Console është e hapur, kliko **File**, dhe pastaj kliko komandën **Send a Fax**. Të dy mënyrat startojnë Send Fax Wizard.

2. Kliko **Next** të ecësh nga dritarja welcome në hapin e parë.
3. Shkruaj emrin dhe numrin e pranuesit (shiko Figurën 11.2). Kliko **Next**.

The image shows a 'Send Fax Wizard' dialog box. It has a title bar with a close button. The main content area is titled 'Recipient Information' and includes a small icon of a fax machine. The text below the title says: 'Enter the name and number of the person you want to send the fax to, or click Address Book to select a fax recipient.' The form contains several input fields: 'To:' with the text 'Sunny Dulin' and an 'Address Book...' button; 'Location:' with a dropdown menu showing 'Albania (355)'; 'Fax number:' with a dropdown menu showing '812-555-9000' and a 'Dialing rules...' button; and a checkbox for 'Use dialing rules' with a 'New Location' dropdown. Below these fields is a table with columns 'Recipient name' and 'Fax number', and buttons 'Add', 'Remove', and 'Edit'. At the bottom are '< Back', 'Next >', and 'Cancel' buttons.

FIGURA 11.2

*Shkruaj emrin e pranuesit dhe numrin e faksit të tij.*

4. Në qoftë se dëshironi të përdorni një formularë tjetër të ballinës së faksit, shfaq listën rënese të formularëve dhe zgjedh atë që të pëlqen.
5. Shkruaj titullin dhe mesazhin për fletën ballinë të faksit (shiko Figurën 11.3). Kliko **Next**.
6. Pëckato se kur do t'a dërgosh faksin. Parametrat e juaj janë paraqitur në Figurën 11.4. Kliko **Next**.




FIGURA 11.3

*Shkruaj përmbajtjen e faksit në këtë kuti të dialogut, duke përfshi edhe titullin dhe mesazhin.*




FIGURA 11.4

*Ju mund t'a dërgoni faksin menjëherë apo t'a skeduloni atë për dërgim në ndonjë kohë tjetër.*

7. Kliko **finish**. Faksi është dërguar në kohën që ju keni përcaktuar në hapin 6.

Gjithashtu ju mund të faksoni dokumentet e krijuara në programet e Windows duke i "shtypur" në faks; programi do të përdorë faks-modemin që ju e keni konfiguruar përmes **Wizard** për konfigurim.

Për të faksuar një dokument, hapë dokumentin që dëshiron t'a faksosh dhe kliko **File, Print**. Në kutinë e dialogut të **Print**, zgjedh **Fax** në rolin e shtypësit. Kompleto të dhënat e pranuesit si dhe informatat e tjera që nevojiten për faksim, kliko **Next** që të përmbushësh çdo hapë në **Wizard** të faksit. Dokumenti pastaj do të faksohet deri tek ai pranues.

## PRANIMI DHE SHFLETIMI I FAKSIT

Kur ju përdorni **Fax Configuration Wizard** për të konfiguruar modemën, modemi pranon fakset e ardhura dhe i trajton ato në pajtim me opsionet që ju keni zgjedhur. Në qoftë se keni zgjedhur që t'i shtypni fakset e pranuar, atëherë ato do të shtypen në shtypsin e zgjedhur. Në qoftë se keni zgjedhur që ato t'i ruani në follder, atëherë ato vendosen në atë follder. Ju do të mund t'a hapni atë follder dhe pastaj t'i shikoni fakset. Gjithashtu, ju mund t'i shikoni fakset edhe nga Fax Console duke selektuar **Inbox** nga lista e **Fax**. Për t'a hapur një faks të ardhur, kliko dy herë mbi të. Pastaj, ju do të mund t'i shtypni nga kjo dritare e para-pamjes (shiko Figurën 11.5).





FIGURA 11.5

*Ju mund t'i hapni fakset nga Inbox i juaj dhe pastaj t'i shtypni ato.*

Në këtë mësim ju keni mësuar si të përdorni faks-modemën e juaj për të dërguar dhe pranuar fakse. Mësimi vijues flet për një temë të re, përdorimin e skenerit ose të kamerës digjitale për të krijuar, shtypur dhe dërguar përmes e-mailit fotografitë.



## KUJDES

Nuk mund të pranon? Në qoftë se keni probleme me pranimin e fakseve, paisja e juaj e faksit mbase nuk është e konfiguruar të pranojë fakse. Ju mund t'a aktivizoni dërgimin dhe pranimin. Për të bërë një gjë të tillë , kliko **Start, Control Panel, Printers and Other Hardware**, dhe në fund, **Printers and Faxes**. Kliko me tastin e djathtë të miut mbi paisjen e faksit, kliko me tastin e djathtë të miut mbi **Receive**, dhe pastaj kliko **Auto**.

# MËSIMI 12

## Puna me Fotografit



*Në këtë mësim ju do të mësoni të punoni me paisje të ndryshme për imazhe, veçanërisht për skenerat dhe kamerat digjitale. Microsoft Windows XP përmban shumë veçori të reja për shtypjen, e-mailimin si dhe bërjen e on-line porosive për fotografi të shtypura.*

### PËRDORIMI I SKENERIT OSE I KAMERËS DIGJITALE

Kamerat digjitale janë bërë paisje periferike shumë të përdorura në kompjuterat shtëpiak. Ju mund t'i përdorni këto kamera që të realizoni fotografi, dhe pastaj t'i kopjoni ato nga kamera në kompjuter. Pasi të jenë kopjuar në kompjuter, ju do të mund t'i editoni, shtypni, t'i dërgoni me e-mail, apo tjetër aspekt edhe të bëni porosi on-line të fotografive të gatshme.

Gjithashtu, edhe skenerat paraqesin një paisje periferike shumë të përdorur. Përmes skenerit, ju do të mund të ruani imazhet, fotografit, vizatimet, dokumentet, etj, si fajlle në kompjuterin e juaj. Si edhe me fotografitë, edhe këtu ju do të keni mundsinë e modifikimit, shtypjes dhe të dërgimit përmes e-mailit të imazheve. Gjithashtu, ju mund të vendosni imazhin në dokument. Për shembull, ju mund të skenoni fotografinë e familjes së juaj dhe t'a insertoni atë në letrën e Përvjetshme të Festës së Bajramit.

Hapat e saktë të përdorimit të kamerës dhe skenerit të juaj ndryshojnë varësisht nga modeli që posedoni. Prandaj, ju duhet t'i referoheni dokumentacionit i cili ka ardhur së bashku me paisjen hardware, me qëllim që të mësojmë si të bëjmë fotografi dhe skenojmë imazhe. Ky mësim ju shpjegon procedurën e konfigurimit të skenerit dhe kamerës si dhe cilat punë mund t'i bëni pasi që të keni ruajtur këto mesazhe në kompjuterin e juaj.

## KONFIGURIMI I SKENERIT OSE I KAMERËS DIGJITALE

Windows XP në përgjithësi i njeh kamerat dhe skenerat e zakonshëm, dhe krejt çfarë duhet të bëni është që të bëni lidhjen fizike të paisjes për kompjuterin e juaj dhe Windows XP e njeh paisjen e re hardware dhe e bënë konfigurimin e saj në mënyrë automatike. Kjo ndodhë për arsye se Windows XP u alarmon ju me mesazhin që shfaqet nga System Tray.

Në qoftë se keni skener apo kamerë të cilën Windows XP nuk e njeh, atëherë konfigurimin e tyre ju do t'a bëni në mënyrë manuale duke përdorur Wizard për instalim të skenerit dhe kamerës. Ndjek këta hapa:

1. Kliko **Start**, dhe pastaj kliko **Control Panel**.
2. Kliko **Printers and Other Hardware**.
3. Kliko ikonën **Scanners and Cameras Control Panel**.
4. Kliko dy herë ikonën **Add Device** për të startuar Wizard për instalim të kamerës dhe skenerit.
5. Ndjek hapat në wizard, duke shkruar apo selektuar parametrat e duhura dhe duke klikuar **Next** për të lëvizur nga njëri hap tek vijuesi. Hapat bazë kërkojnë nga ju që të selektoni prodhuesin dhe modelin e paisjes së juaj të veçantë (skener ose kamerë). Gjithashtu, ju duhet të selektoni portin për të cilin paisja është lidhur si edhe të shkruani emrin identifikues për paisjen. Kur të keni dhënë informacionet e tërësishme, kliko **Finish** për të kompletuar konfigurimin.

### KËSHILLË

Kthehu një Hap Mbrapa Në qoftë se duhet që të bëni një selektim të ndryshëm nga ai paraprak, ju mund të klikoni **Back** për t'u kthyer një hap mbrapa në wizard.

### KUJDES

Fajllat e Drajverit Që çdo paisje hardware periferike të punojë siç duhet, nevojiten fajllat e drajverit. Windows XP përmban drajverat për shumicën e shtypësave, skenerave, kamerave dhe paisjeve tjera periferike të njohura. Sepse jo të gjithë drajverat janë testuar me Windows XP, dhe si rrjedhojë mund të

hasni që Windows XP nuk përmban drajverin për skenerin e juaj të veçantë (ose ndonjë paisje tjetër hardware). Në këtë rast, shfletu Web sajtin e Windows XP ose të prodhuesit të skenerit (ose paisjeve tjera hardware) për drajvera të risijuar.

## SHTYPJA E FOTOGRAFIVE

Për t'i organizuar fotografitë, Windows XP përmban një follder të veçantë të quajtur My Pictures. Duhet të konsideroni që të gjitha fotografitë e juaj t'i vendosni në këtë follder. Ju mund të krijoni nënfolldera përmbrenda follderit kryesor My Pictures për të ruajtur fotografitë e ngjashme së bashku.

Kur t'a keni hapur follderin i cili përmban fotografi, dhe të keni selektuar fajllat e fotografive, Task Pane shfaq lidhjet të cilat kanë të bëjnë me fotografitë. Figura 12.1 paraqet disa fotografi të bëra me kamerë digjitale. Ju mund t'i shtypni fotografitë në shtypsin e zakonshëm apo në shtypsin e posaçëm për shtypjen e fotografive.




Figura 12.1

*Në follderat që përmbajnë fotografi, Task Pane shfaq lidhjet që kanë të bëjnë me fotografitë.*




## KËSHILLË

Shtypësat për Foto Me shtypsat e zakonshëm nuk do të mund të fitoni një kualitet të fotografisë. Për të arritur një gjë të tillë, atëherë duhet të bleni shtypsa të posaçëm për shtypjen e fotografive si dhe letër për fotografi. Mendoni të shpenzoni nga 200\$ deri në 800\$ ose më shumë për një shtyp të posaçëm. Vizitoni shitoret kompjuterike me pakicë që të shifni opsionet nga më të ndryshmet. Mënyra më e mirë për të zgjedhur një shtyp është krahasimi i rezultateve të shtypjes nga shtypsa të ndryshëm me qëllim që të gjendet njëri me kualitet të pranueshëm të shtypjes.

Ndjek këta hapa për të shtypur forotgrafitë:

1. Hapë follderin i cili përmban fotografitë që ju dëshironi t'i shtypni.
2. Kliko **Print** nga Task Pane. Ky e starton Wizard për shtypjen e fotografive (Photo Printing Wizard).
3. Ndjek hapat në Wizard, si dhe kliko **Next** për të lëvizur nga një hap në tjetrin. Ju mund të selektoni se cilat fotografi janë printuar (shiko Figurën 12.2). Gjithashtu, ju mund të selektoni dhe t'i deselektoni në mënyrë individuale fotografitë për të bërë përzgjedhjen e juaj. Ju mund të fshini të gjitha fotografitë e selektuara përmes klikut në **Clear All**. Ose ju mund t'i selektoni të gjitha fotografitë përmes klikut në **Select All**.

Përmes hapave vijues, ju zgjedhni shtypsin me të cilin do të shtypni dhe pastaj të bëni faqosjen për fotografitë (tërë faqen, 8x10, 5x7, si dhe madhësi tjera të zakonshme të fotografive). Kur fotografitë të jenë shtypur, ju do të vëreni hapin e fundit të Wizard, që u tregon juve se fotografitë janë shtypur. Kliko **Finish** për të mbyllur Wizard për shtypjen e fotografive (Photo Printing Wizard).



## KËSHILLË

Përfshij Fotografi në Dokument Gjithashtu ju mund të bashkangjitni fotografitë (ose imazhet e skenuara) në dokument. Hapat e saktë ndryshojnë varësisht nga programi. Në Microsoft Word, për shembull, ju do të përdorni **Insert, Picture**, komandën **From File**. Shfletu dokumentacionin e programit të juaj për



hapa më të përpiktë për sa i përket insertimit të fotografive në programet e juaj të zakonshëm.




FIGURA 12.2

*Ju mund t'i selektoni fotografitë të cilat dëshironi t'i shtypni dhe t'i deselektoni fotografitë të cilat nuk doni t'i shtypni.*

## DËRGIMI I FOTOGRAFIVE ME E-MAIL

Është kënaqësi të këmbesh fotografitë me shoqërinë dhe antarët e familjes. Përveç shtypjes, gjithashtu ju mund të dërgoni fotografi përmes e-mailit nga Task Pane. Ndjek këta hapa:

1. Hape folderin i cili përmban fotografitë që ju dëshironi t'i dërgoni përmes e-mailit.
2. Selektoto fotografinë(të) që ju dëshironi t'a dërgoni. Fotografitë janë si edhe fajllat e zakonshëm. Ju mund të ndryshoni pamjen e tyre se si ato janë të shfaqura përmes menysë View, si dhe mund t'i selektoni ato ashtu siç edhe i selektoni fajllat e rregullt. (Shiko Mësimi 6, "Menagjimi i Fajllave," për më tepër ndihmë në lidhje me selektimin e fajllave.)

3. Në hapësirën e File and Folder Tasks të Task Pane, kliko **E-mail this file**. Nga ju kërkohet të optimizoni imazhin (e cila gjë do të përshpejton procesin e dërgimit dhe hapjes së fotografisë).
4. Bëni selektimin e optimizimit të juaj dhe klikoni **OK**. Windows hapë dritaren e e-mailit të Outlook Express së bashku me fotografinë e bashkangjitur (shif Figurën 12.3).




FIGURA 12.3

Shkruaj e-mail adresën, pastaj mesazhin, si dhe pastaj kliko Send për t'a dërguar fotografinë.

5. Shkruaj e-mail adresën dhe mesazhin të cilin dëshironi t'a dërgoni me fotografinë e bashkangjitur për të. Pastaj kliko butonin **Send**. Shiko Mësimi 9, "Dërgimi i E-mailit" për më tepër informatë në lidhje me dërgimin e mesazheve.

## KËSHILLË

Puna me Fajllat e Fotografive Emrat e përdorur për follderat dhe fajllat e fotografive shpeshë ndodhë që të mos jenë vetëpërshkrues (zakonisht paraqiten me datën kur imazhet janë bërë ose janë transferuar në kompjuter). Ju mund t'i riemërtoni, fshini, zhvendosni ose kopjoni këta fajlla si edhe cdo fajllë tjetër. Shiko Mësimi 6 për më tepër ndihmë në lidhje me riemërtimin, fshierjen, kopjimin si dhe punën me fajlla.

## POROSITJA E FOTOGRAFIVE TË SHYTPURA NGA INTERNETI

Përveç shtypjes dhe dërgimit të fotografive përmes e-mailit, gjithashtu ju mund të zgjedhni metodën e bërjes së porosive për blerjen e fotografive kualitative nga Interneti. Windows XP përmban Wizard i cili ju drejton hap pas hapi nëpër procesin e bërjes së porosisë së fotografive të shtypura nga shërbimet kualitative përfshi këtu Kodak Online. Ju merrni informata për çmimin e fotografive të shtypura kur bëni porosinë. Gjithashtu, duhet të keni parasysh se do të ngarkoheni me një shumë të vogël për shpenzimet postare. Që të paguani, duhet që të jepni numrin e kartelës kredituese si dhe adresën postale të juajen. Fotografitë zakonisht arrijnë mbrenda disa ditëve.

### KËSHILLË

Mundsitë Tjera      Nëqoftë se kamera e juaj digjitale ka modul të kujtesës, atëherë ju mund të shfrytëzoni këtë kartelë duke e dërguar deri në shërbimet lokale për printim dhe të bëni prosi të shtypjes së fotografive nga kartela. Shiko shitoret lokale të fotografive se çfarë shërbime të kamerave digjitale ato ofrojnë.

Për të porositur kopje nga Interneti, ju duhet të keni çasje në Internet. Në qoftë se nuk keni çasje, atëherë një gjë e tillë kërkohet nga ju. Kur të jeni lidhur, ndjek këta hapa për të bërë porosi të fotografive të shtypura:

1. Hape follderin i cili përmban fotografitë.
2. Kliko **Order prints online** nga Task Pane.
3. Kompletto hapat në wizard për të porositur kopjet e juaja, dhe kliko **Next** për të lëvizur nga një hap në tjetrin. Hapat varen nga shërbimi që ju keni selektuar, por mund të ndodhë që të kërkohet nga ju të selektoni fotografinë që dëshironi të bëni porosinë (ngjashëm si edhe mënyra e selektimit të fotografive për t'i shtypur), madhësinë e fotografisë (janë të listuara cmimet për madhësi të fotografisë), si dhe informatat për pagesën dhe shërbimin postar. Në hapin e fundit, kliko **Finish** që të porositni fotografitë e juaja.

Në këtë mësim ju keni mësuar përdorimin e paisjeve të fotografive përfshi këtu skenerin dhe kamerën digjitale. Gjithashtu, ju mësuar për disa veçori të fotografive në Windows XP. Mësimi vijues mbulon një tjetër temë interesante, muzika dhe argëtimi.



## MËSIMI 13

# Ekzekutimi i Muzikës

*Në këtë mësim do të mësoni për veçoritë muzikore të Microsoft Windows XP, përfshirë regjistrimin e tingullit përmes Sound Recorder si dhe ekzekutimin e fajllave të zakonshëm muzikor përmes Media Player, nga CD e rëndomtë muzikore.*

### EKZEKUTIMI DHE REGJISTRIMI I TINGULLIT PËRMES SOUND RECORDER

Ju mund t'a përdorni Sound Recorder për të ekzekutuar dhe regjistruar tinguj. Ju mund të regjistroni tingujt e juaj dhe të insertoni fajllat e tingujve në dokumentin e juaj ose t'i bashkangjitni ato në e-mail. Për të përdorur Sound Recorder, ju duhet të keni të instaluar një kartelë zëri si dhe t'i kyçni altoparlantët, të cilët tashmë janë bërë pjesë përbërëse e konfiguracioneve standarde kompjuterike. Për të regjistruar tinguj, ju duhet të posedoni mikrofoni të lidhur fizikisht për kartelën e zërit.

#### EKZEKUTIMI I TINGUJVE

Ndjek këta hapa për të ekzekutuar fajllat e tingujve:

1. Kliko **Start, All Programs, Accessories, Entertainment** dhe **Sound Recorder**. Do të shfaqet dritarja e Sound Recorder.
2. Kliko **File** dhe pastaj kliko komandën **Open**.
3. Kalo në drajvin dhe follderin i cili përmban fajllin e tingullit që ju dëshironi t'a kezekutoni. Shiko Mësimi 5, "Përdorimi i My Computer për të Organizuar Follderat e Juaj" që t'u ndihmojë për orientim ndërmjet follderave.

## KËSHILLË

Provo një Tingull të gatshëm Për të ekzekutuar një tingull të gatshëm nga tingujt e Windows, selekto folderin **Windows\Media..**

4. Kliko dy herë mbi fajllin e tingullit që të hapet ai në Sound Recorder (shiko Figurën 13.1). Pastaj, kliko butonin **Play** për të dëgjuar fajllin.




FIGURA 13.1

*Ju mund t'i ekzekutoni fajllat e tingujve në Sound Recorder.*

5. Kliko butonin **Close** për t'a mbyllur dritaren e Sound Recorder.



## REGJISTRIMI I TINGUJVE

Gjithashtu ju keni mundsinë e regjistrimit të tingujve duke përdorur Sound Recorder. Për të bërë një gjë të tillë, ndjek këta hapa:

## KËSHILLË

Kyçni Mikrofonin e Juaj Për të regjistruar tinguj, ju duhet të keni mikrofoni ose ndonjë paisje tjetër hyrëse të kyçur. Verifikohu përmes sistemit të zërimit për instruksione në lidhje me lidhjen dhe testimin e paisjes.

1. Starto **Sound Recorder**.
2. Kliko **File** dhe pastaj kliko komandën **New**.

3. Kliko butonin **Record**  .
4. Fillo të flasësh në mikrofon që t'a regjistrosësh zërin tënd. Kur të keni përfunduar regjistrimin, kliko butonin **Stop**  .
5. Për t'a ruajtur tingullin e juaj, kliko **File** dhe pastaj kliko komandën **Save As**. Zgjedh follderin, shkruaj emrin e fajllit dhe kliko butonin **Save**. Shiko Mësimi 4, "Puna me dokumentet", për më tepër informatë për sa i përket ruajtjes së fajllave.
6. Kliko butonin **Close** për t'a mbyllur dritaren e Sound Recorder.

## EKZEKUTIMI I NJË CD MUZIKORE

Përveç se keni mundsi të ekzekutoni fajllat me tinguj, ju mund të ekzekutoni edhe CD-et muzikore përmes **Windows Media Player**. Ju mund t'a përdorni këtë vegël mediale për të dëgjuar muzikë në sfond sipas dëshirës, përderisa ju vazhdoni të punoni. Në qoftë se nuk keni investuar në altoparlantë për PC, të kualitetit të lartë, atëherë mos pritni kualitet stereo të shtëpisë.

Për t'a ekzekutuar një CD muzikore, thjeshtë vendoseni atë në lexuesin për CD. Windows Media Player do të duhej të fillonte në mënyrë automatike të ekzekutonte CD (shiko Figurën 13.2). Në qoftë se CD nuk ekzekutohet (atëherë lexuesi i CD suaj nuk është i konfiguruar për Autoplay), kliko **Start, All programs, Accessories, Entertainment**, dhe përfundimisht **Windows Media Player**. Pastaj kliko butonin **Play**.




FIGURA 13.2

*Ju mund të përdorni mekanizamt e kontrollit në dritaren Windows Media Player për të ekzekutuar këngë të ndryshme, të shfaqni vizualitete të ndryshme, si dhe të bëni ndryshime të tjera.*

## PUNA ME WINDOWS MEDIA PLAYER

Dritarja e Media Player ofron disa butona për kontrollim dhe ekzekutim të muzikës si dhe audiove tjera. Ju mund të bëni njërën nga vijueset:

- Për të ekzekutuar këngë të ndryshme, bëni klik të dyfishtë në listën e këngëve, apo për të ekzekutuar këngën vijuese, kliko **Next**. Për të ekzekutuar këngën paraprake kliko **Previous**.



## KËSHILLË

Nuk di se Cili buton është Cili? Në qoftë se nuk jeni i sigurtë se çfarë roli ka ndonjë buton i veçantë, atëherë mbajeni shënjesin e miut mbi të mbrenda kohës prej dy deri në tre sekonda. Emri i butonit do të shfaqet.

- Për të ndryshuar tonin, tërhiq kontrollin e zërimit.
- Për të shfaqur vizualitet të ndryshëm, kliko **Next Visualization** ose **Previous visualization**.



## SHQIPE E QARTË

Vizualiteti Vizualiteti është një grafikë lëvizëse e cili në form vizuele paraqet interpretimin e muzikës.

- Për të ndalur ekzekutimin, kliko **Stop**.
- Për t'a mbajtur së ekzekutuari muzikën, por për të fshehur dritaren e Media Player, kliko butonin e saj **Minimize**.
- Për t'a ndalur muzikën dhe mbyllur Media Player, kliko butonin **Close**.

## PËRDORIMI I VEÇORIVE TË WINDOWS MEDIA PLAYER

Përveç ekzekutimit të rëndomtë, gjithashtu ju mund të përdorni Windows Media Player për disa punë tjera në lidhje me muzikën. Ju mund të bëni secilën punë si në vijim:

- Ju mund t'i kopjoni këngët nga CD në kompjuterine juaj. Pastaj, do të mund t'i ekzekutoni këngët nga kompjuteri e jo nga CD audio. Gjithashtu, ju mund të kopjoni këngët nga kompjuteri në CD, po që se keni CD shkruar ose në ekzekutues të muzikës portativ siç është ekzekutuesi MP3. Përdorë butonat **Copy from CD** dhe **Copy to CD or Device** në dritaren e Media Player në lidhje me këto veçori.



## SHQIPE E QARTË

**MP3** MP3 është një format i fajllit, i cili i referohet fajllave muzikor. Ju mund të gjeni MP3 fajlla në sajta të ndryshëm në Internet. Me anë të një ekzekutuesi MP3, ju mund të kopjoni meloditë në ekzekutuesin e juaj dhe t'a merrni muzikën me vehte, ngjashëm si edhe Sony Walkman. Përveçë fajllave MP3, ju mund të gjeni edhe lloje të fajllave standard të muzikës.

## SHQIPE E QARTË

**WMA** WMA është një format tjetër i famshëm fajllave muzikor, i cili format është i preferuar për paisjet ekzekutuese të Windows

## KUJDES

**Mbrojtja nga Kopjimi** Kur kopjoni fajllat audio, sigurohuni se ju kuptoni rregullativën ligjore për mbrojtje nga kopjimi. Kohëve të fundit, qe prezentë një kontest i madhë në lidhje me sajtin Napster, i cili ofronte muzikë. Përderisa ai sajt akoma sot ekziston, juve nuk do mund të importoni muzikë pa të holla nga ai sajt. Mund të gjeni sajte të tjerë të cilët ofrojnë muzikë pa të holla, njashtu siç edhe mund të gjeni sajte nga të cilët mund të bleni muzikë

- Ju mund të kyçeni në radio stacionin e preferuar, që të dëgjoni muzikë që transmetohet nga shiritat magnetik apo të gjallë, dhe tërë kjo nga kompjuteri juaj. Ju keni mundsinë e zgjedhjes së stacionit nga lista e radio stacioneve, përfshi këtu BBC World, NPR (National Public Radio), Billboard, dhe të tjera. Për të përdorur këtë veçori, ju duhet të keni çasje në Internet. Përdorë butonin e **Radio Tuner** në dritaren e Media Player për të gjetur listën e radio stacioneve (shiko Figurën 13.3).
- Përdorë Media Library për t'i çasur të gjitha përmbajtjet audio, video dhe radio stacionet në kompjuterin e juaj. Ju mund të krijoni lista ekzekutuese në këtë faqe, ashtu si edhe të organizoni përmbajtjen sipas kategorisë. Për shembull, ju mund të renditni fajllat muzikor sipas albumit, apo artistit.

- Ju mund të modifikoni pamjen e dritares së Media Player, duke selektuar **skin** tjetër. Për të bërë një gjë të tillë, klikoni butonin **Skin Chooser** dhe pastaj selektoni nga lista e skin-ve të ndryshëm.




## KËSHILLË

Skin Skin është një shtresë që vendoset mbi një aplikacion për të ndryshuar pamjen se si duket ai.



FIGURA 13.3

Kyçu në radio stacione përmes tabulatorit Radio Tuner në Windows Media Player.



## KËSHILLË

Më Shumë Informatë Për më tepër informata në lidhje me secilën nga këto veçori, konsultoni ndihmën on-line të Windows Media Player. Klikoni **Start, Help and Support**, dhe pastaj klikoni **Music, video, games, and photos**, në listën e temave Pick a Help. Në dritaren tjetër të ndihmës, klikoni **Music and sounds**. Do t'i shifni temat përbrenda këtyre kategorive. Kliko **Using Windows Media Player** dhe pastaj kliko secilën nga temat në dispozicion për të marrë informata më të detajizuara.

- Përdorë Media Guide për të patur çasje tek **WindowsMedia.com** një sajtë medial on-line, ku ju mund të gjeni informatë për muzikën, radiot, filmat, si dhe tema të tjera (shiko Figurën 13.4). Pë të çasur këtë udhëzues on-line, duhet të kenë koneksion në Internet.



FIGURA 13.4  
Përdorë Media Guide për të marrë lajme argëtuese.




## MËSIMI 14

# Përdorimi i Veglave të tjera të Windows XP

*Në këtë mësim, ju do të mësoni për programet e veglave të përfshira në Windows XP. Ju mund t'i gjeni këto mini-aplikacione përmënda menysë Accessories.*

### PËRDORIMI I WINDOWS MOVIE MAKER

Një nga veçoritë e nxehta të punës me kompjuter është realizimi i filmave, me çka Windows XP përmban versionin e risijuar të programit **Windows Movie Maker**, i cili për herë të parë u prezantua në Windows Me. Ju mund t'a përdorni këtë program të veglave për t'i shikuar dhe edituar filmat. Që të realizoni një film të juajin, ju nevojitet një kamerë e cila ka mundsinë e regjistrimit të sekuencave digjitale. Pastaj, ju mund të ç'ngarkoni sekuencën filmike nga kamera juaj në kompjuterin e juaj dhe t'a përdorni Windows Movie Maker për t'a shikuar dhe edituar atë. Gjithashtu, ju keni mundësinë e importimit të tjera sekuencave filmike ose të muzikës për t'i përdorur ato në Windows Movie Maker. Figura 14.1 paraqet një fajll filmik shembull të shfaqur përmes Windows Movie Maker.



### KËSHILLË

Përdorë Help Për informatë më të detajuar në lidhje me të gjitha veçoritë e Windows Movie Maker dhe të secilit program tjetër të veglave, përdorë komandat në menynë Help të programit.





FIGURA 14.1

*Me anë të Windows Movie Maker, ju mund të realizoni , editoni dhe të ekzekutoni fajllat filmik.*

## ARGËTIMI ME LOJRA

Windows ofron disa lojëra të cilat ju mund t'i luani, ashtu që t'a theni paksa angazhimin e madh ne punë gjatë ditës me paksa argëtim. Të lozurit e lojnave gjithashtu paraqet një mënyrë të mirë që të mësoni përdorimin e miut në qoftë se jeni fillestar. Për shembull, të lozurit e **Solitaire** do të ju ndihmon që të praktikoni klikun dhe tërheqjen. Lojnat do të mund t'i gjeni duke klikuar tek **Start, All Programs**, dhe pastaj **Games**. Figura 14.2 paraqet Solitaire.



## KUJDES

Lojrat Nuk Janë Instaluar? Mvarësishtë nga lloji i instalimit që ju keni ekzekutuar, disa nga veçoritë mund të mos jenë instaluar. Ju mund t'i shtoni ato sipas nevojës. Që të bëni një gjë të tillë, kliko **Start, Control Panel**. Kliko kategorinë **Add or Remove Programs** dhe pastaj butonin **Add/Remove Windows Components** në dritaren **Add or Remove Programs**. Zgjedh veçoritë për të instaluar dhe pastaj kliko **Next**. Windows pastaj shton dhe konfiguron komponentet e shtuara. Kjo procedurë vlenë si për lojrat ashtu edhe për opsionet e tjera siç janë veçoritë e faksit, veglat e sistemit, motivet për desktop, si edhe për komponentet e tjera të Windows.




FIGURA 14.2

*Ju mund të luani një nga shumë lojrat e mundshme, përfshirë këtu edhe të popullarizuarën Solitaire.*

## PËRDORIMI I KALKULATORIT

Një nga programet e veglave më të pëlqyera për mua është Kalkulatori. Shumë i lehtë për t'a startuar dhe për të bërë llogaritje. Ju mund t'i shkruani vlerat numerike nga pjesa numerike e tastierës (sigurohuni që **Num Lock** është i aktivizuar) ose klikoni butonat ne kalkulator.

Ju mund të mblidhni, zbritni, shumëzoni, pjestoni, përcaktoni përqindjen, si dhe shumë operacione të tjera mund të kryeni më këtë vegël të përshtatshme e paraqitur në Figurën 14.3.



FIGURA 14.3  
Përdorë kalkulatorin për të kryer kalkulime elementare.

## KUJDES


Më shumë Veçori Që të punoni me një kalkulator më të avancuar shkencëtarisht, hapni **Calculator** dhe pastaj klikoni **View, Scientific**. Kështu ju do keni në dispozicion veçori më të sofistikuar për llogaritje.

## PËRDORIMI I COMMAND PROMPT

Në qoftë se juve e përdorni kompjuterin që moti, atëherë juve jeni i familjarizuar me **prompt** të **DOS**. Mbase do ketë momente kur do paraqitet nevoja që të çasni promptin e DOS nga Windows XP. Për shembull, ju do të dëshironit të ekzekutonit një aplikacion të DOS ose të përdorni komandat e DOS. Në mënyrë alternative, ju mund të posedoni programe (veçanërisht lojra) që ekzekutohen në DOS. Ju do të keni mundsinë e ekzekutimit të secilit program duke shkruar komandën përkatëse të DOS. Windows XP ofron dritaren e Command Prompt që ju do të mund t'a hapni përdorësi punoni me Windows.

Si edhe programet e veglave të tjera, startoni Command Prompt duke klikuar **start, All Programs, Accessories, Command Prompt**.

Shkruaj komandën e dëshiruar dhe shtyp tastin **Enter**. Që t'a mbyllësh dritaren e Command Prompt, kliko butonin **Close** të saj ose shkruaj **EXIT** dhe shtyp tastin **Enter**.



## KUJDES

Ekzekutimi i Programeve të DOS Windows XP nuk përmban kodë të DOS; me çka, përkrahja e aplikacioneve të DOS është e kufizuar. Përderisa shumë aplikacione të DOS do të ekzekutohen, ndodhë që ato mund të mos instalohen si duhet, me çka pastaj do të paraqiten probleme të pajtueshmërisë, në veçanti me programet që përdorin kartelat e zërit.

## PËRDORIMI I WORD PAD

WordPad është një program modest për përpunimin e tekstit, i cili përmban veçoritë elementare për shkruarjen, editimin dhe formatimin e tekstit. Në qoftë se krijoni një dokument të thjeshtë, WordPad do të mund të ju përshtatej shumë mirë. Figura 14.4 paraqet dritaren e WordPad. Që të vendosni tekstin, vetëm filloni të shkruani nga tastiera. Që të bëni formatimin e tekstit të shkruar, përdorni butonat nga shiritat e veglave ose komandat në menynë **Format**. Që të bëni ndryshime të editimit, përdorni komandat nga menya **Edit**.

Në qoftë se dëshironi të ruani dokumentin e juaj, përdorni komandën **File**, **Save As**. Për më tepër informatë për sa i përket ruajtjes së fajllave, shiko Mesimi 4, “Puna me Dokumente.”




FIGURA 14.4

*WordPad është një program aplikativ modes për përpunimin e tekstit i përfshirë në Windows XP.*



## KËSHILLË

Editimi i Fajllave Tekstual Një program tjetër që përdoret për editimin ose shikimin e fajllave të thjeshtë tekstual (.txt) është Notepad. Ju mund t'a startoni këtë program duke klikuar **Start, All Programs, Accessories, Notepad**. Ka më pak opsione të ndërhuara se sa WordPad, por është i mirë gjatë shikimit të fajllave README që zakonishtë ndodhen në programe.

## PËRDORIMI I PAINT

Ju mund t'a përdorni Paint për të krijuar vizatime të thjeshta. Ju mund të vizatoni vija dhe figura, të shtoni tekst, si dhe të ndryshoni ngjyrat. Në qoftë se gaboni, përdoreni gomën për të shlyer pjesët e vizatimit.

Për të filluar vizatimin, kliko **start, All Programs, Accessories**, dhe selektoni **Paint**. Figura 14.5 paraqet dritaren e Paint.



FIGURA 14.5

*Ju mund të ndërtoni diagrame dhe të bëni vizatime të thjeshta përmes Paint.*

Në Paint ju mund të bëni secilën nga vijueset:

- Për të vizatuar një figurë, kliko veqlën në shiritin e veglave. Pastaj klikoje dhe tërhiqe përbrenda hapsirës vizatuese për vizatim të figurave.
- Për të shtuar ngjyrat, ju mund të përdorni veqlën **Fill With Color** ose veqlën **Airbrush**.
- Për të vizatuar një kuti tekstuale, përdorë veqlën **Text** për t'a tërhjekur kutinë tekstuale. Pastaj shkruaj tekstin përbrenda saj. Ju mund të ndryshoni shkronjat, madhësinë e tyre si dhe stilin e tyre (**bold**, *italic* ose underline).
- Në qoftë se keni bërë gabim dhe dëshironi që t'a shlyeni atë që keni shtuar, atëherë ju do mund të përdorni veqlën **Eraser**. Kliko veqlën **Eraser**. Kliko madhësinë që ju dëshironi të ketë **Eraser**. Lëviz shënjesin tek sipërfaqja për vizatim. Mbaje të shtypur butonin e majtë të miut dhe kalo nëpër sipërfaqen që dëshiron t'a shlyesh.
- Në qoftë se dëshironi t'a ruani vizatimin e juaj, përdorë komandën **File, Save As**. Për më tepër informatë në lidhje me ruajtjen e fajllave, shiko Mësimi 4.



## KËSHILLË

Selekto Ngjyrat      Përdorë paletën e ngjyrave (në pjesën e poshtme të dritares Paint) për të selektuar ngjyrat për vijat dhe mbushjet e hapësirave të objekteve. Kliko ngjyron që dëshiron t'a përdorësh për kufijtë. Për mbushjen e hapësirës së objektit me ngjyrë, kliko tastin e djathtë mbi ngjyrën e dëshiruar në mënyrë që të përdoret ajo ngjyrë për mbushjen e sipërfaqes së objektit.

Mënyra më e mirë për të mësuar ndonjërin nga programet e veglave, përfshirë këtu edhe Paint është metoda e eksperimentimit. Gjithashtu, përdorë menynë Help përbrenda programit për të shikuar temat e Help.

Në këtë mësim ju mësuar për disa nga programet e veglave që përdoren zakonishtë. Gjithashtu, ju mund të provoni edhe të tjerë programe të listuar në menynë Accessories. Mësimi vijues sqaron dia nga ndryshimet që ju do keni mundsinë t'i bëni për t'a personalizuar Windows XP.

## MËSIMI 15

# Përshtatja e Desktop të Windows XP



*Në këtë mësim ju do të mësoni se si t'a rregulloni pamjen e Taskbar të Microsoft Windows XP, menysë Start, si dhe Desktop që t'i përshtatet stilit të juaj personal.*

### PËRSHTATJA E TASKBAR

Windows XP ju mundëson që t'a përshtatni Taskbar dhe System Tray (gjithashtu e quajtur zonë e informimit). Që të bëni modifikime, hapni kutinë e dialogut Taskbar and Start Menu Properties duke bërë këta hapa:

1. Kliko tastin e djathtë të miut mbi hapsirën e zbrazët të Taskbar dhe selekto komandën **Properties** nga menya e shfaqur. Do të shfaqet kutia e dialogut Taskbar and Start Menu Properties (shiko Figurën 15.1).
2. Bëje ndonjë ndryshim. Ju mund t'a hapni Taskbar ashtu që të keni mundsi për t'a zhvendosur atë për rrethë. Ju mund t'a fshehni Taskbar ashtu që të keni më tepër hapsirë për desktop. Ju do të mund t'a rishfaqni çdo herë Taskbar duke shënjuar në pjesën e fundme të desktop. Gjithashtu, ju keni mundsinë e fshehjes së orës, të ikonave joaktive, si dhe të bëni ndryshime të tjera.



### KËSHILLË

Jo i Sigurtë në Lidhje me Opcionin? Në qoftë se nuk jeni i sigurtë se çfar bënë një opcion, klikoje atë me tastin e djathtë dhe selekto **What's This** për të shfaqur sqarimet në lidhje me opcionin në fjalë.




FIGURA 15.1

Përdorë këtë kuti dialogu për të përshtatur Taskbar dhe System Tray (ndryshe e quajtur zonë e informimit).

3. Kur të keni mbaruar së bëri me ndyshimet, kliko butonin **OK**.



## KËSHILLË

Zhvendos dhe Rizmadho Gjithashtu, ju mund të zhvendosni Taskbar në një lokacion tjetër përmes desktop si dhe të ndryshoni madhësinë e tij. Për t'a zhvendosur Taskbar, vendosni shënjesin e miut në pjesën e zbrazët të Taskbar dhe tërhiqe atë në lokacionin e dëshiruar. Për t'a rizmadhuar Taskbar, vendos shënjesin e miut në pjesën e kufirit të sipërm të tij dhe tërhiqe për t'a rizmadhuar.

## PËRSHTATJA E MENYSË START

Përveç përshtatjes së Taskbar, ju keni mundsinë e përshtatjes së pamjes së menysë Start. Për shembull, ju do të mund të zgjedhni menynë Classic Start (një nga versionet e mëparshme të Windows) ose ju do të mund të përcaktoni të listoni më shumë ose më pak programe në panelin e majtë. Gjithashtu, ju mund të zgjedhni se ku dëshironi t'i vendosni programet për Internet dhe e-mail, si edhe cilat programe do t'i përdorni për këto komanda.

Ndjek hapat vijues për të bërë ndryshimet:

1. Kliko tastin e djathtë mbi hapsirën e zbrazët të Taskbar dhe selekto **Properties** nga menyja e shfaqur.
2. Kliko tabulatorin **Start Menu**.
3. Nga ky tabulator, kliko **Classic Start menu** në qoftë se e preferoni këtë stil të menysë.
4. Për t'a përshtatur menynë Start të Windows XP, kliko butonin **Customize** pranë këtij opcioni. Do të shfaqet kutia e dialogut të Customize Start Meny të paraqitur si në Figurën.15.2.




FIGURA 15.2

*Ju mund të selektoni pamjen e ikonave, numrin e programeve të listuar, si edhe atë se a doni t'i përfshini programet për Internet dhe e-mail.*

5. Bëje njërën nga vijueset:


Zgjedh që të shfaqen ikonat e mëdha ose të vogla.

Zgjedh numrin e programeve të përdorura së fundi që të listohen në pjesën e majtë të menysë Start.

Për të ç'aktivizuar komandat që startojnë programin e Internetit dhe e-mailit, deselekto opcionet. Për të përdorur programe të tjera

për to, atëherë shfaq listën rënëse pranë llojit të programit dhe pastaj zgjedh programin që do t'a përdorësh.

6. Kliko butonin **OK** që ndryhimet e bëra të kenë efekt.




### KËSHILLË

Më Shumë Opcione të Avancuara      Për më shumë opzione të avancuara, kliko tabin **Advanced** në kutinë e dialogut Customize Start Menu dhe bëji ndryshimet e duhura.

## PËRSHTATJA E DESKTOP

Keni mundsi të shumta për t'a përshtatur desktop. Ju mund t'i përdorni motivet e desktop, të ndryshoni skemën e ngjyrave, të aktivizoni mbrojtësin e ekranit, si dhe të tjera mundsi. Të gjitha këto opzione ndodhen tek kutia e dialogut Display Properties.



### KËSHILLË

Motivet në Desktop      Motivet në desktop përbëhen nga sfondi, tingujt, ikonat si dhe nga elementet tjera. Windows XP ofron motive të shumta të cilat ju mund t'i zgjedhni apo edhe t'i ndërtoni të juajat.

Për të bërë ndonjë nga këto ndryshime, klikoni tastin e djathtë në hapsirën e zbrazët në desktop, dhe selektoni **Properties** nga menya shfaqur. Shfaqet kutia e dialogut Display Properties, së bashku me tabulatorin e Themes. Paragrafet vijuese përshkruajnë ndryshimet më të rëndomta. Ju mund të zgjedhni se cilën dësironi t'a provoni.

Për të bërë një ndryshim, selekto opcionet dhe kliko **OK** për të mbyllur kutinë e dialogut. Për të bërë disa ndryshime, selekto opcionin dhe kliko Apply, që e len kutinë e dialogut hapur me qëllim që të bëni ndryshime tjera. Kur të keni mbaruar me përshtatjen e ekranit, kliko **OK**.

## PËRDORJA E THEMES TË DESKTOP

Për të përdorur Themes në desktop, hap listën rënëse të **Themes** dhe selekto një theme. Theme që e keni sleketuar duket paraprakisht në dritaren për shembuj. Figura 15.3 tregon themes e Windows Classic.




FIGURA 15.3

*Ju mund të vendosni një bashkësi opcionesh, të quajtur motiv.*

## KËSHILLË

Instalimi i Themes të Tjera Në qoftë se theme të cilën doni t'a përdorni nuk ndodhet në në listën rënëse të Themes, selekto ose opcionin **More Themes** ose **Browse** nga lista. Në qoftë se e selektoni **More Themes** atëher do të hapet Web sajt i cili përmban motive; në qoftë se selektoni **Browse** atëherë do të ju mundësoj që të instaloni motive tjera që ju i keni ruajtur me parë ne diskun e ngurtë.

## PËRDORIMI I FOTOGRAFISË SË SFONDIT

Për të vendosur një fotografi të sfondit ose një model në desktop, kliko tabin **Desktop**. Pastaj selekto sfondin që dëshiron të përdorësh. Figura 15.4. paraqet një shembull të zgjedhjes së sfondit (lulja Vjollcë).





FIGURA 15.4

*Përdorni fotografitë e sfondit që desktop të duket më artistik.*



## KËSHILLË

Ekspono Fotografinë Tuaj Në qoftë se do të preferonit që të ekspononi një nga fotografitë e juaja digjitale, atëherë kliko butonin **Browse** në tabin e Desktopit. Në kutinë e dialogut të Browse, orientohu deri tek follderi i cili përmban fotografinë , selektoje atë, dhe pastaj kliko **Open**. Për më tepër informatë në lidhje me orientimin nëpër folldera shiko Mësimi 5, “Përdorimi i My Computer për të Organizuar Follderat e Juaj”. Imazhi është shtuar në listën e zgjedhjeve të sfondit; selektoje atë që t’a përdorësh si sfond.

## PËRDORIMI I SCREEN SAVER

Për t’a aktivizuar mbrojtësin e ekranit, duhet klikuar tabulatorin **Screen Saver**. Pastaj hap listën rënëse tek opcionet e Screen Saver dhe selekto fotografinë lëvizëse që dëshiron t’a përdorësh. Vendors limitin kohor duke përcaktuar atë ke Wait editor (shiko Figurën 15.5). Kur kompjuteri juaj të jetë i papunë gjatë kohës sa është përcaktuar limiti kohor, fotografia e mbrojtësit të ekranit do të paraqitet. Mjafton të lëvizim miun ose të shtypim ndonjë tast nga tastiera dhe mbrojtësi i ekranit do të ndalë aktivitetin e tij në ekran.






FIGURA 15.5

Selekto një fotografi lëvizës që t'a përdorësh si screen saver.

## KËSHILLË

Screen Saver i Domosdoshëm? Jo edhe aq. Në monitorat e vjetër një imazh mund të digjej në monitor në qoftë se i njëjti tekst apo imazh do të kishte qëndruar së ekspozuari për një periudhë kohore më të gjatë. Tek monitorat e rinj kjo nuk paraqet problem. Në përgjithësi, sot, screen saver zakonisht përdoren për argëtim dhe paksa për intimitet. Gjithashtu, të mbani në mend se screen saver shfrytëzon RAM kujtesën dhe resurset e kompjuterit të juaj e që ndikon në performacën e tij.

## MODIFIKIMI I SKEMËS SË NGJYRAVE

Windows XP bënë të mundur ndryshimin e strukturës së ngjyrave të përdorura për disa elemente të caktuara në ekran, siç janë: shiriti i emrit, sfondi, dhe të tjera. Këto bashkësi të ngjyrave quhen *Scheme*, dhe juve keni mundsinë e selektimit të atyre ngjyrave që u përshtaten më së mirë juve dhe monitorit të juaj. Ngjyrat e qelura, për shembull mundësojnë punë më të rehatshme në disa aplikacione të Windows. Në anën tjetër, ju mund të preferoni ngjyra më të ndezura dhe më të gjalla.



## SHOIQE E QARTË

Scheme Skema është një bashkësi opcionesh, siç janë: ngjyrat dhe shkronjat për të gjithë elementet e Windows. Gjithashtu, ju mund të përdorni skemat e tingujve, bashkësitë e tingujve për ndodhi të ndryshme të sistemit.

Për të bërë ndonjë ndryshim, kliko tabulatorin **Appearance**. Hap listën rënëse të skemës së ngjyrave dhe selekto skemën që dëshiron t'a aplikosh. Skema e selektuar do të duket në dritaren shembull (shiko Figurën 15.6).




FIGURA 15.6

*Ndoshta do të jetë vështirë të vërehet dallimi në ngjyrë në këtë figurë bardhë e zi, por figura paraqet llojin e skemës së ngjyrës Maple.*

## PËRCAKTIMI I REZOLUCIONIT DHE I NGJYRAVE


Shumica e monitorëve u mundësojnë selektimin e opioneve të caktuara në lidhje me mënyrën se si punojnë ata, siç është numri i ngjyrave që ata shfaqin në rezolucionin e tyre.



## SHQIPE E QARTË

**Rezolucioni** Rezolucioni është njësi për matjen e pikave ose të elementeve të shfaqura të fotografisë. Një shembull i rezolucionit të zakonshëm është 800x600 ose 1024x768.

Për të bërë ndryshime, kliko tabulatorin **Settings**. Për të ndryshuar rezolucionin, tërhiq shiritin e rezolucionit të Ekranit deri tek niveli i dëshiruar. Për të ndryshuar numrin e ngjyrave për ekranin, kliko listën rënëse **Colors** dhe zgjedh numrin që dëshiron. Windows XP nuk u lejon që të zgjedhni rezolucionin ose thellësin e ngjyrave që kompjuteri i juaj nuk e përkrah, kështu që ndjehuni të lirë të eksperimentoni me këto opsione.



## KËSHILLË

**Troubleshoot** Në qoftë se keni problem me monitorin e juaj, ju mund të startoni **troubleshooter**. Nga tabulatori Settings, kliko butonin **Troubleshoot**, i cili starton Video Display Troubleshooter. Ju mund të selektoni disa nga variantet e problemeve të ndryshme të shfaqjes dhe Windows XP troubleshooter u sugjeron zgjidhjet e mundshme.

Windows XP ofron edhe shumë veçori të tjera të përshtatjes, përfshirë këtu vendosjen e parametrave të miut dhe të tastierës. Megjithatë, ky mësim përmendi ato më të zakonshmet. Mësimi vijues sqaron mënyrën e konfigurimit të programeve në kompjuterin e juaj.



## MËSIMI 16

# Instalimi i Programeve

*Në këtë mësim ju do të mësoni të instaloni programe të reja, t'i shlyeni programet që nuk ju nevojiten, si dhe të shtoni programe në menynë Start.*

### INSTALIMI I PROGRAMEVE

Kur e keni blerë kompjuterin e juaj, mund të ketë ardhur vetëm me disa programe të zakonshme të instaluar në të. Në qoftë se dëshironi të shtoni akoma programe, ju mund të bleni programe shtesë dhe t'i instaloni ato në sistemin e juaj. Programe të ndryshme kërkojnë edhe proces të ndryshëm të instalimit. Për këtë, mënyrat e instalimit dallojnë nga një program në tjetrin. Veçoria e Microsoft Windows XP, Add or Remove Programs ju mundson të startoni proceset e instalimit si nga CD-ROM ashtu edhe nga floppy disketa. Pastaj mund t'i ndiqni hapat e instalimit të programeve të juaja.

Ndjek këta hapa për të instaluar një program të ri:

1. Kliko butonin **Start** dhe pastaj klikoni **Control Panel**.
2. Kliko **Add or Remove Programs**. Do të shohësh dritaren e Add or Remove Programs (shiko Figurën 16.1).
3. Kliko butonin **Add New Programs**.
4. Kliko butonin **CD ose Floppy**.
5. Inserto CD-ROM apo flopi disketën e programit dhe kliko **Next**. Windows XP kontrollon flopi disketën, si dhe diskun pastaj, për të gjetur programet instaluese. Pastaj në menyre automatike selekton fajllin e përshtatshëm, i cili është i listuar në kutinë e dialogut Run Installation Program (shiko Figurën 16.2).




FIGURA 16.1

Përdorë këtë veçori të Control Panel për të ndryshuar ose larguar programet, instaluar programe të reja, ose të shtosh apo të largosh komponente të Windows.





FIGURA 16.2

Kliko **Finish** për të ekzekutuar fajllin instalues zakonisht i quajtur *install* ose *setup*.


6. Kliko **Finish**. Çfar ndodhë më tutje mvaret nga software që ju instaloni; ndjek udhëzimet në ekran. Zakonisht juve pyeteni për llojin e instalimit (pjesërisht, i plotë, me mundsi zgjedhjeje

apo edhe të tjerë) si dhe në cilin vend në diskun e juaj të ngurtë të instaloni programin. Në qoftë se jeni të pasigurtë se çfarë po bëni zakonisht është më së miri të ndjekni opcionet e paradefinuara që ofron procesi i instalimit të programit. Pas gjithë këtyre hapave do të instalohet programi, dhe i cili në fund zakonisht shton ikonën e programit në menynë Start.



### KËSHILLË

**Instalimi Automatik** Shumica e programeve të reja përmbajnë tiparin si Autorun. Porsa të keni vendosur CD në lexuesin e saj, në mënyrë automatike vetë ekzekutohet fajlli për instalimin e programit (përveç rasteve kur drajvi juaj nuk e përkrah tiparin Autorun ose ky tipar të jetë jo aktiv.



### KËSHILLË

**Përdore Komandën Run** Në qoftë se kjo procedurë nuk punon, atëherë mund të përdorësh komandën Run për të ekzekutuar instalimin e programit. Vendos CD ose disketën në drjavin adekuat dhe pastaj kliko butonin **Start** dhe kliko komandën **Run**. Shkruaj shtegun dhe emrin e programit për të filuar procesin e instalimit të programit dhe kliko **OK**. (Në qoftë se nuk din emrin e programit apo shtegun etij, kliko butonin **Browse** dhe përdorë kutinë e dialogut të Browse për t'a gjetur fajllin. Gjej fajllin e quajtur Setup apo Install.). Ndjek udhëzimet në ekran.

## INSTALIMI I RISIVE TË WINDOWS

Nga kutia e dialogut Add or Remove Programs, ju mund të lidheni tek sajti online për upgrade i Microsoft dhe të ç'ngarkoni ndonjë risi të re të programit. Në mënyrë periodike, Microsoft shton risit e Windows, përfshirë edhe arrnimet për ndonjë gabim të lëshuar në program.



## KËSHILLË

Bug dhe Patch Bug është një problem në kodin e softwarit i cili shkakton probleme. Patch është një copë e vogël e kodit programues e cila riparon bug.

Ju mund të klikoni butoni **Windows Update** për të kontrolluar për ndonjë risi të re. Pastaj ju mund të selektoni për t'i ç'ngarkuar nga Interneti dhe instaluar ato. Ju mundeni gjithashtu të selektoni komandën Windows Update nga menya Start, nën All Programs.

## INSTALIMI I KOMPONENTEVE TË WINDOWS

Përveç instalimit të risive të Windows, mund të paraqitet nevoja që të shtoni ose largoni komponente të Windows. Mvarësisht nga lloji i instalimit që ju keni bërë gjatë instalimit të Sistemit Operativ, mund të ketë ndodhur që ju nuk keni instaluar komponentet e duhura (siç është ajo për Faks). Ose, për të kursyer hapsirë në diskun e ngurtë juve u duhet të largoni komponentet që nuk i përdorni.

Për të bërë ndryshime në komponentet e Windows, ndjek këta hapa:

1. Kliko butonin **Start**, dhe pastaj kliko **Control Panel**.
2. Kliko **Add or Remove Programs**. Ju shifni dritaren e Add or Remove Programs (shiko Figurën 16.1).
3. Kliko butonin **Add/Remove Windows Components**. Do të paraqitet Windows Components Wizard (shiko Figurën 16.3). Komponentet që janë të selektuara janë të instaluara. Ju mund t'i deselektoni komponentet për t'i larguar nga setapi i juaj. Gjithashtu, ju mund të selektoni çdo component për t'a shtuar atë në setapin e juaj.
4. Seleкто ose deseleкто komponentet dhe pastaj kliko **Next**. Inserto CD e Windows në CD-ROM nëse kërkohet një gjë e tillë. Windows instalon komponentet e reja ose largon çdo component që juve e keni selektuar për t'a larguar. Kliko **Finish** për të përmbyllur wizard.





FIGURA 16.3

*Selekto komponentet që dëshiron t'i shtosh apo t'i largosh.*

## DEINSTALIMI I PROGRAMEVE

Në qoftë se nuk e përdorë programin, ju mund t'a largoni atë nga sistemi. Në këtë mënyrë ju lironi hapsirë në diskun e ngurtë. Thjeshtë ju mund të shlyeni fajllat e programit, por këta fajlla jo gjithmonë ruhen në një lokacion. Ndodh që gjatë instalimit programi të ketë vendosur fajllat në vende të tjera në diskun e ngurtë të juajin. Në vend të kesaj, deinstaloni programin duke përdorur Add or Remove Programs nga Control Panel. Në këtë mënyrë ju largoni programin dhe të gjithë fajllat dhe follderat që kanë të bëjnë me atë program nga disku juaj i ngurtë.



### KËSHILLË

Kontrollo Fajllat e Dokumentit Në qoftë se keni folldera që përmbajnë dokumentet e juaj dhe ata ndodhen përmbrenda follderave të programit, sigurohuni që t'i largoni nga aty në ndonjë follder apo drajv tjetër ashtu që ato të mos shlyhen me programin.

Ndjek këta hapa që të deinstalosh një program:

1. Kliko butoni **Start**, dhe pastaj kliko **control Panel**.
2. Kliko **Add or Remove Programs**. Paraqitet dritarja e Add or Remove programs (shiko Figurën 16.1).



3. Kliko butonin **Change or Remove Programs**.
4. Selektto programin që dëshiron t'a largosh (shiko Figurën 16.4). Pastaj kliko butonin **Remove**. Windows XP pastaj e largon këtë program. Hapat ndryshojnë nga programi në program. Thjeshtë ndjek udhëzimet në ekran.




FIGURA 16.4

*Ju mund të gjeni informacion në lidhje me atë se sa shpeshë programi është përdorur, ashtu si edhe largimi i tij nga kjo faqe e Control Panel.*

## KËSHILLË

**Deinstalo Programe** Ju mund të bleni programe të cilët mbajnë shënim për programet e instaluar, ku ndodhen ato programe në diskun e ngurtë, si dhe çfarë ndryshimesh i kanë bërë ato programe sistemit të juaj. Ju mund të përdorni këto programe për të deinstaluar programe të cilët nuk ndodhen në dritaren e Add or Remove Programs të Control Panel.

## IKONË ME ÇASJE TË SHPEJTË E PROGRAMIT

Ju mund të realizoni ikona me çasje të shpejtë të programve dhe t'i vendsoni ato në desktop për të patur një çasje më të shpejtë deri tek programet. Pastaj me anë të klikut të dyfishtë mbi këto ikona t'i startoni shumë shpejtë programet.




### KËSHILLË

Shortcut të Fajllave dhe Follderave    Ju mund të ndiqni këta hapa të njëjtë që të krijoni ikonë me çasje të shpejtë të fajllit apo follderit. Kur të keni bërë klik të dyfishtë tek ikona e fajllit, fajlli do të hapet në programin që e shoqëron. Për shembull, në qoftë se keni bërë klik të dyfishtë mbi një fajll të Word, dokumenti hapet dhe njëkohësisht Word startohet. Në qoftë se bëni klik të dyfishtë mbi ikonën e follderit, hapet dritarja e atij follderit.

Ndjek këta hapa për të krijuar një çasje të shpejtë të programit.

1. Shfaq fajllin e programit të cilit dëshiron t'i bësh ikonë me çasje të shpejtë. Për ndihmë në lidhje me orientimin nëpër drajvat dhe follderat, shiko Mësimi 5, "Përdorimi i My Computer për të Organizuar Follderat e Juaj". Gjithashtu ju mund të kërkonit fajllat (siç është sqaruar në Mësimi 7, "Gjetja e Fajllave").
2. Kliko fajllin me tastin e djathtë të miut dhe pastaj kliko komandën **Send To**. Nga nënmenyja, kliko komandën **Desktop (create shortcut)** (shiko Figurën 16.5). Windows vendos ikonën me çasje të shpejtë në desktopin e juaj.



### KËSHILLË

Riemërto Shortcut    Windows XP përdorë emrin e fajllit të programit për emrin e ikonës me çasje të shpejtë. Ju keni mundsinë e ndryshimit të këtij emri në një emër më përshkrues. Për të bërë një gjë të tillë, klikoni tastin e djathtë mbi ikonën me çasje të shpejtë dhe selektoni **Rename**, shkruani një emër të ri dhe klikoni **Enter**.

Në qoftë se desktopi i juaj bëhet i stërngarkuar me ikona me çasje të shpejtë, ju mund t'i shlyeni ato. Për të bërë një gjë të tillë, klikoni tastin e djathtë mbi ikonën e shortcut-it dhe selektoni komandën **Delete**.

Kliko butonin **Yes** për të shlyer ikonën me çasje të shpejtë. Shlyerja e ikonës me çasje të shpejtë nuk e shlyen programin nga disku juaj i ngurtë. Për t'a fshirë programin ju duhet t'a deinstaloni atë. Shiko paragrafin “Deinstalimi i Programeve” më lartë në këtë mësim.




FIGURA 16.5

*Përdorë menynë e realizimit të ikonave me çasje të shpejtë për të bërë ikona të tilla për fajlat dhe programet.*

## KËSHILLË

Pastroni Desktop Windows XP përmban veçorinë për largimin automatik të ikonave të papërdorura në desktop. Për të patur çasje deri tek kjo veçori, klikoni tastin e djathtë mbi hapsirën e zbrazët të desktop dhe selekto Properties. Kliko tabin **Desktop** dhe pastaj butonin **Clean Desktop Now** për të filluar Desktop Cleanup Wizard. Ndjek hapat në wizard për të parë dhe konfirmuar largimin e ndonjëres nga ikonat e papërdorura në desktop.

## NGJITJA E PROGRAMIT NË MENYNË START


Kur ju instaloni programe, shumica prej tyre vendosen në mënyrë automatike në menynë Start. Në qoftë se programi nuk është shtuar gjatë procesit të instalimit, ju mund t'a shtoni atë vetë. Windows XP ju mundson që të bëni “ngjitjen” e programit në menynë Start.

Ndjek këta hapa:

1. Shfaq fajllin e programit të cilit dëshiron t'i krijosh ikonë me çasje të shpejtë. Për ndihmë rreth orientimit nëpër drajva dhe folldera shiko Mësimi 5. Ju gjithashtu mund të kërkoni fajllin (shiko Msimi

7 “Gjetja e Fajllave” ). Në qoftë se programi është i listuar në menynë Start, thjeshtë ju mund t’a shfaqni listën e programit.

2. Kliko me tastin e djathtë ikonën e programit dhe kliko komandën **Pin to Start menu** (shiko Figurën 16.5). Programi është shtuar në menyn e juaj Start.



## KËSHILLË

Zhvendosni Programin Kur t’i keni bërë “ngjitjen” një programi për menynë Start, atëherë ai është vendosur në panelin e majtë të menysë. Ju mund t’a tërhiqni programin e “ngjitur” në follderat si: My Documents, My Pictures, ose në My Music, por aksund tjetër përmbrenda menysë Start.

Në këtë mësim ju mësuat se si të instaloni dhe deinstaloni programet. Gjithashtu, mësuat se si të siguronit çasje më të shpejtë deri tek programet, përmes realizimit të ikonave me çasje të shpejtë ose përmes :ngjitjes” së programit për menynë Start. Mësimi tjetër mbulon temat e zgjidhjes së problemeve dhe mirëmbajtjes.

## MËSIMI 17

# Mirëmbajtja e PC së Juaj



*Në këtë mësim ju do të mësoni të kryeni detyrat e mirëmbajtjes (e evitimit të problemeve) si edhe mënyrën e zgjidhjes së problemeve.*


### RISTARTIMI DHE FIKJA E KOMPJUTERIT

Në qoftë se kompjuteri i juaj bllokohet, një nga detyrat e para është të provohet të ristartohet. Ristartimi i kompjuterit mund të ndodh që kërkohet të bëhet edhe gjatë ndryshimeve në sistem; me çka përmes ristartimit ndryshimet e bëra do të kishin efekt.

Gjithashtu, me qëllim të evitimit të defekteve, ju duhet të tentoni të fikni siç duhet kompjuterin para se të bëni fikjen manuale. Në këtë mënyrë neve i japim hapsirë Microsoft Windows XP që të kryen të gjitha punët e duhura pas-skenës para se të fiket kompjuteri.

Për t'a ristartuar ose fikur kompjuterin, ndjek këta hapa:

1. Kliko butonin **Start**.
2. Kliko butonin **Turn Off computer**.
3. Selektu **Restart** për t'a ristartuar kompjuterin, ose selektu **Turn Off** për t'a fikur kompjuterin. Në qoftë se keni selektuar që të ristartohet, kompjuteri do të ristartohet, Në qoftë se keni selektuar turn off, kompjuteri do të fiket dhe së bashku me të do të ndërpritet edhe rryma. (Disa PC më të vjetër mund të shfaqin në ekran mesazhin i cili do t'u thotë që tani është i gatshëm për tu fikur; me çka pastaj juve duhet manualisht të ndërpritni rrymën.)



## KËSHILLË

**Hibernate** Për t'a vendosur në gjumë kompjuterin në mënyrë që të kursej energji, kliko butonin **Hibernate** . Çdo gjë që ndodhet në kujtesën e kompjuterit ruhet në diskun e ngurtë. Kur t'a keni "zgjuar" nga gjumi, të gjitha programet dhe dokumentet që kanë qenë hapur do të restaurohen. Në përgjithësi hibernate përdoret më së shumti tek laptopat, për faktin që e ulë mundsinë e e PC për t'u fikur dhe startuar përsëri.

## PËRDORIMI I HELP

Ju mund të përdorni komandën **Help** të Windows për të marë ndihmë për temat e rëndomta. Ju mund të selektoni nga lista e temave, përfshirë edhe startimin e zgjidhjeve të problemeve që ju ndihmon të gjeni me saktësi problemet dhe duke ju ofruar sugjerime të mudshme.

Ndjek këta hapa për të përdorur Helpin:

1. Kliko butonin **Start**.
2. Kliko **Help and Suport**. Paraqitet dritarja e Help and Support Center (shiko Figurën 17.1).
3. Kliko temën e dëshiruar nga Help. Për shembull, selekto **Fixing a problem**. Do të vëresh temat e ndërlidhura.
4. Kliko nëntemën e dëshiruar. Paneli i djathtë liston temat e përshtatshme të Help. Figura 17.2, paraqet temat për problemet e shtypsit.
5. Kliko temën e dëshiruar. Kur të keni përfunduar me rishqyrtimin e informacionit të Help, kliko butonin **Close** të dritares së Help.

## KËSHILLË

Gjurmimi për Ndhmë Si aleternativë e kërkimit të përmbajtjes, ju mund të gjurmoni për ndihmë. Shkruaj temën në kutinë e kërkimit dhe shtyp **Enter**. Temat koiciduese janë listuar në panelin e majtë të Search Results. Ju mund të klikoni çdo njëjërën nga temat koiciduese në këtë panel për të shfaqur temat e ndërlidhura të Help në panelin në anën e djathtë.




FIGURA 17.1

Ju mund të merrni ndihmë gjithpërfshirëse nga manuali i Help të Windows, njashtu si edhe nga burimet on-line.




FIGURA 17.2

*Përdorë Help të Windows për të marrë informatë të detajzuar në lidhje me veçoritë, njashtu edhe për këshillat e zgjidhjes së problemeve.*

## SHFAQJA E VETIVE TË SISTEMIT

Kur jeni duke zgjidhur ndonjë problem, ndonjëherë u duhet të shfaqni informatat në lidhje me sistemin e juaj. Një vend me të cilin mund të filloni është vetitë e sistemit të juaj. Këtu ju mund të çasni Add Hardware Wizard, të shfaqni Device Manager si dhe të tjera. Për të shfaqur vetitë e sistemit, hapni menyën Start, bëni klik të djathtë mbi **My Computer** dhe pastaj kliko komandën **Properties**. Pastaj mund të klikoni çdonjërin nga tabulatorët në dispozicion. Figura 17.3 paraqet tabin e Hardware të kutisë së dialogut të System Properties.





FIGURA 17.3

Merrni informatë për sistemin e juaj nga kutia e dialogut të System Properties.

## KËSHILLË

Më Tepër Informatë Teknike Për më tepër informatë teknike përfshi këtu edhe informatat në lidhje me konfigurimet e hardware, komponentet e kompjuterit, si dhe software, shfaq System Information. Për të bërë një gjë të tillë, kliko **Start, All Programs, Accessories, System Tools, System Information**. Kliko cilëndo nga kategoritë e listuara për të parë informacion të përafërt.

## SHFAQJA E INFORMTAVE TË DISKUT

Ju mund të shfaqni informatat për disqet, siç është madhësia, sasia e hapsirës së okupuar, si dhe sasia e hapësirës së lirë. Gjithashtu, ju mundeni t'i çasni veglat e sistemit nga kjo dritare.

Ndjek këta hapa për të shfaqur informatat për disqet:

1. Hap ikonën **My Computer**. Mund të klikosh **Start, My Computer**. Ose në qoftë se e ke vendosur ikonën e My Computer në desktopin e juaj, ju mund të bëni klik të dyfishtë mbi të.

2. Në dritaren e My Computer, kliko tastin e djathtë mbi diskun për të cilin dëshiron të marrësh informatë dhe kliko komandën **Properties**. Kutia e dialogut të Properties të diskut shfaqet. Në tabulatorin General, i paraqitur në Figurën 17.4, ju mund të shifni totalin e hapsirës së zbrazët, hapsirën e përdorur të diskut si dhe hapsirën e lirë.




FIGURA 17.4

*Ju mund të shikoni informatat e diskut nga kjo kuti e dialogut.*

3. Kliko butonin **OK** për të mbyllur kutinë e dialogut.

## PËRDORIMI I VEGLAVE TË DISKUT

Në kutinë e dialogut Local Disk Properties të paraqitur në Figurën 17.4, vëreni tabulatorin Tools. Ju mund të klikoni këtë tab për të parë veglat për punë me diskun e juaj të ngurtë. Për shembull, ju mund të kontrolloni diskun për gabime dhe t'a defragmentoni diskun përmes këtij tabi.

### KONTROLLIMI I DISKUT PËR GABIME

Nganjëherë, pjesë të diskut të juaj ndodhë të dëmtohen, kështu që në ekran do të shifni mesazhin për gabime në rastet kur ju dëshironi të

hapni apo të ruani fajll nga/në disku i juaj. Ju mund të bëni skenimin e diskut për gabime dhe t'i rregulloni gabimet. Për të kontrolluar për gabime, kliko butonin **Check Now** në tabin Tools (shiko Figurën 17.5). Ju mund të zgjedhni që gabimet të riparohen ose në menyrë automatike ose gjatë procesit të skenimit, skenimi të kontrollon dhe riparon sektorët e dëmtuar. Kliko **Start** për të filluar kontrollimin.

Në qoftë se Check Disk detekton gabimin, paraqitet kutia e dialogut e cila sqaron gabimin. Lexo mesazhin e gabimit dhe zgjedh opcionin qe dëshiron të ekzekutosh. Kliko **OK** për të vazhduar. Bëje këtë për secilin mesazh.




FIGURA 17.5

*Kontrollo diskun për gabime ose bëji defragment diskut duke përdorur butonat e këtij tabi.*

## KËSHILLË

Skenimi pas Ristartimit      Në qoftë se nuk e ke fikur si duhet kompjuterin, atëherë Check Disk ekzekutohet në mënyrë automatike kur të ristartoni kompjuterin.

## DEFRAGMENT I DISKUT

Kur të jetë ruajtur në diskun e juaj të ngurtë, Windows vendos sa të jetë e mundur fajlla në sektorin e parë në dispozicion (i quajtur **cluster**), dhe pastaj kalon në cluster tjetër për të vendosur pjesën tjetër të fajllave.

Fillimisht, kjo ruajtje nuk shkakton probleme në performansë, por me kalimin e kohës fajllat e juaj të diskut bëhen të shkëputur; që do shprehet në konsumim të madh të kohës gjatë hapjes së fajllit ose startimit të programit. Për t'a shpejtuar çasjen deri tek fajllat si dhe për të evituar problemet e mundshme me fajllat e fragmentuar, ju mund të përdorni Disk Defragmenter për t'i bërë defragment diskut tuaj, duke i vendosur fajllat në cluster sa të jetë e mundshme më afër njëri tjetrit. Bërja defragment diskut, paraqet një nga punët më të zakonshme që ju duhet t'a kryeni çdo herë në disa muaj për rezultate më të mira.

Ju mund të startoni këtë vegël nga tabi Tools (referoju Figurës 17.5). Ju mund te selektoni drajvin të cilin dëshironi t'a kontrolloni dhe të filloni procesin e defragmentimit (shiko Figurën 17.6).





FIGURA 17.6

*Përdorë Disk Defragmenter për t'i bërë defragment drajvit me qëllim të përmirësimit të performacës së tij.*



## KËSHILLË

**Bëje Një Analizë** Para se të bëni defragment, analizoni diskun duke klikuar butonin **Analyze**. Analiza do ju jep rekomandime. Për faktin që defragment merr shumë kohë, andaj mos e bëni atë në qoftë se nuk është e rekomanduar.

Disk Defragmenter mund të merr një kohë të gjatë përderisa bënë defragment diskut, kjo mvarësishtë nga kapaciteti i diskut, nga numri dhe madhësia e fajllave në të, shtrirja e fragmentimit në disk, si dhe resurset e sistemit në dispozicion. Progresi i Disk Defragmenter tregohet përmes shiritit të progresit në dritaren e Disk Defragmenter. Kliko **View Report**. Kutia e dialogut të Defragmentation Report shfaq informatat e detajizuara për diskun i cili është bërë defragment. Kliko butonin **Close** për të mbyllur raportin, dhe pastaj dritaren e Defragmenter.

## PËRDORIMI I SYSTEM RESTORE

Në qoftë se shtoni programe apo hardware të ri, mund të ndodhë që sistemi i juaj të mos punoj si duhet. Tentativa për të zgjidhur këtë lloj të problemit është shumë e vështirë. Për të dal në ndihmë, Windows XP përmban në vete System Restore, të cilin ju mund t'a përdorni për t'u kthyer mbrapa tek gjendja paraprake e sistemit e cila punonte. Përdorimi i System Restore bënë të mundur të shpëtojë punën aktuale, siç janë: dokumentet e ruajtura, mesazhet e e-mailit, listën e historisë, apo listën e favoriteve.

Në vend që të mbështeteni në bërjen e kopjeve rezervë (back up), System Restore monitoron ndryshimet në sistemin e juaj si dhe krijon **restore points** çdo ditë në mënyrë të paradefinuar. Ekzistojnë dis lloje të *restore points*:

- *Initial system checkpoint* krijohet herën e parë kur ju startoni kompjuterin pasi që Windows XP të jetë instaluar (mos e selektoni këtë *restore point* përderisa nuk dëshironi të shlyeni gjithcka në kompjuterin e juaj që nga instalimi i Windows XP).
- *System checkpoints* krijohen nga Windows çdo 24 orë, dhe në çdo 10 orë kur kompjuteri juaj është ndezur.
- *Program name installation restore points* krijohen në mënyrë automatike kur ju instaloni program duke përdorur njërën nga instaluesit më të fundit (më modern). Selektto këtë *restore point* për të larguar programet e instaluara dhe parametrat e regjistrave.
- *Manually created restore points* janë ato *restore points* që ju vetë i krijoni (shiko hapat tjerë).

- *Restore operation restore points* gjurmon operacionet e rivendosjes vetë, duke ju mundësuar që t'i zhbëni ato.
- *Unsigned driver restore points* krijohen çdo kohë kur System Restore përcakton se ju jeni duke instaluar një drajver të pa regjistruar ose i pa verifikuar.

Ndjek këta hapa për të përdorur System Restore:

1. Kliko butonin **Start**, kliko **All Programs, Accessories, System Tools, System Restore**. Hapet dritarja e System Restore (shiko Figurën 17.7).




FIGURA 17.7

*Dritarja e System Restore jep informatë të detajuar për sa i përket përdorimit të kësaj veçorie.*

2. Bëni një të një nga vijueset:

Për të krijuar një *restore point*, klik **Create a restore point**, dhe pastaj kliko **Next**. Shkruaj emrin e *restore point* dhe kliko **Create**.

Për t'u kthyer mbrapa në *restore point* të mëhershëm, kliko **restore my computer to an earlier time**. Selektu datën në kalendar dhe selektu *restore point*. Ndjek instruksionet vijuese në ekran, duke klikuar **Next** ju ecni nga hapi në hap. Sigurohu që të lexosh secilin sqarim me kujdes në mënyrë që ju të kuptoni atë që do të ndodhë.

Në këtë mësim ju mësuat për disa veçori të rëndësishme të mirëmbajtjes dhe të zgjidhjes së problemeve eventuale në Windows XP. Mësimi i ardhshëm sqaron përdorimin e Windows XP nga më shumë përdorues dhe përdorimi i tij në rrjetën shtëpiake.



## MËSIMI 18

# Konfigurimi i Windows për Përdorues të Shumfishtë dhe për Rrjetë

*Në këtë mësim ju do të mësoni të bëni konfigurimin e Microsoft Windows për përdorues të shumfishtë. Gjithashtu, do të fitoni një pasqyrë të veçorive të rrjetit shtëpiak në Windows XP.*

### KONFIGURIMI I WINDOWS PËR PËRDORUES TË SHUMFISHTË

Në qoftë se më shumë se një person e përdorë PC e juaj, ju keni mundsinë e personalizimit të disa parametrave të Windows për secilin përdorues. Për shembull, ju mund të përshtatni Desktop Properties, menynë Start, follderin Favorites, follderin My Documents, dhe të tjera. Secili përdorues mund të bëjë një përshtatje të parametrave të Windows sipas mënyrës që ai dëshiron dhe pastaj të krijojë llogari të përdoruesit. Çdo herë që përdoruesi logohet, të gjitha përshtatjet e bëra hyjnë në aplikim.

#### LLOGARIA E RE

Ndjek këta hapa për të bërë një llogari të re:

1. Përshtate Windows ashtu si dëshiron
2. Kliko **Start** dhe pastaj kliko **Control Panel**.
3. Kliko **User Accounts** në dritaren e Control Panel. Çdo llogari që e ke krijuar është e listuar (shiko Figurën 18.1).






FIGURA 18.1

Ju mund të përdorni këtë opcion të Control Panel për të modifikuar llogarit ekzistuese dhe realizoni llogari të reja.

4. Kliko lidhjen **Create a new account**.
5. Shkruaj emrin për llogarinë dhe kliko butonin **Next**.
6. Zgjedh llojin e llogarisë që dëshiron të ndërtosh: Computer administrator ose Limited. Kur të keni zgjedhur llojin e llogarisë, ju do të vëreni përshkrimin e gjërave që mund dhe nuk mund t'i bëjë kjo llogari. Kliko butonin **Create Account**. Llogaria e re është shtuar.

## KËSHILLË

Zgjedh një Administrator të Kompjuterit      Është mirë që një përdorues të jetë adminstrator i kompjuterit. Ky person mund të krijoj llogari të reja si dhe të modifikojë dhe shlyej llogaritë ekzistuese. Për të gjitha të tjerat, konsideroni t'i bëni ato llogari të limituara ashtu që këta përdorues të mos ngatroheshin me të tjerat llogari.

## MODIFIKIMI I LLOGARISË

Ju mund të bëni ndryshime në llogaritë ekzistuese, për shembull specifikimin e fjalës kaluese për atë llogari, ndryshimin e fotografisë dhe kështu me rradhë. Për t'a bërë këtë, kliko llogarinë në dritaren e User Accounts. Pastaj përdorë njërën nga komandat e paraqitura në Figurën 18.2 për të bërë vijuesen:




FIGURA 18.2

*Ju mund të bëni ndryshime në llogarin ekzistuese në dritaren User Accounts.*

- Për të ndryshuar emrin e llogarisë, kliko **Change the name**, shkruaj emrin e ri dhe pastaj kliko butonin **Change Name**.
- Për të vendosur një **password** për këtë llogari, kliko **Change a password**. Shkruaj fjalën kaluese që dëshiron t'a përdorësh dhe shkruaje përsëri atë për konfirmim. Shkruaj një **hint** për të të ndihmuar të rikujtosh fjalën kaluese duke të shfaqur një etiketë të dukshme gjatë procesit të logimit në Windows, si dhe pastaj kliko butonin **Change Password**.
- Për të përdorur fotografi tjetër për llogarinë, kliko **Change the picture**. Pastaj selekto njërën nga fotografitë në dispozicion. Ju

gjithashtu mund të klikoni **Browse for more pictures** për të zgjedhur një fotografi tjetër (për shembull nga follderi i fotografive) që ndodhen të vendosura në lokacion tjetër. Pasi të keni zgjedhur fotografën kliko **change Picture**.

- Për të ndryshuar llojin e llogarisë, kliko **Change the account type**. Pastaj ju mund të zgjedhni ose administratorin e kompjuterit ose përdoruesin e kufizuar. Kur të keni zgjedhur njërin nga opsionet, Windows XP shfaq përshkrimin e atij lloji të llogarisë.
- Për t'a shlyer një llogari, kliko **Delete the account**. Përcaktohu se a dëshiron t'i mbash apo shlyesh fajllat e llogarisë. Pastaj kliko butonin **Delete Account**.


## LOGIMI DHE Ç'LOGIMI

Në qoftë se keni konfiguruar llogaritë, ju vëreni emra llogarishë të ndryshme kur e kyçni kompjuterin e juaj. Ju mund të klikoni në llogarinë e juaj për t'u loguar. Gjithashtu, mund të kaloni nga një llogari në tjetrën. Kur të keni kaluar nga një llogari në tjetrën, të gjitha programet e hapur mbesin të hapur. Kur të ç'logoheni çdo gjë mbyllet. Për t'u loguar ose ç'loguar ndjek këta hapa:

1. Kliko butonin **Start** dhe kliko **Log Off**.
2. Kur të pyeteni se a jeni të sigurtë se dëshroni të ç'logoheni , kliko butonin **Log Off**.
3. Gjatë procesit të logimit do të kërkohet nga ju të zgjedhni përdoruesin, atëherë ju klikoni tek përdoruesi që dëshiroheni të logoheni.

## BAZAT E RRJETËS SHTËPIAKE

Në qoftë se në shtëpinë e juaj ka më shumë se një kompjuter (njëri i pajisur me Windows XP, si dhe të paktën një tjetër i pajisur me XP/2000, Windows Me ose Windows 9x), atëherë ju mund t'i lidhni fizikisht ata ashtu që të realizoni një rrjetë shtëpiake. Duke vepruar kështu ju ndani lidhjen në Internet, paisjet hardware (siç është shtypsi, skeneri dhe të tjera) si dhe fajllat dhe follderat. Lidhja e kompjuterave në rrjetën shtëpiake gjithashtu u mundëson atarëve të familjes suaj të luani lojra në më shumë kompjutera.



## KËSHILLË

Çasja e Internetit dhe Rrjetat Në qoftë se keni ralizuar një rrjetë dhe dëshironi që të gjithë kompjuterat e lidhur në atë rrjetë të kenë çasje në Internet, atëherë keni dy mundësi. E para është të zgjedhni kompjuterin nikoqir me Windows XP dhe t'a ndani lidhjen e Internetit me të tjerë kompjutera në rrjetë. Mënyra e dytë është të përdorni paisjen e quajtur **router**, që bënë shpërndarjen e koneksionit tuaj të internetit deri tek të gjithë kompjuterat në rrjetën e juaj pa patur nevojë që një nga ata kompjutera të luaj rolin e nikoqirit.

Realizimi i rrjetës shtëpiake kërkon përbushjen e tre hapave: planifikimin e rrjetit tuaj, instalimin dhe konfigurimin e hardware të nevojshëm në secilin kompjuter në rrjetë si dhe ekzekutimin e Windows XP Network Setup Wizard në secilin kompjuter. Megjithëse, shpjegimet e hollësishme të hapit të parë dhe të dytë nuk janë detyrë e këtij libri, ju mund të gjeni informata të shumta në menynë Help të Windows XP (kliko lidhjen **Networking and the Web** në faqen Help and Support).

Kur planifikoni rrjetën e juaj, ju duhet të përcaktoni çfarë lloji të rrjetit dëshironi të realizoni (Ethernet, HPNA apo linjë telefonike shtëpiake ose pa tela) dhe vendos se cila makinë do të të shërbejë si kompjuter nikoqir (në të duhet të jetë Windows XP). Për sa i përket instalimit dhe konfigurimit të hardware për rrjetë, të keni parasyshë që ju duhet të pajisni secilin kompjuter në rrjetin e juaj me kartelë të rrjetit (NIC), gjithashtu i quajtur adapter i rrjetit. Në qoftë se, dëshironi të lidhni më shumë se dy PC, atëherë ju nevojitet **hub** ose **switch**, që paraqet një kuti të veçantë tek e cila kabllot nga secili adapter i rrjetit kyçen. Shumica e pakove të rrjetave shtëpiake që ndodhen në shitje përmbajnë adapterët e rrjetit si dhe **hub** paisjen, njashtu edhe instruksionet për konfigurim.

Hapi i tretë, në të cilin ju duhet të ekzekutoni Windows XP Network Setup Wizard në secilin kompjuter që dëshiron t'a kyçësh në rrjetë, ju mundson që shumë shpejtë dhe lehtë të konfiguroni secilin PC për rrjetë, duke e bërë punën e konfigurimit të rrjetit shtëpiake shumë më pak të vështirë dhe të pabezdisshme se që keni menduar juve.



## SHQIPE E QARTË

Hub apo Switch      Dallimi në mes të **hub** dhe **switch** është se switch është më shumë ose më pak një hub “i mençur”. Kur një kompjuter dërgon një kërkesë deri te ose i ndanë të dhënat me një kompjuter tjetër, hub e dërgon atë deri tek secili kompjuter i lidhur në atë rrjetë, duke besuar se PC për të cilin të dhënat janë dedikuar do t’i njohi ato dhe do të përgjigjet. Switch mëson se cili kompjuter është cili dhe i dërgon të dhënat vetëm tek ai PC për të cilin janë dedikuar.

Network Setup Wizard është sqaruar në paragrafet vijuese, njashtu siç edhe janë shpjeguar punët të shoqëruara me përdorimin e rrjetës shtëpiake, përfshirë çasjen e fajllave të rrjetit.

### PËRDORIMI I NETWORK SETUP WIZARD

Pasi të keni instaluar hardware e domosdoshëm për rrjetë, ju mund të konfiguroni secilin kompjuter të përdorë rrjetin duke ekzekutuar Network Setup Wizard. Ky Wizard automatizon disa procedura të cilat kanë qenë bërë manualisht në versionet paraprake të Windows, përfshirë këtu edhe konfigurimin e adapterëve të rrjetës, konfigurimin e të gjithë kompjuterëve të juaj që të ndajnë së bahku një koneksion të vetëm të Internetit, emërtimin e secilit kompjuter, konfigurimin e ndarjes së fajllave dhe të shtypsit, instalimin e firewall dhe shumë të tjera.

Ndjek këta hapa që të ekzekutosh Network Setup Wizard:

1. Kliko **Start, All Programs, Accessories, Communications, Network Setup Wizard**.
2. Kliko **Next** që të fillosh konfigurimin e rrjetës shtëpiake. Sigurohu se ke instaluar të gjithë adapterët e rrjetit, modemët dhe kabllot; i ke aktivizuar të gjithë kompjuterët, shtypsat dhe modemët e jashtëm; si dhe je i lidhur në Internet. Pastaj kliko **Next**.
3. Kompletu secilin hap në Wizard, duke i'u përgjigjur pyetjeve të bazuara në konfigurimin e juaj të veçantë dhe kliko **Next** për të ecur në hapat tjerë. Ju mund të selektoni një nga vijueset:

- Si e çasë PC e juaj Internetin (shiko Figurën 18.3)



FIGURA 18.3

*Kompjuteri i kyçur në rrjetë ose duhet të posedojë koneksion direkt në Internet ose një koneksion përmes një PC tjetër ose router. Kjo kuti e dialogut i tregon Windows XP se cilin model përdorni juve.*

- Lloji i kompjuterit që juve po konfiguroni
- Shkruni emrin dhe përshkrimin e kompjuterit
- Emërto rrjetin që po e realizon
- Konfirmo parametrat e këtij rrjeti
- Dhe pastaj konfiguro të gjithë kompjuterat e kyçur në rrjetë

Kur të ketë përfunduar kompletimi, ju shifni butonin Finish. Pastaj nga ju kërkohet të ristartohet kompjuteri që të përfundon konfigurimi për këtë kompjuter dhe të fillon konfigurimi për të gjithë kompjuterat tjerë të lidhur në rrjetë.

## NDARJA E FAJLLAVE

Në mënyrë të parafinuar, një numër i konsiderueshëm i flloderave bëhen në dispozicion për të gjithë kompjuterat në rrjetin e juaj. Për të bërë akoma fllodera në kompjuter, në dispozicion për kompjuterat e tjerë të lidhur në rrjetin e juaj, ju duhet të aktivizoni ndarjen e fajllave për ata fllodera.

(Ju duhet të ekzekutoni këtë punë në të gjithë kompjuterat e lidhur në rrjetë të cilët përmbajnë folldera që ju dëshironi t'i bëni në dispozicion në rrjetë.)

Për të ndarë fajlla, ndjek këta hapa:

1. Kliko me tastin e djathtë follderin që dëshiron ta shpërndarësh në rrjetë dhe kliko komandën **Sharing and Security**. Kutia e dialogut të vetive të follderit hapet, me tabulatorin **Sharing** të shfaqur.
2. Selektu katrorin e zgjedhjes tek **Share this folder on the network** (shiko Figurën 18.4).




FIGURA 18.4

*Përdorë tabulatorin Sharing për të aktivizuar ndarjen e follderit për follderin e selektuar.*

3. Në qoftë se dëshiron që përdoruesit në makinat tjera të kenë mundsi të ndryshojnë përmbajtjen e këtij follderit, atëherë selektu katrorin e zgjedhjes tek **Allow network users to change my files**. Pastaj kliko butonin **OK**.

## KËSHILLË

Sharing i Drajvave dhe i Paisjeve Përveç ndarjes së follderave dhe fajllave, ju mund të ndani edhe drajvat dhe paisjet, siç janë: shtypsat, skenerat dhe të tjera paisje. Ndjek hapat e njejtë, por në vend të klikut të djathtë në follder, kliko me tastin e djathtë në drajv respektivishtë paisje.

Ju mund t'i gjeni fajllat e ndarë në rrjetë përmes My Network Places. Punon ngjashëm si edhe My Computer, përveç që në këtë rast u shfaq fajllat e kompjuterëve të tjerë në rrjetë në vend të atyre të sistemit të juaj.

Për të shikuar këta fajlla, ndjek këta hapa:

1. Kliko butonin **Start** dhe pastaj kliko **My Network Places**. Shfaqet dritarja e My Network Places duke i listuar të gjithë follderat e ndarë në rrjetë.
2. Kliko dy herë mbi ikonën e follderit që ta hapësh atë follder (shiko Figurën 18.5).




FIGURA 18.5

*Kur hapni My Network Places, ju shifni të gjithë follderat e ndarë në rrjetë.*

## NDARJA E KONEKSIONIT TË INTERNETIT DHE SHTYPSIT

Disa versione të AOL nuk u lejojnë të shpërndani një koneskion të vetëm të Internetit me shumë makina të tjera (kontakto AOL për më tepër informatë). Megjithë këtë, ISP të tjera mund të ju ngarkojnë me ndonjë shumë paksa më të madhe kur vendosni të përdorni një koneskion të vetëm edhe në më shumë kompjutera.

Shtypsi i rrjetit punon në mënyrë të njejtë me të gjitha aplikacionet e juaja si edhe shtypsi lokal. Thjeshtë selekto **Network the printer** nga kutia e



Dialogut të shtypsit nga secili program që juve dëshironi të shtypni. Për më tepër informata në lidhje me shtypjen, referohu Mësimi 8, “Shtypja e Dokumentit.”

## SIGURIA E RRJETIT

Në qoftë se rrjeti i juaj shtëpiak ka çasje në Internet, atëherë ju i jeni ekspozuar një rreziku të pranishëm të sulmeve nga **hakerat**, të cilët do mundohen që të vendosin çasjen deri tek kompjuterat e rrjetit të juaj. Një mënyrë e pengimit të çasjes nga ana e përdoruesve të pa autorizuar është aktivizimi i **firewall**. Windows XP vjen i kompletuar me firewall i cili instalohet në mënyrë automatike kur ju ekzekutoni Network Setup Wizard në makinën me çasje direkte në Internet. Për më tepër informata në lidhje me Internet Security, shiko Mësimi 10, “Shfletimi i Internetit.”



### KËSHILLË

Më shumë informata Ky mësim deri diku shpjegon ca detaje të rrjetave, por ju të paktën e keni idenë se çfarë keni mundsi të bëni. Për më tepër informata, konsideroni që t'i referoheni librit **Special Edition Using Windows XP Home Edition**, gjithashtu publikim i **Que** (ISBN#0-7897-2627-0).

Ky mësim shpjegoi mënyrën se si konfigurohet një kompjuter për t'u përdorur nga shumë përdorues si edhe realizimin e rrjetës kompjuterike nga disa kompjutera. Mësimi i ardhshëm do të shpjegon konfigurimin e hardware të ri dhe risijimin e drajverave të hardware.



## MËSIMI 19

# Konfigurimi i Hardware të Ri

*Në këtë mësim do të mësoni të bëni konfigurimin e hardware të ri ashtu si edhe të risijoni drajverat e hardware.*

### KONFIGURIMI I HARDWARE TË RI

Përderisa përdorni kompjuterin, do të paraqitet nevoja që t'i shtoni ndonjë komponentë sistemit të juaj. Ju mund të bleni kamerë digjitale ose skener (shiko Mësimi 12, “Puna me Fotografitë”). Gjithashtu, ju mund të shtoni lexuesin e DVD ose të CD-RW (drajvi me mundsi rishkrimi). Ose juve mund të jeni duke ndëgjuar muzikë (e shpjeguar në Mësimi 13, “Ekzekutimi i Muzikës”) dhe dëshironi të hulumtoni pjesën dërmuese të add-ons të muzikës digjitale, siç janë MP3 ose paisjet tjera muzikore portabile.

Në çdo rast, konfigurimi i hardware të ri nuk është edhe aq i lehtë. Në rastet më të mira, thjeshtë ju vetëm lidhni fizikisht paisjen e re për kompjuterin dhe Windows XP e bën konfigurimin automatik. Por në qoftë se kjo nuk ndodhë, atëherë duhet që paisja të instalohet manualisht. Që të dy metodat janë sqaruar në paragrafet vijuese.

### KONFIGURIMI I HARDWARE TË RI NË MËNYRË AUTOMATIKE

Për të bërë konfigurimin e hardware në mënyrë automatike, thjeshtë ndjek instruksionet e instalimit të paisjes në fjalë. Për disa komponente periferike, juve vetëm e lidhni paisjen për portin që është në dispozicion. Për shembull, shumica e skenerëve lidhen për portin USB, përderisa shumica e video-kamkorderëve digjital lidhen për PC e juaj përmes portit Firewire.



## SHQIPE E QARTË

USB and Firewire      USB ose **universal serial bus**, është lloj i portit të cilin e takojmë në shumicën e kompjuterave PC. Ju mund t'i lidhni paisjet për këto porte duke i kyçur ato me anë të kablrit USB për portin USB në kompjuterin e juaj.

Firewire, ndryshe e quajtur IEEE 1394b, paraqet një teknologji me shpejtësi të lartë për lidhjen e paisjeve periferike të cilat transferojnë sasi të mëdha të të dhënave, siç janë disqet e ngurta të jashtëm ose video-kamkorderët digjital. Shumica e PC nuk vijjnë me këto porte të ndërtuara, që zakonishtë kërkohet nga ju që të instaloni kartelën Firewire.

Disa paisje hardware, mund të ndodhë që kërkojnë fikjen e kompjuterit dhe hapjen nga ana e juaj e shtëpizës së kompjuterit tuaj. Për shembull, për instalimin e kartelës së rrjetit LAN ose modemit të mbrendshëm, atëherë ju duhet të fikni kompjuterin, të largoni mbulesë e shtëpizës dhe pastaj të vendosni kartelat në kallëpet adekuate të pllakës amë.

Në secilin nga këto raste në qoftë se Windows XP njehë hardware e ri, atëherë në mënyrë automatike starton Add Hardware Wizard dhe fillon të pyes për paisjen informata të konfigurimit. Pastaj, ai instalon fajllin e drajverit të duhur dhe u lajmëron se paisja është gjetur dhe instaluar. Përderisa mbaron ky process ju shifni mesazhet e lajmërimit në system trayin në task bar. Pas kësaj ju mundeni të përdorni paisjen e juaj.



## SHQIPE E QARTË

Drajveri      Drajveri paraqet llojin e veçantë të fajllit i cili i tregon Windows XP detajet për paisjen hardware të posaçme. Windows është i pajisur paraprakisht me shumë drajvera të komponenteve periferike. Në përgjithësi komponentet periferike vijjnë me diskun i cili përmban drajverin për të përdorur ato komponente. Në qoftë se Windows i duhet ky drajver atëherë ai kërkohet nga ju të instalohet drajveri i kërkuar.

## KONFIGURIMI I HARDWARE TË RI MANUALISHT

Në qoftë se Add Hardware Wizard nuk starton në mënyrë automatike dhe nuk e gjenë paisjen hardware të re në mënyrë automatike, atëherë ju mund të startoni wizard manualisht. Ose lëreni Windows të hulumton dhe instalon paisjen e re ose selektoni prodhuesin e paisjes dhe produktin nga lista. Ndjek këta hapa:

1. Hape menynë Start, kliko me tastin e djathtë të miut ikonën **My Computer** dhe selekto **Properties**. Në kutinë e dialogut të System Properties, kliko tabin **Hardware** (shiko Figurën 19.1). Pastaj kliko butonin **Add Hardware Wizard**.




FIGURE 19.1

*Ju mund t'a çasni Hardware Wizard ose nga kutia e dialogut të System Properties ose nga Control Panel.*

Ose

Kliko **Start**, pastaj kliko **Control Panel**. Kliko **Printers and Other Hardware**. Në zonën See Also të Task Pane, kliko **Add Hardware**.

Që të dyjat shfaqin hapin e parë të Add Hardware Wizard.

## KËSHILLË

Përdor Diskun e Hardware Dritarja e hapjes së Add Hardware Wizard rekomandon përdorimin e diskut i cili ka ardhur së bashku me hardware për të bërë konfigurimin e paisjes. Gjithashtu, ju mund t'a përdorni këtë metodë. Për të bërë një gjë të tillë, ndjek instruksionet specifike për komponenten hardware të posaçme.

2. Kliko **Next** për të ecur nje hap para nga dritarja Welcome. Ju pyeteni se a është paisja tashmë e lidhur fizikishtë (shiko Figurën 19.2).



FIGURA 19.2

*Windows XP se pari dëshiron të dijë se a është e lidhur paisja.*

3. Në qoftë se paisja e juaj është një paisje e jashtme që lidhet përmes USB apo Firewire, sigurohuni që ajo të jetë e lidhur dhe klikoni **Yes, I have already connected the hardware**. Në qoftë se paisja e juaj është e instaluar përbrenda ose e lidhur për portin paralel të kompjuterit të juaj, së pari duhet t'a fikni PC e juaj para se të instaloni ose lidhni atë. Kliko **Next** për të ecur një hap para. Ju shifni një list të të gjitha paisjeve tashmë të instaluara. (Ju mund të përdorni këtë listë për të zgjidhur ndonjë problem të paisjes. Shiko “Zgjidhja e Problemeve Hardware” më vonë në këtë mësim.) Figura 19.3 paraqet këtë hap.



FIGURA 19.3

*Për të shtuar hardware, selekto opcionin e fundit në listën e paisjeve hardware.*

4. Selekto **Add a new hardware device** dhe kliko **Next**. Ju keni zgjedhjen që të leni Windows XP të kërkojë për paisjen e re dhe të bëj konfigurimin automatik ose ju të bëni konfigurimin manualisht (shiko Figurën 19.4). Proveni kërkimin fillimisht. Për të përdorur metodën manuale, selektoni këtë opcion dhe kërceni në hapin e 6.




FIGURA 19.4

*Windows ofron dy metoda për gjetjen dhe instalimin e hardware: autmatike dhe manuale.*

5. Selektu opcionin automatik (i rekomanduar) dhe kliko **Next**. Windows XP kërkon për paisjen e re. Në qoftë se paisja është gjetur, Windows XP pastaj e instalon paisjen e re. Përcjell dritaret e mëvonshme për të kompletuar këtë konfigurim.
6. Në qoftë se paisja hardware nuk është gjetur, kliko **Next**. Ju shifni listën e kategorive të komandave hardware. Gjithashtu, po këtë listë do t'a shifni po që se do të kishit selektuar opcionin e konfigurimit të hardware në mënyrë manuale në hapin e 4. Figura 19.5 paraqet këtë listë.




Figura 19.5

Ju mund të selektoni llojin e hardware nga lista e paisjeve të ngjashme.

7. Selektu llojin e paisjes suaj dhe kliko **Next**. Nga ju kërkohet të selektoni prodhuesin dhe modelin e paisjes që ju instaloni (shiko Figurën 19.6).

## KUJDES

Paisja nuk Ndodhet në Listë Në qoftë se paisja nuk është e listuar, kliko **Show All Devices** dhe pastaj kliko **Next**.

8. Lëviz shiritin rrëshqitës të listës që të gjeshë prodhuesin e paisjes suaj. Pastaj kliko atë. Pastaj do shifni modelet e këtij prodhuesi në dispozicion në listën e Modeleve.

Kliko modelin dhe kliko **Next**. Ndjek instruksionet në ekran për të kompletuar procesin e instalimit të paisjes suaj. Pastaj ju do të mund t'a përdorni paisjen e juaj hardware të re.





Figura 19.6

*Selekto prodhuesin si dhe modelin e paisjes nga lista.*



## KËSHILLË

Përdore Diskun Në qoftë se prodhuesi i paisjes suaj nuk ndodhet në listën e kutisë së dialogut, por ju keni diskun i cili ka ardhur së bashku me paisjen, kliko butonin **Have Disk** dhe përcjell instruksionet në ekran. Në qoftë se nuk keni diskun e drajverit më të riun së bashku me paisjen, provoni të kërkoni versionin që mund të ç'ngarkohet nga Web sajt i prodhuesit.

## RISIJIMI DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE TË PAISJEVE

Ju mund të shikoni listën e paisjeve të instaluara në kompjuterin e juaj. Ju do të bëni këtë për të marrë informatë për paisjen, për shembull, se a ndodhet apo jo e listuar. Por këtë do të mund t'a bënit edhe në qoftë se dëshironi t'a risijoni drajverin e paisjes ose të merrni ndihmë në zgjidhjen e problemeve eventuale të paisjes së veçantë.



Për të filluar, hap Device Manager duke bërë këta hapa:

1. Kliko butonin **Start**, kliko me tastin e djathtë mbi ikonën **My Computer** dhe selekto **Properties** për të hapur kutinë e dialogut të System Properties. Pastaj kliko tabin **Hardware** (referohu Figurës 19.1).
2. Kliko butonin **Device Manager**. Ju shifni dritaren e Device Manager dhe listën e kategorive të paisjeve hardware. Secila kategori ka një shenjë të plusit pranë saj. Ju mund të klikoni shenjën e plusit për t'a zgjeruar listën dhe shikoni paisjen(et) e instaluara për secilën kategori. Figura 19.7 paraqet kategorinë e Modemit të zgjeruar.




FIGURA 19.7

*Ju mund të zgjeroni dhe mblidhni listën e paisjeve hardware për të shikuar paisjen(et) në secilën kategori.*

3. Për të bërë ndryshime ose për të shikuar informatat në lidhje me ndonjë paisje të veçantë, kliko në listë. Pastaj ju mundeni të përdorni menyte në dritaren e Device Manager për të bërë ndryshime. Një alternativë tjetër, klikoni me tastin e djathtë paisjen për të shfaqur menyne e çasjes së shpejtë.

## TË SHIKUARIT E VETIVE TË PAISJES

Për të shfaqur informatat në lidhje me paisjen, kliko me tastin e djathtë paisjen dhe selekto **Properties** ose kliko paisjen dhe pastaj kliko **Action**, komandën **Properties**. Në secilin nga këto raste, ju shifni kutinë e dialogut të vetive për paisjen e selektuar. Figura 19.8 paraqet kutinë e dialogut të vetive për modemën.




FIGURA 19.8

*Ju mund të shikoni detajet e informatës në lidhje me paisjet e instaluar duke shfaqur kutinë e dialogut të vetive të saj.*

Tabularët dallojnë mvarësishtë nga paisja e selektuar, por ju keni mundsinë e klikimit të secilit tab për të parë informatat. Për shembull, për modemët tabi **General** tregon listën e paisjeve, prodhuesve dhe lokacionin (si është i lidhur). Gjithashtu, ju shifni edhe gjendjen e paisjes. Ju mund të klikoni tabin e **modemit** për të konfiguruar altoparlantët, shpejtësinë maksimale të portit, si dhe kontrollin e thirrjes telefonike. (Përsëri, mos harroni se këto tabe dhe opcionet në të dallojnë nga ajo se çfarë keni selektuar.) Përdorë tabin **Advanced** për të shkruar në komandat e posaçme të modemit ose të vendosni parametra të avancuar për portin. Përdorë tabin **Driver** për të shikuar informatat mbi drajverin (shiko paragrafin “Risijimi i Drajverave të Paisjeve”). Tabulatori **Resources** liston informatat teknike siç janë: kujtesa dhe parametrat e IRQ (ju nuk duhet

t'i modifikoni këto parametra). Përdorë tabin Diagnostics për të disgnostifikuar problemet e mundshme në modem.

## ZGJIDHJA E PROBLEMEVE TË PAISJES

Në qoftë se keni probleme me ndonjërin nga paisjet hardware, atëherë ju do të mund të përdorni njërin nga mënyrat e zgjidhjes të Windows XP, për të shfaqur problemet e rëndomta si edhe zgjidhje te mundshme. Ju mund t'i çasni këto zgjidhje nga Device Manager.



### KËSHILLË

Troubleshoot nga Add Hardware Wizard      Ju mund të zgjidhni problemet në paisje duke përdorur Add Hardware Wizard. Kur lista e drajverave të instaluar të shfaqet, selekto paisjen që ka problem, si dhe ndjek instruksionet ne ekran për të shfaqur problemin.

Ndjek këta hapa:

- a) Kliko me tast të djathtë mbi paisjen dhe selekto **properties**. Pastaj kliko butonin **Troubleshoot** në kutinë e dialogut të vetive (referohu Figurës 19.8). Duke vepruar kështu, do të startohet Help i Windows XP dhe do të shfaq informatat për zgjidhjen r problemit (shiko Figurën 19.9).
- b) Selektu problemin nga lista dhe pastaj kliko **Next**. Windows XP fillon me pyetjet për ju që të provoni të definoni problemin. Përgjigjuni pyetjeve, pastaj duke klikuar **Next** ecni nga hapi në hap. Kur Windows të ketë identifikuar problemin, atëherë u rekomandon disa mënyra të zgjidhjes së atij problemi. Provoni secilën nga mënyrat e dhëna. Ndoshta do të kërkohet nga ju që të kaloni nëpër shumë faqe me pyetje dhe sygjerime të ndihmës përderisa të jetë zgjidhur problemi.

Për shembull, në qoftë se problemi juaj me modemën është lidhja në Internet, atëherë Windows XP ju pyet se modemi juaj a nxjerrë ndonjë tingull. Në qoftë se selektoni **No**, Windows XP sugjeron që ju të verifikoni modemën se a është i lidhur ashtu si duhet. Po që se veproni kështu, pastajju do të mund të selektoni disa nga opcionet e paraqitura në variantin e zgjidhjes (shiko Figurën 19.10).

Duke selektuar **Yes** bëhet zgjidhja e problemit. Ju keni mundsinë e anulimit të zgjidhjes së rekomanduar ose të klikoni **No** për të shfaqur zgjidhje tjera të mundshme.




FIGURA 19.9

*Përdorë veglën Troubleshoot për të definuar problemin e juaj, dhe pastaj gjej zgjidhjen e mundshme për atë problem.*




FIGURA 19.10

*Në qoftë se zgjidhja e parë nuk kryen punë, atëherë mund të kërkonti që Windows të shfaq zgjidhje të tjera të mundshme.*



## KËSHILLË

Shiko Help Gjithashtu ju mund të çasni informatat e veglës Troubleshooting përmes komandës Help. Shiko Mësimin 17, "Mirëmbajtja e PC së juaj".

Në qoftë se vegla Troubleshooting e Windows XP nuk arrijnë të identifikojnë problemin e juaj hardware atëherë ju do të sygjerojeni që të kontaktoni shërbimin teknik. Përderisa përkrahja teknike e Microsoftit do të mundën ndoshta të ju ndihmojnë në zgjidhjen e problemit, por gjëja më e mirë do kishte qenë që ju të kontaktoni departamentin teknik të prodhuesit të paisjes suaj (ky informacion duhet të jetë i disponueshëm në dokumentacion ose në Web sajtin e prodhuesit).

## RISIJIMI I DRAJVERAVE TË PAISJEVE

Nganjëherë kur paisja nuk punon si duhet, mund të kërkohet nga ju që t'a largoni atë dhe t'a ri-instaloni atë. Për shembull, në qoftë se paisja punon në mënyrë sporadike, atëherë ju do të dëshironit që t'a largonit atë nga konfigurimi i Windows XP dhe të provoni përsëri t'a ri-instaloni atë. Një opcion tjetër do të kishte qenë, që ju të kërkonit nga Windows XP të skenoj hardware e veçantë për ndryshime eventuale. Në qoftë se paisja u shkakton shumë telashe dhe ju nuk keni kohë për t'a rregulluar atë ose ju duhet të pritni deri sa t'a gjeni drajverin e risijuar, ju mund t'a ç'aktivizoni atë (ta çkyçni ashtu që drajveri është akoma i instaluar, por paisja nuk është në dispozicion).

Ju mund të bëni secilin nga këto veprime duke shfaqur Device Manager. Atëherë klikoni me tastin e djathtë mbi paisje dhe selektoni komandën adekuate. Ju mund të selektoni **Disable**, **Uninstall**, ose **Scan** për ndryshime hardware. Për secilën komandë, nga ju kërkohet të konfirmoni aksionet e mundshme. Për shembull, në qoftë se deinstaloni paisjen, atëherë kërkohet nga ju të konfirmoni deinstalimin e saj nga sistemi.

Një opcion tjetër do të kishte qenë risijimi i drajverit. Siç u përmend më herët në këtë mësim, drajveri i paisjes është një fajll i cili i tregon Windows XP detajet teknike në lidhje me paisjen e posaçme. Windows XP përmban shumë drajvera të paisjeve të regjistruara paraprakisht. Komponenten hardware që ju e shtoni gjithashtu vjen me një disk i cili përmban drajverin e paisjes në fjalë. Këto janë të risijuara periodikisht në qoftë se paisja ka problem (të quajtura bugs) ose në qoftë se Windows është i risijuar.

Risijimi i drajverave kur nxjerret version i ri i Windows, siç është Windows XP, paraqet një punë të zakonshme. Microsoft i teston dhe i ofron shumicën e drajverave, por nuk mundet t'i testojë të gjitha paisjet periferike hardware. Megjithë këtë, prodhuesi i paisjes shpesh nxjerrë drajverat e ri që punojnë me vesrionet e reja të Windows.


Për të risijuar drajverin e juaj, ndjek këta hapa:

1. Hap Device Manager.
2. Kliko me tastin e djathtë mbi paisjen dhe selekto **Update Driver**. Kur të keni selektuar Update Driver, Windows XP starton Update Hardware Wizard (shiko Figurën 19.11).



FIGURA 19.11

Përdorë Hardware Update Wizard për të risijuar drajverin e juaj.



## KËSHILLË

Përdorë tabin Driver Gjithashtu ju mund të shfaqni kutinë e dialogut të vetive të paisjes, kliko tabin **Driver** dhe përdorë butonat në atë tab për të risijuar drajverat.

3. Ndjek hapat në wizard, duke bërë selektimet e juaja klikoni **Next** që të ecni nga hapi në hap.



## KËSHILLË

Hardware Update Wizard      Wizard për Risijim të Hardware bënë kontrollimin e vetëm drajverave të çertifikuar të Windows. Mund të ndodhë që prodhuesi i paisjes së juaj të ketë nxjerrë risijimet e drajverave ashtu që Microsoft në pamundësi të kohës nuk i ka çertifikuar akoma. Në këtë rast, ju duhet të vizitoni Web sajtin e prodhuesit të paisjes së juaj hardware për të ç'ngarkuar drajverat e tyre (filimisht sigurohuni që janë të dizajnuar për Windows XP). Instruksionet për të instaluar atë si duhet gjithashtu do t'i gjeni në Web sajtin e tyre.

Ky mësim shpjegoi mënyrat e konfigurimit të paisjes së re hardware. Mësimi i ardhshëm shpjegon përdorimin e opcioneve të veçanta për përdoruesit me aftësi të kufizuara fizike. Windows XP përmban disa programe Accessibility Accessories ashtu si edhe disa veçori në Control Panel.




## MËSIMI 20

# Përdorimi i Veçorive të Accessibility

*Në këtë mësim do të mësoni të përdorni programet Accessibility Accessories dhe opcionet e Control Panel për të bërë konfigurimin e Windows për përdoruesit me aftësi të kufizuara fizike.*

### PËRDORIMI I PROGRAMEVE TË ACCESSIBILITY

Windows XP ofron programe të cilat e lehtësojnë përdorimin e sistemit operativ për personat me aftësi të kufizuara fizike. Magnifier zmadhon përmbajtjen e ekranit të juaj, Narrator e lexon përmbajtjen e ekranit të juaj zëshëm, si dhe On-Screen tastiera u mundson përdoruesve të cilët kanë kufizime në lëvizshmëri që të shkruajnë në ekran duke përdorur shënjesin e miut.



### KËSHILLË

Menagjo Programet e Accessibility Ju mund të menagjoni që të tre programet accessibility duke përdorur Utility Manager. Gjithashtu, ju mund të përdorni Accessibility për të bërë konfigurimet dhe aktivizuar secilin nga programet. Për të përdorur këto programe, selektoji ata nga menya e Accessibilities.

Për të startuar secilin nga këta programe të accessory, ndjek këta hapa:

1. Kliko butonin **Start**, selekto **All Programs**, zgjedh **Accessories**, dhe pastaj kliko **Accessibility**.
2. Kliko njërin nga programet: **Magnifier**, **Narrator** ose **On-Screen keyboard**. Programi i zgjedhur do të startohet.





## KUJDES

Kutitë Informative të Dialogut Kur të startoni secilin program ju do të vëreni paraqitjen e kutisë së dialogut e cila ofron informata në lidhje me programin që e keni hapur. Thjeshtë, lexojini përmbajtjen e kutisë së dialogut dhe klikoni butonin **OK** për t'a mbyllur atë.



## KUJDES

Minimizo Programin Për të mbajtur programin të hapur, por kutinë e dialogut të programit të larguar nga pamja në ekran, kliko butonin **Minimize** në këndin e djathtë lartë të kutisë së dialogut.

## PËRDORIMI I MAGNIFIER

Magnifier zmadhon një pjesë të ekranit të juaj ashtu që ju të mund të shifni më mirë përmbajtjen në ekran. Pjesa e sipërme e ekranit paraqet lokacionin ku ndodhet shënjesi i miut. Pjesa tjetër e ekranit paraqet pamjen “e rregullt” të dritares. Në figurën 20.1, për shembull, ju shifni kutinë e dialogut të Display Properties të hapur. Sipërfaqja e zmadhuar paraqet lokacionin e shënjesit të miut. Ju mund të përdorni këtë vegël për t'i parë më mirë opcionet dhe selektuar ato.

Për t'a akorduar më mirë këtë program, ju mund të përdorni kutinë e dialogut të Magnifier Settings, të paraqitur në Figurën 20.2. Kjo kuti e dialogut paraqitet kur ju të startoni programin. Bëni njërën nga vijueset:

- Për t'a modifikuar nivelin e zmadhimit, shfaq listën rënëse dhe selekto nivel të ndryshëm. Sa më i lartë niveli, aq më i madhë do të paraqitet lokacioni aktual i shënjesit të miut.
- E pararendinuar, Magnifier në mënyrë automatike ndjek kursoren e miut, fokusin e tastierës dhe editimin e tekstit. Për të ç'kyçur secilën nga opsionet e gjurmimit, deselektoni ato.
- E pararendinuar, kutia e dialogut të Magnifier Settings shfaqet. Ju mund të zgjedhni të startoni programin të minimizuar. Gjithashtu, ju mund t'i invertoni ngjyrat. Për të vepruar kështu, selekto njërën nga këto opsione në sipërfaqen e prezantimit të kutisë së dialogut.




FIGURA 20.1

*Ju mund të zmadhoni lokacionin aktual të shënjesit të miut ashtu që të mund t'i shifni më mirë dhe selektoni opcionet.*

Për të dalë nga Magnifier, kliko butonin **Exit** në kutinë e dialogut të Magnifier Settings.

## PËRDORIMI I NARRATOR

Kur t'a startoni Narrator, do të hapet dritarja e këtij programi. Klikoni **OK**. Ju shifni kutinë e dialogut të Narrator, të paraqitur në Figurën 20.3, si dhe Narrator në mënyrë të paradefinuar lexon ndodhitë në ekranë si dhe karakteret e shtypura.

Gjithashtu, Narrator ka mundsinë e lëvizjes së shënjesit të miut në ikonën aktive. Një opcion tjetër, ju mund të startoni programin të minimizuar. Selektoni cilëndo nga opcionet e dëshiruara në kutinë e dialogut të Narrator.

Ju mund të selektoni tingullin që do t'a përdorni për Narrator, ashtu si edhe shpejtësinë, zërin si dhe tonin e atij tingulli. Për të bërë këtë, kliko

butonin **Voice** në kutinë e dialogut të Narrator. Do të hapet kutia e dialogut të Voice settings; vendos parametrat tuaj, dhe pastaj kliko butonin **OK**.




FIGURA 20.2

*Përdor kutinë e dialogut të Magnifier Settings për të bërë ndryshime përmes të cilave shofim se si punon ky program.*




FIGURA 20.3

*Përdor Narrator ashtu që programi t'i lexon ngjarjet, përfshirë leximin e opsioneve të kutisë së dialogut ashtu si edhe karakteret e shtypura.*

Për të dalë nga programi, kliko butonin **Exit**. Pastaj kliko **Yes** për të konfirmuar daljen nga programi.

## PËRDORIMI I TASTIERËS NË EKRAN

Kur t'a startoni On-screen Keyboard, në ekran shfaqet dritarja Welcome e cila e përshkruan mënyrën e përdorimi të saj. Kliko **OK** për t'a mbyllur kutinë e dialogut. Pastaj ju mund t'a përdorni On-Screen Keyboard për të shkruar, si në Figurën 20.4.



FIGURA 20.4

*Ju mund t'a përdorni On-Screen Keyboard për të shkruar duke përdorur miun.*

Ju mund të shkruani duke klikuar tastet në ekran përmes shënjesit të miut. Në qoftë se preferoni metodë tjetër, atëherë klikoni **Settings, Typing Mode** për të selektuar një metodë tjetër: **Hover** ose **Scanning**. Në regjimin **hove**, ju përdorni miun ose xhoistikun për të tërheqë shënjesin mbi tastin; karakteri i selektuar pastaj do shkruhet. Në regjimin mode, On-Screen Keyboards skenon tastierën, duke theksuar shkronjat; ju shtypni një tast të nxehtë ose përdorni switch-input paisjen sa herë që On-Screen Keyboard thekson karakteret që ju dëshironi t'i shkruani.

## PËRDORIMI I ACCESSIBILITY CONTROL PANEL OPTION

Përveç accessory programs, gjithashtu ju mundeni të përdorni disa nga opcionet e Control Panel. Për të shikuar dhe selektuar keto opsione, ndjek këta hapa:

1. Kliko **Start, Control Panel**.
2. Në dritaren e Control Panel, kliko **Accessibility Options**.

3. Në dritaren Accessibility Options, kliko **Accessibility Options** përsëri. Ju shifni kutinë e dialogut të Accessibility Options (shiko Figurën 20.5).




FIGURA 20.5

Selekto tabulatorin dhe pastaj aktivizo opcionet që dëshiron t'i përdorësh.

4. E paradefinuar, tabulatori i tastierës është shfaqur. Kliko një nga tabulatorët dhe aktivizo opcionet plotësuese duke selektuar katrorët e duhur të zgjedhjes.
5. Kliko **OK**.

Ju mund të selektoni opcionet vijuese:

- Në tabulatorin e tastierës, ju mund t'a aktivizoni Sticky Keys (u mundson të shtypni një tastë mbrenda kohës në vend të tasteve të njëkohëshme), ose Toggle Keys (ekzekuton tonet kur ju shtypni **Caps Lock**, **Num Lock**, ose **Scroll Lock**).
- Në tabulatorin e Sound, ju mund të aktivizoni Sound Sentry (i cili shfaq vërejtjet në lidhje me ekzekutimin e tingujve të sistemit).

Ose ShowSound (instrukton programet që të shfaqin opcionet për tinguj).

- Në tabulatorin Display, ju mund të aktivizoni High Contrast (përdoret për ngjyrat alternative, madhësinë e shkronjave për të përmirësuar kontrastin e ekranit). Ju mund të selektoni shkallen e vezullimit për kursorin ashtu si edhe për gjërësinë.
- Në tabulatorin Mouse, ju mund të aktivizoni Mouse Key në qoftë se ju dëshironi të kontrolloni shënjesin e miut duke përdorur tastet në pjesën numerike.
- Në tabulatorin General, ju mund të vendosni opsione gjenerale siç janë: se a është aktivizuar një veçori pasi të ketë qenë aktive për një periudhë të konsiderueshme kohore, se a e shifni apo ndëgjoni juve tingullin e veçorisë pasi të jetë aktivizuar apo ç'aktivizuar, si dhe opsione të tjera.

Ky mësim shpjegoi se si të bëhet konfigurimi i Windows për përdoruesit me aftësi të kufizuara fizike. Tani ju posedoni të gjitha njohuritë që juve u duhen për t'a përdorur Windows XP për argëtim, në mënyrë të sukseshme si dhe të bëni punë kompjuterike pa stres. Kënaquni!